



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I DREJTËSISË**  
**DEPARTAMENTI I PENALES**



**DISERTACION**

Për mbrojtjen e gradës shkencore

“DOKTOR”

**MASAT E SIGURIMIT**

**Disertanti**

Nikolin Hasani

**Udhëheqës shkencor**

Prof.dr.Maksim Haxhia

Tiranë, 2015



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I DREJTËSISË  
DEPARTAMENTIT I SË DREJTËS PENALE**

PROGRAMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË TË DREJTËN PENALE

**DISERTACION**

Paraqitur nga z. Nikolin Hasani  
Për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

**Tema: MASAT E SIGURIMIT**

Specialiteti : E drejta Penale

Mbrohet më datë :// 2015, para Komisionit të përbërë nga:

1. \_\_\_\_\_ Kryetar
2. \_\_\_\_\_ Anëtar / oponent
3. \_\_\_\_\_ Anëtar / oponent
4. \_\_\_\_\_ Anëtar
5. \_\_\_\_\_ Anëtar

**©2015 E drejta e autorit: Nikolin Hasani**

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin nr.20, datë 13.11.2008.

## FALËNDERIME

Përfundimi i këtij disertacioni nuk do të kishte qenë i mundur pa ndihmën e shumë personave që më kanë mbështetur dhe inkurajuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë kohës së punimit të tij.

Mirënjohje dhe falënderim të veçantë për udhëheqësin tim shkencor në këtë punim të temës së doktoraturës, Prof. dr. Maksim Haxhia, i cili ka kontribuar si shpirtërisht ashtu dhe profesionalisht në mënyrë që punimi të kishte standardet e kërkuara.

Një falënderim të veçantë përprofesorët e nderuar të së drejtës penale: Prof. dr. Maksim Haxhia, Prof. dr. Altin Shegani, Prof. dr. Skënder Kacupi, Prof. dr. Theodhori Karaj, Prof. dr. Vasilika Hysi dhe Prof. as. dr. Artan Hoxha.

Së fundmi, falënderoj familjen time, bashkëshorten për energjitë pozitive që më ka vënë në dispozicion, pa fund falënderime për djemtë e mi të cilëve u kam munguar në kohën që duhej të kaloja me ta.

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

KSH-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

KP- Kodi Penal

KPrP- Kodi Procedurës Penale

KPrPK – Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

GJL - Gjykata e Lartë

GJK - Gjykata Kushtetuese

GJEDNJ - Gjykata e tëDrejtave të Njeriut

KEDNJ – Konventa e të Drejtave të Njeriut

CPP – Kodi i Procedurës Penale Italiane

## PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE .....</b>	<b>8</b>
<b>METODOLOGJIA E PËRDORUR .....</b>	<b>10</b>
 <b>KREU I : MASAT E SIGURIMIT, KUPTIMI, KARAKTERI DHE QËLLIMI</b>	
1.1 Pak histori mbi masat e sigurimit .....	12
1.2 Kuptimi i masave të sigurimit, sipas legjislacionit tonë .....	13
1.3 Kuptimi i të drejtës së lirisë dhe sigurisë sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut .....	19
1.4 Karakteri dhe qëllimi i masave të sigurimit sipas legjislacionit tonë .....	22
 <b>KREU II : MASAT E SIGURIMIT PERSONAL</b>	
2.1 Tipologjia e masave të sigurimit personal .....	34
2.2 Masat e sigurimit personal .....	34
2.2.1 Ndalimi i daljes jashtë shtetit .....	50
2.2.2 Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore .....	51
2.2.3 Ndalimi dhe detyrimi për t'u paraqitur në një vend të caktuar .....	52
2.2.4 Garancia pasurore .....	54
2.2.5 Arresti në shtëpi .....	56
2.2.6 Arresti ne burg .....	59
2.2.7 Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik .....	60
2.3 Tipologjia e masave të ndalimit .....	61
2.3.1 Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publikë .....	62
2.3.2 Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.....	63
2.4 Formaliteti i masave të sigurimit personal .....	63
2.5 Arresti në flagrancë dhe ndalimi i të dyshuarit .....	83
2.5.1 Arrestimi ne flagrance .....	84

2.6 Revokimi dhe shuarja e masave të sigurimit .....	106
2.7 Kohëzgjatja e masave të sigurimit .....	119
 <b>KREU III : MASAT E SIGURIMIT PASUROR</b>	
3.1 Tipologjia e masave të sigurimit pasuror .....	144
3.2 Sekuestro konservative.....	145
3.3 Sekuestro preventive .....	150
 <b>KREU IV : ZHVILLIMI HISTORIK DHE TEORIK I TË DREJTËS PENALE SHQIPTARE NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT</b>	
4.1 Masat e sigurimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1979 .....	158
 <b>KREU V : ANALIZË KRAHASUESE TË MASAVE TË SIGURIMIT SIPAS DISA LEGJISLACIONEVE</b>	
5.1 Masat e sigurimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Italisë .....	164
5.2 Masat e sigurimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës .....	170
 <b>KREU VI : INSTITUCIONET QË LUAJNË ROL NË CAKTIMIN E MASAVE TË SIGURIMIT</b>	
6.1 Roli i Prokurorisë në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit .....	176
6.2 Roli i Gjykatave në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit .....	177
6.3 Roli i Policisë gjyqësore në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit .....	177
 <b>KREU VII: KONKLUZIONE DHE PËRFUNDIME</b>	
7.1 Konkluzione dhe përfundime.....	186
 <b>BIBLIGRAFIA</b> .....	193
<b>ANEKS</b> .....	211

## PARATHËNIE

Historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore ka arritur në stadi të tillë lartësimi të mënyrës së bërjes të gjërave deri në perfeksion, pasi në themele të saj janë vënë idetë brilante të organizimit e drejtimit të saj si një qelizë embrionale në lidhje e bashkëveprim të përhershëm e të pandërprerë me të tretët. Format e evoluimit të shoqërisë njerëzore në themel të organizimit të saj kanë pasur shtetin dhe kolona bazë e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të vet ka qenë ligji.

*“Ligji është arsye e çliruar nga pasioni”*. Nuk mjafton që një shoqëri e caktuar të ketë ligje të mira e me standarde të larta që rrokin të gjitha sferat e veprimtarisë jetësore dhe që premtojnë një zhvillim të vrullshëm në vijimësinë kohë. Kjo është njëra anë, sigurisht e rëndësishme, por nuk do të kishte asnjë funksion apo vlerë reale në rast se nuk do të kombinohej me një vullnet këmbëngulës, real e të vijueshëm për t’i materializuar në praktikën e përditshme jetësore të drejtat e detyrimet, duke respektuar me korrektësi fuqinë e madhe që të jep liria e kurorëzuar në një strukturë vitale brenda ligjshmërisë.

Shteti shqiptar ka ndërmarrë një sërë reformash me qëllimin e vetëm për të forcuar ekzistencën dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Në këtë rrugë të gjatë e plotë sfida për t’u realizuar, pa dyshim që një ndër promotorët kryesorë të tij ka qenë reforma në drejtësi dhe të gjithë elementët përbërëse të saj. Kjo pasi e drejta është ajo që i paraprin, disiplinon dhe normon marrëdhëniet e ndryshme juridiko-shoqërore.

Në mënyrë të pandërprerë është përmirësuar kuadri ligjor si ai civil dhe ai penal, këto ndryshime janë imponuar nga nevoja e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Synimi i sistemit të përgjithshëm në zbatimin e ligjshmërisë duhet të jetë motivi i vetëm që e drejta që jepet në emër të ligjit të përputhet me të vërtetën. Kjo kërkon një njohje të thellë e aftësi të lartë profesionale, mbledhje, administrim e shqyrtim të hollësishëm të fakteve e



provave, gjykim në dritën e tërësisë së ngjarjeve duke i marrë ato në dinamikën reale të zhvillimit me synimin e vetëm duke iu afruar sa më tepër së vërtetës. Nxitimi, anashkalimi apo injorimi i fakteve e provave që në dukje mund të duken të vogla e të parëndësishme, pasioni apo mbajtja anë në një qëndrim të paravendosur apo të ngurtësuar jo vetëm që na largojnë nga e vërteta, por thellojnë padrejtësinë duke dhënë vendime të padrejta që nuk i shërbejnë askujt.

## METODOLOGJIA E PËRDORUR

Në këtë punim doktore, kam përdorur një metodologji disi komplekse e ndërthurur kjo me disa elemente. Gjerësisht në këtë punim kam përdorur rastet studimore, nga praktika e gjykatave apo juridiksioni i tyre. Nëpërmjet metodës analizuese dhe asaj induktive, kam bërë një analizë të këtyre vendimeve, me qëllimin e nxjerrjes në pah të problematikave që mbartin ligjet në lidhje me masat e sigurimit dhe absolutisht nevojën për të bërë reforma drejt përsosjen së tyre.

Në këtë studim kam diskutuar për parimin e lirisë e të sigurisë, si parime themelore të të drejtave të njeriut. Kam diskutuar për masat e sigurimit, si veprime procedurale që heqin dhe kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Gjithashtu kam përmendur parimin tjetër shumë të rëndësishëm i tillë është prezumimi i pafajësisë, sipas të cilit nuk duhet të gjykojmë një çështje deri sa vendimi të ketë marrë formë të prerë ku gjatë gjithë procesit personi do të konsiderohet i pafajshëm.

Liria dhe siguria mbrohen si nga legjislacioni i brendshëm i Republikës së Shqipërisë konkretisht nga Kushtetuta, Kodi i Procedurës Penale, por dhe nga legjislacioni ndërkombëtar i tillë është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është një pikë e rëndësishme orientimi për këtë punim disertacion. Kjo bazë ligjore e gjerë është parë në këndvështrimin e përmirësimeve ligjore dhe risive që ka sjellë dhe mundësive për përmirësim. Gjithashtu një rol të rëndësishëm kanë vendimet unifikuese ndër vite të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, vendime të cilat më kanë ndihmuar për të kuptuar kushtetutshmërinë e masave të sigurimit. Liria e personit është e patjetërsueshme, e padhunueshme, është një e drejtë që personi e gëzon që me lindjen e tij dhe nuk mund të ndërhyjmë për ta ndryshuar këtë gjë me përjashtim të rasteve kur ligji na i lejon një ndërhyrje të tillë, për raste të parashikuara qartë në legjislacion dhe po sipas një procedure të parashikuar në mënyrë eksplicite në legjislacion.

Në këtë studim kam marrë disa aspekte të analizës:

- Së pari si parashikohen dhe zbatohen masat e sigurimit në konceptin aktual. Si vendosen ato në raport me të drejtën e lirisë e të sigurisë;
- Së dyti si kanë evoluar masat e sigurimit me kohën duke analizuar dhe krahasuar me kode të ndryshme ndër vite në Republikën e Shqipërisë;
- Së treti vështrim krahasues me vende të tjera të Evropës ku njohin një zhvillim në legjislacion.

Respektimi i këtyre parimeve është shumë i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Në kushtet kur ne po kërkojmë të aderojmë në Bashkimin Europian, pa respektimin e këtyre parimeve themelore një gjë e tillë do të ngelej në nivelin e një “ëndrre” për të gjithë ne shqiptarët.

Kjo metodologji e përdorur më ka ndihmuar për të nxjerrë në pah karakteristikat, veçoritë dhe problematikat që mbartin masat e sigurimit në një procedim penal. Prandaj pritet çdo kritikë dhe sugjerim nga studiuesit për përmirësimin e tij dhe absolutisht për ndikimin pozitiv drejt përsosjes.

## KREU I

### MASAT E SIGURIMIT, KUPTIMI, KARAKTERIDHE QËLLIMI

#### 1.1. Pak histori mbi masat e sigurimit

Liria personale e personit konsiston në lirinë e këtij të fundit nga çdo lloj shtrëngimi që e ndalon apo e kufizon atë në lëvizje ose në veprime.<sup>1</sup> Si pjesë e lirive pozitive, të cilat realizohen dhe qëndrojnë në krah të lirive negative,<sup>2</sup> liritë personale konsiderohen si liri në shtet.<sup>3</sup> Liria personale nuk mund të kufizohet, veçse në raste dhe mënyrat e parashikuara nga ligji dhe me akt të arsyetuar nga autoriteti gjyqësor.<sup>4</sup>

Liria personale e personit është lidhur pazgjidhshmërisht me imunitetin e qytetarëve nga arrestimet arbitrare. Ai paraqitet në institutin ËRIT HABEAS CORPUS AD SUBIICIENDUM, i cili u shfaq për herë të parë si parim i COOMON LAË -t dhe u disiplinua në kuptimin e sotëm për herë të parë nga “PETITON OF RIGHTS”, në vitin 1628.<sup>5</sup> Si pikënisje fillestare për kodifikimin e disa garancive të procesit të rregullt përgjithësisht konsiderohet MAGNA CARTA e vitit 1215. Kapitulli 29, i versionit të vitit 1279 konfirmuar nga mbreti Eduard, në formën përfundimtare thotë: “Asnjë njeri i lirë nuk mund të burgoset apo të zhvishet nga liritë e tij apo nga zakonet e lira, apo të nxirret jashtë ligjit, përveçse nëpërmjet gjykimit të ligjshëm të të parëve të tij apo ligjit të vendit. Ne nuk do t’i shesim, t’i mohojmë apo t’i vonojmë askujt të drejtat dhe drejtësinë”.<sup>6</sup>

<sup>1</sup> A. Anastasi, *E drejta kushtetuese*, Tiranë 2005, fq. 98.

<sup>2</sup> Liritë pozitive realizohen si rezultat i një sërë ndërhyrjesh të pushteteve publike. Liritë negative, realizohen si rezultat i një sjelljeje mos ndërhyrëse të shtetit.

<sup>3</sup> A. Anastasi, *E drejta kushtetuese*, Tiranë 2005, fq. 80.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> A. Anastasi, L. Omari, *E drejta kushtetuese*, Ribotim, Tiranë 2010, fq. 139-140.

<sup>6</sup> A. Shameti, *Studime Juridike 2*, Tiranë 2006, fq. 52.

Pra, çdo person në çdo gjendje apo situatë duhet të gëzojë mbrojtje qoftë ky dhe autor i akteve kriminale.

Është shtruar pyetja: Përse duhet t'u kushtojmë kaq vëmendje mbrojtjes të autorëve të këtyre akteve kriminale, në vend që më shumë vëmendje t'i kushtojmë viktimës? Kjo duhet të konsiderohet si mbrojtje për të gjithë qytetarët, të cilët mund të akuzohen për kryerjen e një krimi. Ata mbrohen mjaft mirë nga parimi i prezumimit të pafajësisë.<sup>7</sup> Në bazë të këtij parimi, kushdo konsiderohet i pafajshëm përderisa në ngarkim të tij nuk është pranuar fajësia me vendim gjykate të formës së prerë, si dhe nga neni 29 i Kushtetutës.<sup>8</sup> Të dyja këto parime shfaqen si parime garanci për të gëzuar realisht HABEAS CORPUS-in.

## **1.2. Kuptimi i masave të sigurimit sipas legjislacionit shqiptar**

E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit është një nga të drejtat më themelore dhe më të qenësishme të të drejtave të njeriut dhe vjen kurdoherë pas të drejtës së jetës, pasi si liria dhe siguria kanë po të njëjtat vlera si dhe vetë jeta. Termat liri dhe siguri duhen kuptuar si një term i vetëm, i cili duhet ti referohet vetëm lirisë dhe sigurisë fizike. Liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi ndërsa siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij.<sup>9</sup>

Rastet e kufizimit të lirive të personit përbëjnë rezerva kushtetuese, të parashikuara shprehimisht në një listë të mbyllur dhe që nuk mund të ndryshojnë me ligj. Formulimi i Kushtetutës është krejt i ngjashëm me atë që është sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

---

<sup>7</sup> Shih neni 30 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

<sup>8</sup> Ligji nuk ka fuqi prapavepruese.

<sup>9</sup> A. Shameti, *Jeta Juridike nr.4*, Dhjetor 2006, fq. 24.

Kushtetuta u jep mundësi për t'u mbrojtur personave që akuzohen për kryerjen e një veprë penale, për aq kohë sa ata nuk janë deklaruar fajtorë për veprën e kryer, nga gjykata kompetente. Nëse personi dënohet pa u provuar akuzat që janë ngritur në ngarkim të tij, do të ndodheshim para një precedenti mjaft të rrezikshëm për shoqërinë. Kjo na bën të kuptojmë përse liritë personale marrin rëndësi kushtetuese.

Në bazë të nenit 15 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Por ato nuk mund të përdoren për arritjen e qëllimeve kriminale ose në dëm të interesave të të tjerëve, prandaj mund të kufizohen me ligj, duke u mbështetur në nenin 17 të Kushtetutës, ku shprehimisht thuhet: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë nëpërpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”*. Në këtë kuptim, ligji kryesor që përcakton dhe konkretizon mbrojtjen e të drejtave e të lirive dhe rregullat për kufizimin e tyre është Kodi i Procedurës Penale.

Në bazë të dispozitave të K.Pr.Penale, masat e sigurimit mund të përkufizohen si veprime procedurale të cilat heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit.<sup>10</sup> Një përkufizim tjetër përcakton se masat e sigurimit janë heqje dhe kufizime të lirive dhe të të drejtave të personit të proceduar, të parashikuara nga ligji për të parandaluar atë në kryerjen e veprimeve, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, shmangien nga procedimi dhe veprimtaritë e mëtejshme kriminale, si dhe për të garantuar shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.<sup>11</sup> Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Por, siç ka theksuar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>12</sup>

<sup>10</sup> Procedura Penale, H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Botime “Morava”, Tiranë 2007, fq. 230.

<sup>11</sup> A.Gjoleka, E.Shoshi, *Komente mbi masat e sigurimit personal*, Tiranë 1999, Botime “GEER”, fq. 6.

<sup>12</sup> Shih Vendimi nr.489, datë 12.12.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

*“Masa e sigurimit nuk është dënim penal që të përdoret si masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një vepër penale dhe, nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e një çështjeje penale. Masat e sigurimit aplikohen për shkaqe dhe kritere të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedures Penale”.*

Neni 27 i Kushtetutës “Liria”:

1. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
  - a) Kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
  - b) Për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
  - c) Kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
  - d) Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
  - e) Kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
  - f) Për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.
3. Askujt nuk mund t’i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Liria e personit si një nga të drejtat më të rëndësishme garantohet nga Kushtetuta në nenin 27 të saj. Kjo dispozitë fillon me një ndalim ligjor që në pikën 1 të saj, dhe kjo jo pa qëllim por për të treguar se liria e personit nuk mund të cenohet me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj dhe sipas një procedure po të parashikuar në ligj. Legjislatori

i ka kushtuar një rëndësi dhe vëmendje implementimit të kësaj dispozite, pasi ky nen ka të bëjë drejtpërdrejtë me lirinë fizike të personit. Liria e individit është e paprekshme, është një e drejtë e patjetërsueshme, pasi është aq personale sa dhe vet ekzistenca e tij. Ta cenosh atë është njësoj si t'i marrësh jetën këtij individ, t'i heqësh të drejtën e gjithçkaje që ai bën ose do të donte të bënte me jetën e tij, këtë fuqi nuk e ka as vet ligji. Si çdo gjë tjetër, dhe garantimi i të drejtës së lirisë nuk është absolute. Shpesh ndodh që në praktikë të ndeshemi me situata të tilla që të detyrojnë për ta kufizuar këtë të drejtë për një të mirë në interes të shoqërisë.

Në bazë të nenit 27 të Kushtetutës paragrafi 2, liria e personit mund të kufizohet por vetëm në ato raste që parashikohen shprehimisht. Ky paragrafliston rastet në të cilat liria personale e personit mund të kufizohet, dhe vetëm në këto raste të sipërcituara të drejtat dhe liritë themelore mund të cenohen dhe nuk janë absolute. Rastet e heqjes së lirisë, të parashikuara në nenin 27 të Kushtetutës, janë rregulluar me ligje të veçanta. Të gjitha këto raste të heqjes së lirisë, në kuptimin e gjerë, janë masa sigurimi që synojnë parandalimin dhe luftën efektive kundër kriminalitetit dhe rreziqeve të tjera që i kanosen shoqërisë, këtu kam hequr fjalën “konkretisht”, pasi nuk është nevoja që ti themi ligjet sepse i kemi shpjeguar të gjithë me radhë më poshtë.

Të gjitha këto raste të heqjes së lirisë, në kuptimin e gjerë, janë masa sigurimi që synojnë parandalimin dhe luftën efektive kundër kriminalitetit dhe rreziqeve të tjera që i kanosen shoqërisë. Në një kre të veçantë të Kodit të Procedurës Penale, që bën fjalë për masat e sigurimit, është zbërthyer dhe konkretizuar rasti që personit mund t'i hiqet liria “*kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj*”.<sup>13</sup>

Ky është rasti që lidhet drejtpërdrejt me procedimin penal dhe që ndeshet më shpesh në praktikën e subjekteve të këtij procedimi, si një masë sigurimi që sjell heqjen e lirisë dhe

---

<sup>13</sup> Shih neni 27/c i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



shërben për zhvillimin me sukses të luftës kundër kriminalitetit dhe sidomos kundër krimeve të rënda. Për këto arsye, më poshtë do të ndalemi gjerësisht për të theksuar nevojën e kuptimit të drejtë dhe zbatimit me korrektësi të kësaj mase sigurimi. Për rastin *kur personi është dënuar me burgim*, nga gjykata kompetente, në bazë të ligjit procedural,<sup>14</sup> prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit, i cili përmban gjeneralitetet e të dënuarit, dispozitivin e vendimit dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin. Urdhri i dërgohet Policisë Gjyqësore dhe organit shtetëror që administron burgjet.

Heqja e lirisë për shkak të zbatimit të *masave mjekësore dhe edukuese*, bazohet në Kodin penal,<sup>15</sup> i cili përcakton se masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të përgjegjshëm që kanë kryer vepra penale, ndërsa masat edukuese jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që, për shkak të moshës, nuk kanë përgjegjësi penale. Ekzekutimi i vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione mjekësore dhe edukimi bëhet me urdhër të prokurorit sipas ligjit procedural.<sup>16</sup>

*Për personat e sëmurë mendorisht*, që nuk kanë kryer vepra penale, por që paraqesin rrezik për shoqërinë, zbatohen dispozitat e ligjit, “Për shëndetin mendor”.<sup>17</sup> Në bazë të nenit 27 të këtij ligji, një person me çrregullime mendore mund të shtrohet në një institucion psikiatrik, pa pëlqimin e tij ose të kujdestarit ligjor vetëm nëse për shkak të çrregullimit mendor të tij, ai paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën ose shëndetin e tij dhe të të tjerëve. Vendimi për shtrimin e tij merret nga mjeku specialist, i cili i njoftohet personit, familjarëve ose kujdestarit ligjor.

---

<sup>14</sup> Shih neni 464 “Ekzekutimi i vendimeve me burgim”, të K.Pr.Penale.

<sup>15</sup> Shih neni 46 të Kodit Penal.

<sup>16</sup> Shih neni 464 “Ekzekutimi i vendimeve me burgim”, të K.Pr.Penale.

<sup>17</sup> Shih Ligji nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”.

Mjeku detyrohet të njoftojë brenda 24 orëve shefin e klinikës dhe ky i fundit, brenda 48 orëve nga dhënia lejes për shtrim të detyrueshëm, duhet të paraqesë kërkesë para gjykatës së rrethit ku ndodhet institucioni. Kërkesa shqyrtohet brenda tri ditëve nga gjyqtari i vetëm, vendimi i të cilit zbatohet menjëherë. Familjarët ose përfaqësuesi ligjor kanë të drejtë të kërkojnë daljen nga spitali në çdo kohë. Nëse refuzohet dalja nga spitali, ata kanë të drejtë të ankohen brenda 7 ditëve në gjykatën e rrethit dhe vendimi i gjyqtarit është i formës së prerë. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për personat që, për shkak të prapambetjes mendore, nuk janë në gjendje të kujdesen për veten dhe nuk kanë kujdesin e personave të tjerë.

*Për personat që janë përhapës të sëmundjeve ngjitëse, heqja e lirisë bëhet duke zbatuar rregullat e parashikuara në ligj.<sup>18</sup> Në bazë të nenit 16 të këtij ligji, punonjësit e shëndetësisë, të caktuar për këtë shërbim, kanë të drejtë të hyjnë në qendra pune dhe banesa për të bërë hetimin epidemiologjik, izolimin dhe shtrimin në spital të personave të sëmurë. Kur ata hasin pengesa në kryerjen e detyrës, kërkojnë mbështetjen e organeve të rendit, të cilat janë të detyruara t'i ndihmojnë.*

Gjithashtu në ligj,<sup>19</sup> është përcaktuar kompetenca e Policisë Kufitare, në bazë të së cilës ajo “kryen të gjitha veprimet e nevojshme për zbulimin, kapjen, arrestimin në flagrancë të personave që hyjnë dhe dalin nga kufiri në mënyrë të paligjshme”.

Për të gjitha rastet e folura më sipër, Kushtetuta parashikon se:<sup>20</sup> “personi të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase”.

---

<sup>18</sup> Shih Ligji nr.7761, datë 19.10.1993, “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”.

<sup>19</sup> Shih Ligji nr.8772, datë 19.04.2001, “Për ruajtjen e kufijve shtetëror”.

<sup>20</sup> Shih neni 28/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Penale parashikon se:<sup>21</sup> me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata mund të caktojë masa shtrënguese, përfshirë edhe *arrestimin e personit për të cilin është kërkuar ekstradimi*, gjithashtu parashikon edhe mundësinë e caktimit të përkohshëm të një mase sigurimi, të kërkuar nga shteti i huaj, para se të ketë ardhur kërkesa e ekstradimit.<sup>22</sup>

### **1.3 Kuptimi i të drejtës së lirisë dhe sigurisë sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**

Neni 5 “E drejta për liri dhe siguri”, i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:
  - a) Kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
  - b) Kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
  - c) Kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
  - d) Kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent gjyqësor;

<sup>21</sup> Shih neni 493 “Masat shtrënguese dhe sekuestrimet”, të K.Pr.Penale.

<sup>22</sup> Shih neni 494 “Zbatimi i përkohshëm i masave shtrënguese”, të K.Pr.Penale.

- e) Kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
  - f) Kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.
  3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.
  4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
  5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Parimi i lirisë dhe sigurisë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, është sanksionuar në nenin 5 të saj. Ai parashikon të gjithë elementët e privimit të lirisë, duke filluar nga arrestimi fillestar, e deri tek lirimi. Ai definon të drejtën e lirisë, subjekt vetëm i disa përjashtimeve ligjore që lejojnë arrestimin në rrethana të caktuara, të tilla si arrestimi i personave të dyshuar për krim apo burgosjen e personave të dënuar nga gjykata. Gjithashtu

ofron të drejtën për t'u informuar në gjuhën që ata kuptojnë, për arsyet e arrestimit dhe akuzave kundër tyre, të drejtën për paraqitje të menjëhershme në një gjykatë për të përcaktuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit, të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ose të lirimit si pjesë e kohës së procedurës, dhe të drejtën për kompensim në rastet e arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me këtë nen. Ndërsa koncepti i *sigurisë personale* nuk ka qenë ende subjekt i një interpretimi nga GJEDNJ.

Në fakt, brenda nenit 5 të Konventës është inkorporuar parimi i *prezumimit të pafajësisë*, si një garanci e pandarë që shteti duhet të akordojë në respekt të lirisë dhe sigurisë personale.

Ekzistojnë rreth 284 vendime të Dhomës së Madhe të Gjykatës, të cilat kanë vendosur gradualisht një Jurisprudencë të konsoliduar në interpretimin e këtij neni (neni 5), në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndër kryesorët përmenden: *Mansur k. Turqisë*,<sup>23</sup> *Moulin k. Francës*,<sup>24</sup> *Epplë k. Gjermanisë*.<sup>25</sup>

Nga analiza e mësipërme vihet re lehtësisht se neni 5, ka një interpretim të gjerë në praktikën e GJEDNJ. Doja të theksoja se një nga pikat që vazhdon të jetë ende problematike, sidomos për Shqipërinë është ajo e “reparacionit”, dëmshpërblimit. Ky është një pasqyrim i nenit 13 të Konventës dhe frymës mbi të drejtën e ankimit efektiv për individin të cilit i janë shkelur të drejtat e mbrojtura nga KEDNJ. Gjykata këtë veprim e ka ndërmarrë sa herë ka konstatuar një pikë tjetër të nenit 5 të shkelur, pra dëmshpërblim ka atëherë kur ka një objekt fizik ose moral të cenuar.

---

<sup>23</sup> “Respektimi nga gjykata kombëtare të prezumimit të pafajësisë”.

<sup>24</sup> “Prokurori nuk është një autoritet gjyqësor”.

<sup>25</sup> “Rregullsia e arrestimit nga autoritetet policore duhet t’i nënshtrohet sa më shpejt kontrollit gjyqësor”.

Mendoj se jurisprudenca dhe doktrina në aspektin e të drejtave të njeriut po avancojnë me ritme pozitive dhe po sjell një rregullim të veçantë për një fushë prioritare sot për të gjitha vendet: *terrorizmi*.

Duhet vendosur një test proporcionaliteti edhe në rastet e personave të dyshuar për krime terroriste, nevojës së parandalimit të tyre, dhe respektimit të garancive të të drejtës për liri dhe siguri efektive.

#### **1.4. Karakteri dhe qëllimi i masave të sigurimit sipas legjislacionit tonë**

Masat e sigurimit kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.<sup>26</sup>

Respektimi i së drejtës në fuqi është kërkesë dhe kusht i domosdoshëm për ligjshmërinë dhe rendin juridik.<sup>27</sup> Një rëndësi të dorës së parë për forcimin e rendit juridik kanë pikërisht masat që merren për ndalimin e shkeljes së ligjit, forcimit të ndërgjegjes juridike dhe edukatës qytetare të shtetasve. Procedurat, që e drejta të kryejë funksionet e saj duhet të jenë të tilla që të shërbejnë si “sipërmarrje e qëllimshme për të vendosur sjelljen e njerëzve nën qeverisjen e rregullave”. Duke bërë kështu që ligji të kryejë një funksion koordinues, lehtësues dhe orientues, ai është si një busull që ndihmon njerëzit për të planifikuar veprimet e tyre dhe për t'i krahasuar ato me të tjerëve.<sup>28</sup>

---

<sup>26</sup>*Procedura Penale*, H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Botime “Morava”, Tiranë 2007, fq. 340.

<sup>27</sup> L. Omari, *Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike*, Botimet “Elena Gjika”, Tiranë 2006, fq. 198.

<sup>28</sup> L. Ikonimi LLM, *Filozofia e së Drejtës*, cikël leksionesh, Tiranë 2006, fq. 93.

Masat e sigurimit nuk mund të merren me qëllim për të marrë nga i pandehuri bashkëpunimin që ai refuzon të japë, duke u mbështetur në faktin se refuzimi ose e drejta e tij për të heshtur është një nga të drejtat themelore të personit ndaj të cilit merret masa e sigurimit. Pra, kjo konsiston në përforsimin e garancive individuale të personit në proces penal edhe pse në këtë pikë jemi përball një raporti opozitar midis të drejtës për të heshtur dhe masave të sigurimit.

Ajo çka duhet sqaruar në planin teknik është fakti se ndaj kujt mund të merren këto masa sigurimi të karakterit personal. Në plan të parë duhet parë se çfarë parashikon kushtetuta në lidhje me subjektin ndaj të cilit merren këto masa si dhe statusin që ai gëzon. Kushtetuta i referohet subjektit ndaj të cilit mund t'i hiqet liria dhe njoftohet për akuzën që i bëhet me termin "kushdo", pra do të thotë se heqja e lirisë në kohë është më e afërt se njoftimi i akuzës. Në lidhje me këtë do të flasim dhe analizojmë më poshtë.

Masat e sigurimit janë të ndjekura nga disa parime, të cilat në mënyrë eksplicite kanë të bëjnë me masat e sigurimit. Këto parime janë:

### *1. Parimi i Ligjshmërisë*

Ky parim është sanksionuar në nenin 5 paragrafi 1 të K.Pr.Penale, në të cilin sanksionohet se liria e personit mund të kufizohet me masat e sigurimit vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. Legjislatori ka përdorur termin "vetëm", për të shprehur vullnetin e tij në lidhje me kuptimin ekskluziv dhe garantues të këtij parimi, duke e bërë atë kurdoherë laksativ.<sup>29</sup>Një parashikim i tillë ligjor është nën gjurmët e rezervës konstitucionale të shprehur nënenin 27 të kushtetutës. Marrja e masave të sigurimit, revokimi, ndryshimi, pezullimi apo shuarja e tyre janë në kompetencë gjithmonë të gjykatës, gjyqtarit që procedon.<sup>30</sup>Pra, janë vetëm organet gjyqësore ato që gëzojnë kompetencën dhe kanë juridiksionin ekskluziv në lidhje me heqjen apo kufizimin e lirive personale duke i njohur të drejtën prokurorit vetëm

<sup>29</sup> G.Conso, V.Grevi, Compendio di Procedura Penale, Seconda Edizione, Cedam 2003, fq. 366.

<sup>30</sup> Shih neni 244 "Caktimi i masave të sigurimit", të K.Pr.Penale.

për të vendosur në lidhje me arrestimin në flagrancë dhe ndalimin, edhe në këto raste që këto veprime procedurale janë të ligjshme duhet të vlerësohen nga gjykata.

## 2. *Parimi i Fumus Commisti dhe Periculum Libertatis*

Parimi i *fumus commisti delicti* në kuadër të nenit 228 pika 1 dhe 2 të K.Pr.Penale, individualizon kushtet e përgjithshme për aplikimin e masave të sigurimit. Këto kushte në mënyrë të renditur janë:

- a. Ekzistenca, në ngarkim të personit ndaj të cilit merret masa, e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova. Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova përbën themelin për marrjen e masave të sigurimit, gjithmonë këto prova për të ndërtuar një dyshim të arsyeshëm duhet të merren në përputhje me dispozitat e titullit të katërt të K.Pr.Penale, si dhe duhet që të administrohen dhe shqyrtohen në seancë gjyqësore në rast të kundërt ato nuk mund të përdoren.<sup>31</sup> Kjo përbën një nga parimet themelore në lidhje me çmuarjen e provave, faktin se asnjë provë nuk ka vlerë dhe fuqi provuese të paracaktuar dhe se vërtetësiadhe fuqia e saj provuese i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.<sup>32</sup> Ndonëse ligji procedural nuk ka dhënë sqarime se çfarë do të kuptojmë me dyshim të arsyeshëm, por nga nenet 149, 152 dhe 228 të K.Pr.Penale dhe veprimtarisë së praktikës gjyqësore del qartë se me dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova duhet kuptuar një gjendje e logjikshme që krijohet nga të dhëna të caktuara të marra sipas ligjit dhe të shqyrtuara e vlerësuara në tërësi, që krijojnë bindjen se vepra penale ka ndodhur dhe se kjo vepër është kryer nga personi ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa e sigurimit personal.<sup>33</sup>

---

<sup>31</sup> Shih Vendimi nr.64, datë 17.07.2006 dhe nr.114, datë 28.05.2008, të Gjykatës së Lartë

<sup>32</sup> Shih Vendimi nr.5, datë 11.11.2003, të Gjykatës së Lartë

<sup>33</sup> A. Gjoleka, E.Sheshi, *Komente mbi masat e sigurimit personal*, Tiranë 1999, Botime “GEER”, fq. 7



Ky dyshim i arsyeshëm duhet të bazohet në prova të administruara dhe shqyrtuara në proces penal si dhe të ndodhura në dosjen penale<sup>34</sup> dhe të mos ngrihet një dyshim i bazuar në prova fantazmë. Këto prova duhet të bëjnë fjalë për personin e dyshuar, pra duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë ose indirekte me të.<sup>35</sup> Këto prova mund të jenë direkte, indirekte apo dhe indicie, pra duhet të përbëjnë provë në kuptim të nenit 149 të K.Pr.Penale.<sup>36</sup> Në momentin e caktimit të masës së sigurimit personal gjykata nuk mund të bëjë një analizë të provave, por duhet të respektoje rigorozisht kërkesën e nenit 228 të K.Pr.Penale, sipas të cilit askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal, nëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, ekzistenca e veprës penale me të gjithë elementët e saj si dhe përjashtohen të gjitha rastet e padënueshmërisë.<sup>37</sup> Duhet nënvizuar fakti se provat indirekte në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm duhet të kenë tre karakteristika për t'u konsideruar si të mjaftueshme, së pari, këto indicie të jenë të rëndësishme, së dyti duhet të jenë të sakta dhe së treti, duhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën.

- b. Ekzistenca e vet veprës penale, pra që veprimi ose mosveprimi të përbëjë një vepër penale. Kjo do të thotë që vepra penale duhet të ekzistojë me të katërt elementët e saj, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive, ku mungesa e njërit prej këtyre elementëve do të bënte që veprimi të mos ndiqet penalisht.
- c. Moszbatimi i masave të sigurimit në momentin kur ekzistojnë shkaqet e padënueshmërisë apo shuarjes së veprës penale (formular kjo në mënyrë negative).<sup>38</sup>

---

<sup>34</sup> Shih Vendimi nr.67, datë 16.04.2008, të Gjykatës së Lartë

<sup>35</sup> Shih Vendimi nr.27, datë 13.02.2008, të Gjykatës së Lartë.

<sup>36</sup> Shih Vendimi nr.20, datë 16.13.2007, të Gjykatës së Lartë.

<sup>37</sup> Shih Vendimi nr.112, datë 26.09.2005, të Gjykatës së Lartë.

<sup>38</sup> Shih Vendimi nr.112, datë 26.09.2005, të Gjykatës së Lartë.

Tre kushtet e mësipërme janë kushtet e përgjithshme që gjyqtari duhet të mbajë parasysh në përcaktimin e *fumus commisti delicti* në momentin që atij i drejtohet kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal nga prokurori.

*Periculum libertatis*, në kuadër të nenit 228 pika 3 të K.Pr.Penale, individualizon kriteret e veçanta që konkurrojnë me dyshimin e arsyeshëm bazuar në prova, ekzistencën e veprës penale, mosekzistencën e rasteve të padënueshmërisë apo shuarjes së veprës penale dhe së bashku justifikojnë masën e sigurimit. Secili prej kriterëve në mënyrë autonome është i mjaftueshëm për të legjitimuar marrjen e masës së sigurimit dhe e kundërta nëse mungon njëri prej tyre masat e sigurimit nuk mund të merren. Pra, në prezantimin e këtyre kriterëve mjaftojnë dy terma “alternative” dhe “domosdoshmërie”.

1. Alternative, sepse kriteret ndërmjet tyre janë alternative, pra mjafton ekzistenca e njërit prej tyre për caktimin e masës së sigurimit.
2. Domosdoshmëri, sepse për marrjen e masave të sigurimit duhet të ekzistojë të paktën njëri prej këtyre kriterëve.

Hipotezat e parashikuara nga neni 228 pika 3 a, b, c, janë alternative dhe të domosdoshme, në kuptimin që nëse jemi në kushtet e marrjes nga gjyqtari të masave të sigurimit për shkak të ekzistencës të një nga hipotezat e pikës 3 të nenit 228, ai nuk është i detyruar të tregojë nëse vendimi i tij mbështetet dhe në ekzistencën e dy kriterëve të tjera. Ajo çka kërkohet në të trija situatat është ekzistenca e “rrezikut konkret”. Gjatë seancës për marrjen e masave të sigurimit, gjyqtari është i “rrethuar” nga prezantimi i fakteve të paraqitura nga palët por jo nga vlerësimi i paraqitur prej tyre, për rrjedhojë gjyqtari në vlerësimin dhe arsyetimin e tij mund të dalë jashtë fakteve të paraqitura nga palët dhe mund të vendosë dhe mbështesë vendimin e tij në kriteret dhe në kushte të tjera nga ato të kërkuara nga prokurori apo pala mbrojtëse, gjithmonë nëse jemi përpara kushteve ligjore.

**Kriteri i parë:** Ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen apo vërtetësinë e provave.

**Kriteri i dytë:** Kur i pandehuri është i larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet. Ekzistenca e mungesës së të pandehurit por është ekzistenca e hipotezës që ai mund të largohet bën të domosdoshme marrjen e masave të sigurimit.

**Kriteri i tretë:** Kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime më të rënda apo të të njëjtit lloj me ato për të cilin ai procedohet. Për të tre kriteret do të flas hollësisht më poshtë.

### *3. Parimi i përshtatshmërisë dhe parimi i proporcionalitetit*

Nenet 229 dhe 230 të K.Pr.Penale, përcaktojnë kriteret thelbësore për caktimin e masave të sigurimit, në themel të të cilave qëndrojnë përshtatshmëria dhe proporcionaliteti i masave të sigurimit.

Parimi i përshtatshmërisë ka karakter të përgjithshëm sepse ka të bëjë me përshtatshmërinë e masave të sigurimit për çdo rast konkret. Në bazë të këtij parimi, gjyqtari në momentin e individualizimit se cilën nga masat do të zbatojë, është i detyruar që të mbajë parasysh karakteristikat e çdo mase sigurimi me qëllim që ta bëjë të aplikueshme në rastin konkret, duke marrë parasysh se ndër masat e sigurimit duhet të zgjidhet ajo më pak e rënda për të pandehurin,<sup>39</sup> sipas nenit 229 pika 1 të K.Pr.Penale.

Parimi i proporcionalitetit ka karakter specifik sepse ka të bëjë me rëndësinë e faktit dhe sanksionimin e përgjithshëm. Ky parim kërkon që çdo masë duhet të jetë në proporcion me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Pra, gjyqtari në përcaktimin e masës së përshtatshme për t'u zbatuar duhet të ketë parasysh si gjendjen në të

---

<sup>39</sup> G. Conso, V. Grevi, Compendio di Procedura Penale, Seconda Edizione, Cedam 2003, fq. 373.

cilën ndodhen faktet, si dhe të ketë parasysh masën e dënimit që mund të merret në çdo rast konkret.<sup>40</sup>

Midis të tjerave gjyqtari e ka të ndaluar të marrë një masë sigurimi në momentin kur mund të vendoset pushimi i çështjes apo vendim dënimi. Ndër elementët e rëndësishëm të sanksionuar nga neni 229 pika 2 e K.Pr.Penale, të cilat duhet të merren parasysh nga gjyqtari, janë dhe vazhdimësia e veprës penale, përsëritja e saj si dhe rrethanat lehtësuese apo rënduese të përcaktuara në Kodin Penal. Sipas parimit të proporcionalitetit, praktikisht ai është i zbatueshëm nëse shqyrtohen të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat çojnë në përcaktimin se cila do të jetë masa e dënimit që mund të zbatohet, duke përcaktuar kështu dhe masën e sigurimit.<sup>41</sup> Kur kjo masë kërkohet të vendoset ndaj një të mituri duhet të mbahet parasysh se nuk duhet të ndërpritet procesi edukativ i të miturit dhe se ndaj tij nuk mund të merret masa e sigurimit arrest në burg, përjashtimisht vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së të miturit apo të veprës penale, dhe se asnjëherë ndaj të miturit nuk mund të zbatohet arresti në burg, nëse vepra për të cilën ai dyshohet përbën kundërvajtje penale.

Në rastin D.G vs Irlanda, gjykata e Strasburgut është shprehur në lidhje me nenin 5 paragrafi 1/d, e cila legjitimon privimin e një të mituri nga liria e tij kur nuk ka asnjë akuzë apo dënim penal për ta justifikuar në bazë të nenit 5 paragrafi 1/a ose c. Ky vendim nxjerr në pah përgjegjësinë e shtetit ndaj të miturit, sjellje jonormale e të cilit është e tillë sa autoritetet vendase vlerësojnë se ai nuk mund të lihet i lirë por dhe nuk ka baza për momentin për ta akuzuar apo dënuar për ndonjë vepër penale. Përderisa neni 5 paragrafi 1/d autorizon privimin e lirisë në rrethana kur ajo mund të justifikohet ndryshe, gjykata është e kujdesshme për të siguruar që mbikëqyrja me karakter edukues e cila kërkohet nga ky paragraf të jetë e ofruar.<sup>42</sup>

---

<sup>40</sup> Po aty, fq. 273.

<sup>41</sup> Cass, 01.12.1989, Lacchini, cass.pen, 1990, 127.

<sup>42</sup> L. Bianku, *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Tiranë 2005, fq. 215.

Parimi i proporcionalitetit dhe ai i përshtatshmërisë luan një rol mjaft të rëndësishëm në momentin kur gjykata cakton masën e sigurimit arrest në burg. Arresti në burg duke qenë masa e sigurimit personal më e rëndë, mund të zbatohet nga gjyqtari vetëm kur masat e tjera janë të

papërshtatshme. Referimi në masën e sigurimit arrest në burg kërkon një *extrema ratio*, të tillë që të bëjë në rastin konkret, për shkak të cilësive të vet rasti, kërkesa e masave të sigurimit nuk mund të përmbushet nga asnjë masë tjetër më e lehtë. Përshtatshmëria e çdo mase lidhet me rrezikshmërinë e veprës penale si dhe rrezikshmërinë e personit ndaj të cilit merret kjo masë.

Gjyqtari ka detyrimin për të argumentuar në mënyrë negative, për çdo rast të zbatimit të arrestit në burg. Ajo që ndodh në praktikë është se gjykata në momentin kur vendos zbatimin e vendimit të arrestit në burg nuk arsyeton pse merret kjo masë dhe pse masat e tjera janë të papërshtatshme.<sup>43</sup> Një vendim i arsyetuar u tregon palëve që zëri i tyre është dëgjuar si dhe lejon ndërhyrjen publike të administrimit të drejtësisë.<sup>44</sup> Gjykata e Strasburgut në një sërë rastesh ka deklaruar se arsyetimi i gjykatave vendase do të konsiderohet gjithmonë i papërshtatshëm nëse është abstrakt ose i bazuar në stereotipe.<sup>45</sup> Ajo çka është e rëndësishme është se gjykatat duhet të japin një vendim të arsyetuar në çdo rast të caktimit të një mase sigurimi personal.

Në vendimin nr.68, datë 11.04.2008, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit i tërheq vëmendjen Gjykatës së Apelit Korçë, lidhur me pjesën e arsyetimit të vendimit, ku ndër të tjera arsyeton: “ndaj të pandehurit ekziston një dyshim i arsyeshem, por akuza në ngarkim të tij mund të jetë e diskutueshme”. Në këtë fazë të gjykimit gjykata është e detyruar të vlerësojë vetëm dy elemente, e para nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e një mase sigurimi personal dhe nëse ekzistojnë kriteret e veçanta për caktimin e një mase sigurimi arrest në burg dhe se në asnjë

---

<sup>43</sup> Shih Vendimi nr.30, datë 09.05.2006, të Gjykatës së Lartë.

<sup>44</sup> Analiza e procedimeve të çështjeve penale në Apel, në Republikën e Shqipërisë, OSCE 2007, fq. 57.

<sup>45</sup> Po aty.

dispozitë procedurale nuk është përdorur shprehja *akuzë e diskutueshme*, pasi në këtë fazë nuk bëhet fjalë për të deklaruar personin fajtor për kryerjen e veprës penale, por për dyshime të arsyeshme të bazuara në prova që personi mund të ketë kryer veprën penale.

Kur personi ndaj të cilit merret masa e sigurimit personal është një grua shtatzënë ose me fëmijë në gjë, arresti në burg cilësohet si i papërshtatshëm për t'u përdorur. Ndalimi për të disponuar me vendim për zbatimin e arrestit në burg në këtë rast, përveç rastit kur kërkesat për zbatimin e arrestit në burg janë të larta, vjen si rezultat i vlerësimit të gjendjes së saj fizike. Nëse kjo gjendje nuk është e dukshme apo e specifikuar në mënyrë procedurale, e pandehura në çdo rast mund të kërkojë revokimin e arrestit në burg dhe zëvendësimin e tij me një masë tjetër më të lehtë, gjithmonë kur kjo vërtetohet nga një raport mjekësor.

Një person i cili ndodhet në një gjendje shëndetësore të rëndë, gjendje kjo e cila vlerësohet rast pas rasti, mund të përfitojë nga përjashtimi i shprehur më lartë. Nëse personi është në trajtim mjekësor për një sëmundje, kjo nuk mund të konsiderohet *apriori* si rrethanë e cila pengon marrjen e arrestit në burg. Kjo gjendje shëndetësore në çdo rast duhet certifikuar në rrugë procedural, nga ana e një ekspertimi të caktuar shëndetësor, i cili duhet të konkludohet në terma të qarta në lidhje me vënien në rrezik të shëndetit nga zbatimi i masës së sigurimit personal.<sup>46</sup> Në vendimin nr.140, datë 21.12.2005, Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj ka cilësuar si të papërshtatshëm arsyetimin e gjykatës së apelit, e cila në pjesën arsyetuese të saj shprehet se “pretendimet e ngritura se personi vuan nga zemra do të sqarohen gjatë hetimeve të mëtejshme të çështjes”.

Ky arsyetim e bën të cenueshëm vet vendimin e dhënë nga gjykata, pasi kërkesa e të pandehurit nuk lidhet me gjykimin e çështjes në themel por me masën e sigurimit personal, në

---

<sup>46</sup> Shih Vendimin nr.2, datë 11.01.2008, të Gjykatës së Lartë.

caktimin e të cilës rëndësi të veçantë procedural merr edhe gjendja shëndetësore e të pandehurit, bazuar në nenin 230 të K.Pr.Penale.<sup>47</sup>

Personat mbi 70 vjeç përfitojnë nga përjashtimi i zbatimit të arrestit në burg, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre personave e cila është mjaft e ulët, e lidhur kjo gjithmonë me mundësitë fizike apo psikike të këtyre personave.

Nga përjashtimi i folur më sipër, përfitojnë dhe toksikomanët dhe të alkoolizuarit ndaj të cilëve zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm, kjo përbën një diskriminim pozitiv.

Në momentin kur jemi përpara rrethanave dhe shkaqeve të një rëndësie të veçantë dhe për krime që dënohen jo më pak se dhjetë vjet në maksimum, edhe ndaj personave të sipërpërmendur mund të zbatohet arresti në burg. Përjashtimi nga përjashtimi, që u bëhet subjekteve të sipërpërmendura nga arresti në burg. Lidhet me shkaqe të një rëndësie të veçantë rast pas rasti.

Vlerësimi i asaj që do të quajmë “shkaqe të një rëndësie të veçantë”, që legjitimon aplikimin e arrestit në burg, lidhet kryesisht me vepra penale të një rrezikshmërie të lartë. Shkaku i një rëndësie të veçantë është superior ndaj gjendjes shëndetësore që mund të gëzojë personi. Në vlerësimin e *shkaqeve të një rëndësie të veçantë* duhet bërë dallimi midis personit i cili ka kryer veprën penale para përkeqësimit të gjendjes shëndetësore dhe personit i cili veprën penale e ka kryer më pas, gjithmonë kjo për të vlerësuar rrezikun konkret të tij, i cili për shkak të gjendjes së tij shëndetësore mund të kryejë një vepër penale tjetër të të njëjtit lloj apo më të rëndë.<sup>48</sup>

Në kuadër të parimit të përshtatshmërisë, në termat e përgjithshme sanksionohet fakti se në rast shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i masave të sigurimit, nga personi ndaj të

---

<sup>47</sup> Cass 23.04.1992, Sicilio, cass.pen, 190376.

<sup>48</sup> Cass, 23.02.1991, cass.pen, 430.

cilit janë marrë këto masa gjyqtari mund të vendosë zëvendësimin masës së sigurimit ose bashkimin e saj me një tjetër më të rëndë. Kjo e drejtë që ka gjyqtari lidhet gjithmonë me faktin se ndaj një personi duhet të zbatohet masa e sigurimit më e përshtatshme. Ajo që duhet thënë është se jo çdo shkelje e kryer nga i pandehuri mund të përbëjë motiv për zëvendësimin apo bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, por vetëm ato shkelje të cilat për shkak të

karakteristikave të tyre objektive ose subjektive, janë të tilla që konsiderojnë jo të përshtatshme masën e mëparshme, për shkak të ndryshimit të situatës. Gjithmonë gjyqtari duhet të marrë parasysh motivet, rëndësinë dhe rrethanat e faktit. Ai gjithashtu mund të zëvendësojë ose të bashkojë një masë ndaluese me një masë shtrënguese. Edhe në këtë rast vepron parimi i kërkesës së prokurorit, një gjë e tillë do të thotë se kjo kërkesë nuk bëhet vetëm në momentin e caktimit të masës së sigurimit, por dhe në këtë rast. Pra, është legjitime zbatimi nga ana e gjyqtarit kryesisht i një mase më të rëndë, në mungesë të kërkesës së paraqitur nga prokurori edhe në rastin e shkeljes së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i masës së sigurimit.

#### 4. Parimi i *Ne bis in idem*

Në lidhje me masën e sigurimit personal duhet thënë se në çdo kohë, gjendje dhe status të procedimit ato janë të udhëhequra nga parimi i *ne bis in idem cautelare*. Në bazë të këtij parimi nuk mund të adoptohet përsëri e njëjta masë sigurimi, pra e të njëjtit lloj<sup>49</sup> për të njëjtin fakt. Në momentin kur ndryshon në mënyrë radikale pozicioni procedural i të pandehurit, në ngarkim të të cilit është vendosur gjykimi, nëse revokimi ose anulimi i masës së sigurimit ka pasur shkak në mënyrë ekskluzive mungesën e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, masa e re shtrënguese do të gjejë zbatim si rezultat i ndryshimit të pozicionit procedural.<sup>50</sup> Zbatimi ndaj të pandehurit i një mase tjetër shtrënguese, për të njëjtin fakt është i lejueshëm vetëm nëse pas caktimit të një mase të sigurimit personal sipas dispozitave konkrete të K.Pr.Penale, ekzistojnë

<sup>49</sup> Cass, 26.05.1992, Chiarabelle, cass.pen, 191542.

<sup>50</sup> Cass, 14.09.1990. Osareme, cass.pen, 732.



kërkesa të reja për masën e sigurimit si rezultat i zhvillimit të hetimit dhe gjithmonë duke mbajtur parasysh kohëzgjatjen e masave të sigurimit po sipas dispozitave të këtij kodi. Ndalimi sipas *ne bis in idem* është konform faktit se është tërësisht i lejueshëm një gjykim i dytë, ndërkohë që asnjë normë ligjore nuk ndalon gjyqtarin për caktimin mbi të njëjtin objekt,

në ngarkim të të njëjtit subjekt një masë shtrënguese të dytë, në rastin kur është konsideruar nul vlefshmëria e ndalimit dhe aplikimit të masave të sigurimit, kjo nuk do të thotë se është i pavlefshëm vendimi me anë të së cilit është caktuar një masë sigurimi, duke qenë se bëhet fjalë për një veprim të pavarur nga ai i shpallur nul.<sup>51</sup> Parimi i *ne bis in idem cautelare* vepron vetëm kur gjyqtari duhet të shqyrtojë në seancë po ato kushte të masave të sigurimit të cilat janë vlerësuar si të paqena, të pamjaftueshme ose të pavlefshme dhe jo kur joefektiviteti i masës së origjinës vjen si pasojë e parregullsive, p.sh. gjatë procedurës së ankimit, të cilat nuk duhet të përbëjnë objekt vlerësimi të një mase të re sigurimi, e cila duhet vetëm të përqendrohet në faktin nëse ekzistojnë apo jo kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit.<sup>52</sup> Konsiderohet ligjore aplikimi i masës së sigurimit arrest në burg, për të njëjtin fakt, objekt me një vendim shtrëngues të mëparshëm ndaj lirisë personale, i bërë jo efikas për shkak se gjykata në të cilën është ankuar vendimi, nuk është shprehur brenda afatit ligjor.

Në rastin De Eilde, Ooms dhe Versyp vs. Belgium, datë 18.06.1971, Gjykata e Strasburgut, është shprehur se, paraqitja e personit në polici me qëllim që ta çojë në një institucion mund të nxitet nga vuajtja ose skamja kalimtare. Kjo nuk do të thotë që personi ndodhet në një gjendje vagabondizmi. Në vazhdim dhe mbi të gjitha, e drejta për liri ka një rëndësi shumë të madhe në shoqëri demokratike, dhe nuk mundet që një person ta humbasë atë

---

<sup>51</sup> Cass, 02.04.1992, Priolo, cass.pen, 191346.

<sup>52</sup> Cass, 08.11.1991, Pezzella, cass.pen, 176, 1992, 107.

vetëm për shkak të faktit se është paraqitur vetë për tu burgosur. Një heqje lirie mendon gjykata mund ta shkelë nenin 5 të K.E.D.Nj, po njësoj edhe kur personi i interesuar e pranon atë.<sup>53</sup>

## KREU II

### MASAT E SIGURIMIT PERSONAL

#### 2.1. Tipologjia e masave të sigurimit personal

Në Kodin e Procedurës Penale, masat e sigurimit ndahen në dy grupe kryesore: *masa të sigurimit personal dhe masa të sigurimit pasuror*.

#### 2.2. Masat e sigurimit personal

Masat e sigurimit personal drejtohen ndaj personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, duke e privuar nga disa të drejta ose duke e ngarkuar atë me detyrime të veçanta.

Neni 227 “*Ndarja e masave të sigurimit personal*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese.

Gjykata e Lartë, nëpërmjet një vendimi unifikues është shprehur se:<sup>54</sup> Dallimi midis masave shtrënguese dhe ndaluese konsiston në faktin se, ndryshe nga masat shtrënguese, ato ndalueset mund tëzbatohen jo për të gjitha veprat penale, por vetëm kur procedohet për vepra

---

<sup>53</sup> L.Bianku, Jurisprudencë e Gjykatës së Strasburgut, Tiranë 2005, fq. 222

<sup>54</sup> Shih Vendimi nr.3, datë 27.9.2002 të Gjykatës së Lartë.

penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë, në maksimum, se një vit, si dhe në faktin që, qëllimi i vetëm i marrjes së këtyre masave është parandalues.

Neni 228 “*Kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit*”, i Kodit të Procedurës Penale: Askush nuk mund t’i nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

Nëpërmjet analizës dhe interpretimit të drejtë të kësaj dispozite, posaçërisht të shprehjes “*dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova*”, në harmoni me institutet e tjera procedurale, mund të bëhet dallimi dhe të arrihet në përfundime të drejta, jo vetëm lidhur me kushtet paraprake për caktimin e masës së sigurimit por edhe se përse kjo masë mund të caktohet edhe në fazën e gjyqimit të çështjes penale. Për rrjedhojë mund të kuptohet dhe të dallohet gjykimi mbi dyshimin e arsyeshëm bazuar në prova për caktimin e masës së sigurimit nga gjykimi i provës për efekt të formimit të bindjes mbi të vërtetën, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, në dhënien e vendimit të pushimit, të pafajësisë apo dënimit të të pandehurit.

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas këtij paragrafi, nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, pra për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale.

Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit a të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij. Pra mos tëndodhemi para një procedure a priori.

Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë e zaurues, domosdoshmërisht një drejtimësh, pra në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjyqimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara, vijnë në përfundimin unifikues se<sup>55</sup>“dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të

konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij.

*Dispozita e pikës 1 të nenit 228 tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë vepër penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij”.*

Nga ana tjetër, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim të të gjykuarit<sup>56</sup> është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të gjykuarit.<sup>57</sup> Procesi i vlerësimit dhe gjykimit për vendosjen ose jo të masës së sigurimit sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara nga ligji,

<sup>55</sup> Shih Vendimi nr.7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>56</sup> “fumus delicti”.

<sup>57</sup> “periculum libertatis”.

mbështetet dhe synon arritjen e ekuilibrit të nevojshëm, nga njëra anë, për respektimin dhe garantimin e rendit publik e të interesit publik për dhënien e drejtësisë dhe nga ana tjetër, me të drejtat dhe interesat ligjore të individit subjekt i procedimit, të dyja të parashikuara nga Kushtetuta.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se dyshimi i arsyeshëm përbën standardin kryesor për heqjen e lirisë. Në vendimin e dhënë për çështjen *“Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar”*, kjo gjykatë e ka konsideruar shkelje të standardit faktin që *“Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar kishte arrestuar dhe ndaluar aplikuesit si terroristë të dyshuar të IRA-s, por nuk arriti t’u jap gjykatave vendase fakte dhe të dhëna të përshtatshme për të mbështetur pretendimin për dyshimin e arsyeshëm se ata kishin kryer një vepër të jashtëligjshme”*.

Në çështjen *“Stogmuller kundër Austrisë”*, të vitit 1969, Gjykata Evropiane ka vënë në dukje se në qoftë se kriteri *“dyshimi i arsyeshëm”* pushon së ekzistuari, vazhdimësia e ndalimit bëhet e paligjshme.

Në çështjen *“El Masri kundër FYROM”*, të vitit 2013, Gjykata Evropiane vëren që në fillim rëndësinë thelbësore të garancive që ofron neni 5 për të siguruar të drejtën e individëve në një demokraci për të qenë të lirë nga ndalimet arbitrare nga ana e autoriteteve. Për këtë arsye, Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur nëpërmjet jurisprudencës së saj se çdo heqje e lirisë jo vetëm që duhet kryer në përputhje me rregullat materiale dhe procedurale të së drejtës kombëtare, por në mënyrë të barabartë duhet të jetë në përputhje me qëllimin kryesor të nenit 5, pikërisht mbrojtjen e individit nga arbitrariteti. Kjo këmbëngulje për mbrojtjen e individit kundër çdo abuzimi të pushtetit ilustron nga fakti se, neni 5/1 paraqet në një listë shteruese rrethanat në të cilat individit mund t’i hiqet ligjërisht liria e tij, duke theksuar se, këtyre

rrethanave duhet t'u jepet një interpretim i ngushtë që mban parasysht faktin se, ato përbëjnë përjashtime të garancisë më themelore të lirisë individuale.<sup>58</sup>

Gjithashtu duhet të theksohet se autorët e Konventës përforcuan mbrojtjen e individit kundër heqjes arbitrare të lirisë duke garantuar një korpus të të drejtave thelbësore të cilat janë të destinuara për të minimizuar rreziqet e arbitraritetit, duke lejuar që akti i heqjes së lirisë t'i

nënshtrohet shqyrtimit të pavarur gjyqësor dhe duke siguruar përgjegjësinë e autoriteteve për atë akt. Kërkesat e nenit 5/3 dhe 4 me theksin që i vënë shpejtësisë dhe mbikëqyrjes gjyqësore marrin rëndësi të veçantë në këtë kontekst. Ndërhyrja e menjëhershme gjyqësore mund të çojë në zbulimin dhe parandalimin e masave kërcënuese për jetën apo keqtrajttime serioze, që shkelin garancitë themelore të parashikuara në nenet 2 dhe 3 të Konventës.<sup>59</sup> Ajo çfarë është në rrezik është mbrojtja e lirisë fizike të individëve, si dhe siguria e tyre personale në një kontekst i cili, në mungesë të garancive, mund të rezultojë në shkatërrimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe i vendos të burgosurit përtej mundësive të formave më elementare të mbrojtjes ligjore.

*Edhe pse hetimi i veprave terroriste padyshim që i vendos autoritetet përballë disa problemeve të veçanta, kjo nuk do të thotë që autoritetet kanë "carte blanche", sipas nenit 5, për të arrestuar të dyshuarit dhe në mbajtjen e tyre të ndaluar nën kontrollin policor, të lirë nga kontrolli efektiv nga gjykatat e brendshme, dhe në instancë të fundit, nga institucionet mbikëqyrëse të Konventës, sa herë që ata vlerësojnë se kanë të bëjnë me një vepër terroriste.<sup>60</sup>*

Gjykata thekson në lidhje me këtë se, ndalimi i panjohur i një individit është një mohim i plotë i këtyre garancive dhe një ndër shkeljet më të rënda të nenit 5. Duke marrë kontrollin mbi një individ, autoritetet kanë për detyrë të japin llogari për vendndodhjen e tij apo të saj. Për këtë arsye, neni 5 duhet të shihet se, kërkon nga autoritetet të marrin masa efektive për të mbrojtur

---

<sup>58</sup> Shih "Quinn k. Francës".

<sup>59</sup> Shih "Aksoy k. Turqisë".

<sup>60</sup> Shih "Dikme k. Turqisë".

kundër rrezikut të zhdukjes dhe të kryejnë një hetim të menjëhershëm efektive lidhur me një pretendim të diskutueshëm se një person është ndaluar dhe nuk është parë më që prej asaj kohe.<sup>61</sup>

1. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes sëveprës penale.
2. Masat e sigurimit personal vendosen:

Paraprakisht, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se kushtet dhe kriteret e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë të të gjykuarit.

- a. Kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë provës:

Nga interpretimi i drejtë i kuptimit që duhet t'i jepet termit “rrezik” në nenin 228 në tërësi, pra edhe për rastin e kësaj shkronje “a” të këtij neni, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues *senë çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit duhet të motivohen dhe të argumentojnë (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të “rrezikut”, pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit) vënia në rrezik e procesit të së provuarit nga ana e të pandehurit.*

---

<sup>61</sup> Shih “Kurt k. Turqisë”.

*Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, në dinamikë, si gjatë fazës së hetimit paraparak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit që e sjellin atë gjykatë në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendje, e cila pengon, ngadalëson apo devijon në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal përkatës, në kuadër të garantimit të procesit të dhënies së drejtësisë në tërësi të parashikuar nga Kushtetuta e që pikërisht justifikon parashikimin në ligj të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit.*

Vlerësimi i rrethanave mbi ekzistencën ose jo të rrezikuar për “*helmimin*” e provave, bëhet rast pas rasti. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohet verifikimi që i bën gjykata edhe rrethanës mbi kohën që ka kaluar nga çasti i vënies në dijëni të të pandehurit për procedimin penal në ngarkim të tij, në lidhje me rrethanën nëse ka kryer apo mund të kryejë ndonjë veprim a sjellje që “*rrezikon*” procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provës.

Në këtë kontekst, në parim, edhe e drejta e heshtjes së të pandehurit, si një strategji mbrojtje e tij, nuk përbën në vetvete “*rrezik*” që mund të shërbejë si motiv për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe kjo rrethanë mund të vlerësohet në harmoni dhe në lidhje me sjelljet e tjera të tij ndaj veprës që ka kryer dhe procedimit penal të filluar, të cilat mund të çojnë gjykatën në bindjen se ekziston dyshim i bazuar në prova se i pandehuri nëse lihet i lirë do të helmojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës, nga ana e të gjykuarit.

b. Kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet:

Në lidhje me këtë kusht për caktimin e masës së sigurimit, ndërkohë që “*ikja*”, “*largimi*” i të pandehurit është çështje fakti, ka vend të evidentohet që pranimi nga gjykata i ekzistencës së mundësisë, pra “*rrezikuttë largimit*”, duhet të jetë më i motivuar, i mbështetur në elementë konkretë, në fakte e rrethana objektive.



Interpretimi i drejtë i dispozitës së shkronjës “b” të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale i sjell Kolegjet e Bashkuara në përfundimin unifikues se “rreziku i largimit”, krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj. Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja “b” nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit.

Për efekt të motivimit të caktimit të masës së sigurimit, një nga rastet që përbën element objektiv për të sjellë gjykatën në përfundime mbi largimin dhe rrezikun e largimit, është edhe gjendja e ikjes pa lënë gjurmë<sup>62</sup> të pandehurit. Kjo gjendje, në vetvete, mishëron logjikisht e juridikisht prirjen e të pandehurit për të shkelur dhe mos zbatuar masat e sigurimit,<sup>63</sup> qenien e tij në mënyrë permanente në pozitën e mosbindjes së paligjshme përballë ligjit, prirjen për t’iu shmangur hetimit dhe gjykimin, si dhe vuajtjes së dënimit. Kjo gjendje rreziku normalisht mbetet e tillë edhe nëse i pandehuri i deklaruar i ikur, më pas, tregon disponibilitetin e tij që të paraqitet apo kur paraqitet vullnetarisht para organeve të procedimit.

Një nga arsytet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimin në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet por t’i nënshtrohet ekzekutimit, pra vuajtjes së dënimit në momentin kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.

<sup>62</sup> “kur ndodhemi para rastit të fshehjes të pandehurit”.

<sup>63</sup> “Këtu përfshihet dhe arresti në burg”.

Masa e sigurimit e vendosur në çdo fazë të procedimit nuk ka lidhje as me të drejtën e të pandehurit që të mos paraqitet personalisht në seancë, apo që të largohet prej saj sipas vullnetit të tij të lirë. Nevojat e sigurimit vendosen për qëllime të tjera, ato nuk kanë asnjë lidhje dhe ndikim në lejimin apo kufizimin e së drejtës së të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet ndaj tij. Të pandehurit, me ose pa masë sigurimi, i garantohet e drejta për të marrë pjesë në gjykimin e akuzës kundër tij.

Nëse çmon të mos marrë pjesë në seancë gjyqësore, ai është i lirë të mos paraqitet apo të largohet nga salla, por nëse është me masë sigurimi arrest në shtëpi apo në burg, i pandehuri detyrimisht qëndron apo kthehet në vendin e izolimit të tij.

Prandaj, në këtë kuptim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se duhet të theksohet që, largim sipas kuptimit të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 228 përbën edhe rrethana kur i pandehuri është larguar, transferuar e qëndron jashtë shtetit dhe me një sjellje e tillë duket se synon që ai t’i shmanget ushtrimit të juridiksionit penal shqiptar.

Ky përfundim vlen edhe nëse pretendohet në gjykim se adresa e të pandehurit në shtetin tjetër është e njohur, përderisa largimi si sjellje nuk nënkupton vetvetiu edhe fshehjen e identitetit apo të adresës së qëndrimit nga ana e të pandehurit. Ky përfundim vlen gjithashtu edhe në rastin kur transferimi e largimi jashtë shtetit kanë ndodhur përpara se të fillohej procedimi penal ndaj këtij subjekti. Sikurse vlen edhe në rastin kur largimi i personit nga vendbanimi i njohur në drejtim të paditur brenda vendit apo jashtë vendit ka ndodhur përpara fillimit të procedimit penal. Sjellje të tilla, në thelb, përbëjnë shmangie të autorit të veprës nga ushtrimi i juridiksionit penal shqiptar.

Gjithashtu, për efekt të disponimit për caktimin e masës së sigurimit, edhe rrethanat e fshehjes apo kamuflimit të identitetit, tërheqja e fshehja e pasurive dhe sasive të

konsiderueshme monetare apo transferimi i tyre jashtë vendit, janë elementë objektivë konkrete, të cilët, në lidhje edhe me rrethana të tjera, mund të krijojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, pra bindjen se i pandehuri ka rrezik të largohet.

Së fundi, vlen të evidentohet situata kur është ushtruar apo përfituar nga i pandehuri e drejta e azilit në një shtet tjetër, si një e drejtë e lirisë së shprehjes (politike) në një shoqëri demokratike.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se e drejta e azilit lidhet dhe mbetet e lidhur vetëm në marrëdhëniet që krijohen mes refugjatit dhe shtetit të huaj pritës. Por kjo gjendje, këto

marrëdhënie, nuk ndikojnë aspak në marrëdhëniet dhe çështjet e mëparshme apo në vijim që ekzistojnë mes këtij subjekti dhe shtetit të tij të origjinës, pra nuk pengojnë ushtrimin ligjor të autoritetit të shtetit të origjinës për ta hetuar, gjykuar dhe eventualisht dënuar atë.

Azilanti, për shtetin e origjinës, mbetet një i pandehur në gjendjen e personit të ikur, të larguar pra jo në atë të rrezikut për t'u larguar, përderisa ai i fshihet drejtësisë së vendit të origjinës, përfshirë edhe gjykimin e zbatimit ndaj tij të masave të sigurimit, mes të tjerave, të justifikueshme pikërisht edhe për shkak të largimit të tij jashtë shtetit. Kjo gjendje është e kuptueshme se e tejkalon edhe konceptin, kriterin e “*rrezikut të largimit*”, edhe kjo në vetvete e mjaftueshme për të zbatuar masën e sigurimit që synon të evitojë që i pandehuri dhe, më pas, eventualisht, i dënuari t'i shmanget gjykimin dhe vuajtjes së dënimit përfundimtar.

- c. Kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atëpër të cilin procedohet.

Përmbajtja e kësaj dispozite, lidhet me nevojën për caktimin e masës së sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit për garantimin e rendit e të sigurisë publike, paprekshmërinë e jetës, shëndetit, pronës dhe interesave e të drejtave të tjera të ligjshme nga kryerja e veprave të tjera penale nga ana e të pandehurit. Në këtë aspekt, për të legjitimuar kufizimin e lirisë së të pandehurit, pra caktimin e masës së sigurimit, mes të tjerave,

objekti i gjykimit është verifikimi i rrethanave konkrete të faktit të cilat i shërbejnë gjykatës për të vlerësuar e konkluduar mbi rrezikshmërinë e autorit dhe, nga ana tjetër, për të përcaktuar veprat penale që ka rrezik të kryhen prej tij.

Në këtë kuptim, për pranimin e ekzistencës së nevojës së sigurimit, të rrezikut konkret për komunitetin, cenimin e rendit dhe të sigurisë publike, të cilat justifikojnë caktimin e masës së sigurimit sipas kësaj dispozite, objekt i hetimit gjyqësor duhet të jetë vlerësimi konkret i rrethanave të faktit, duke nxjerrë nga sjellja në tërësi e të gjykuarit elemente konkrete të vlefshme për të bazuar dhënien e vendimit.

Sikurse për rastet e rrezikut për “eliminimin” e provave dhe atij të ikjes, edhe në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, *“nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të së pandehurit, nëse ka precedentë penale, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij”*.

Bazuar në vlerësimin e provave mbi ekzistencën e elementeve konkrete të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të së gjykuarit, jo domosdoshmërisht kumulative, gjykata nxjerr përfundimin nëse ekziston dyshim i arsyeshëm mbi rrezikshmërinë e tij dhe nevojën për të garantuar paprekshmërinë e komunitetit, nëse ekziston mundësia reale që i gjykuari në të ardhmen, duke qenë në gjendje të lirë, mund të kryejë vepra penale të rënda apo të së njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar.

*“Krimet e rënda”* në kuptim të shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale nuk përfshijnë vetëm ato për të cilat ka kompetencën Gjykata për Krime të

Rënda, por edhe vepra të tjera penale të rënda, të cilat, për vetë rrezikshmërinë dhe pasojat e tyre, janë pranuar si të tilla në praktikën tonë gjyqësore edhe para krijimit të këtyre gjykatave.

Neni 229 “Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Në caktimin e masës së sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.
2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.
3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprës penale prej tij dhe, nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilat tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut, së paku sipas njërit prej rasteve të nenit 228.

Si në rastin kur masa e sigurimit caktohet për herë të parë, ashtu edhe kur shqyrtohet zëvendësimi i masës ekzistuese, gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme. Në çdo rast mbetet detyrimi i

gjykatës që, fillimisht, të argumentojë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova në ngarkim të të gjykuarit për kryerjen nga ana e tij të veprës penale.

Prandaj, edhe në rastin kur vendos caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, gjykata nuk ka detyrim të analizojë në hollësi përse llojet e masave të tjera nuk janë të përshtatshme në çështjen në gjykim. Bazuar në elementet objektive mbi natyrën dhe llojin e veprës penale, mjetet dhe mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e shkaktuara, si dhe në elementet subjektive të lidhura me personalitetin e të gjykuarit dhe gjendjen e rrezikut, gjykata argumenton se masa e vetme e përshtatshme ndaj të gjykuarit në raport me llojin dhe shkallën e rrezikut është ajo e arrestit në burg.

Pika 3 e këtij neni paraqet një rëndësi të veçantë pasi ka të bëjë më të miturit të cilët ligji u njeh të drejtën për tu trajtuar në mënyrë të ndryshme nga të rriturit dhe kjo si pasojë e nevojës së tyre për një trajtim të diferencuar. Në momentin që gjykata arsyeton se masa e vetme e duhur për një të mitur është arresti në burg, duhet ta vendosi atë të shoqëruar me mosndërprerjen e procesit edukativ të të miturit. Vetëm në këtë mënyrë masa do të realizojë qëllimin e vendosjes së saj.

Vlerësoj, se në pikën 3 kemi të bëjmë me një mangësi ligjore pasi ky nen duhej të përfshinte përveç të miturve dhe studentët. Ndërprerja e procesit edukativ nuk do të sillte asnjë të mirë në rehabilitimin e studentit pas kryerjes së një veprë penale të caktuar, përveç se do kishte ndikim shumë negativ në psikologjinë e tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, është shprehur:<sup>64</sup> *“Kolegji penal vlerëson se në caktimin si masësigurimi “arrest në burg”, nuk janë marrë parasysh kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit dhe rrethanat konkrete të çështjes. Në caktimin e llojit të masës së sigurimit, në zbatim të parashikimit ligjor të bërë nga ligjvënësi si më sipër (...mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal...), do të mbahet parasysh se personi nën hetim Ermonela Hekuri (Dyrnjaja) nuk është përsëritëse, ky veprim është një veprim i shkëputur i sjelljes së saj. Gjykatat*

<sup>64</sup> Shih Vendimin datë 30.05.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

*nuk kanë bërë një analizë të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, por janë mjaftuar me citimin e rrezikshmërisë së veprës të kryer në bashkëpunim dhe përhapjen e saj. Nivështrim të provave të mbledhura nga organi i akuzës, ky kolegji, pa dashur të hyjë në analizën e tyre në këtë fazë të hetimeve paraprake, në rastin konkret parasysht disa kriteret për ndryshimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim, si: Fakti se lënia e lirë e personit nën hetim nuk rrezikon marrjen e provave të reja lidhur me provueshmërinë e elementëve të veprës penale për të cilat organi i akuzës po heton. Gjithashtu nivështrim të neneve 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, masa e sigurimit “arrest në burg” e dhënë*

*nga gjykata është papërshtatshme pasi nuk i përgjigjet rrezikshmërisë së personit nën hetim Ermonela Dyrnjaja, e cila është e pa dënuar, pa precedent të mëparshëm penale dhe në 16 vjet punë që ka pranë tij institucioni në të njëjtën detyrë dhe ngjarje të tilla nuk ka pasur. Fakti që ka dy fëmijë më të cilëve i mitur, fakti që bashkëshorti është invalid dhe trajtohet me pagesë invaliditeti pune; fakti që vetë e dyshuara në ambientet e paraburgimit ka shfaqur probleme shëndetësore dhe i është rekomanduar që të shtrihet. Dhe së fundi, nuk vërtetohet ekzistenca e rrethanave në raport me veprën penale dhe autorin e dyshuar të saj”.*

Neni 230 “Kriteret veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Arresti në burg mund të vendoset kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit. Natyrisht, në vlerësimin e këtij kriteri mund të ketë dhe shfaqje të subjektivizmit për shkak të mbivlerësimit apo të moskuptimit të aspekteve të veçanta të çështjes, prandaj edhe kujdesi duhet të jetë i veçantë, sidomos nga gjykatat që shqyrtojnë ankimet kundër masës së dhënë.
2. Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë në gjë, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të

alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion tëposaçëm. Në këtë dispozitë na del karakteri human që e karakterizon ligjin penal në disa raste. Kuptohet që përcaktimi i shtatzënisë, sëmundjes së rëndë apo i moshës duhet të vërtetohen me dokumente apo ekspertime dhe të arsyetohen në vendimin e dhënë. Po kështu, në rastet kur këta faktorë nuk merren parasysh, duhet të tregohen shkaqet që e bëjnë të domosdoshëm arrestin, si dhe sanksioni i dispozitës që parashikon veprën penale që i ngarkohet të pandehurit.

3. Nërastet e parashikuara në pikën 2 arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.

Në rastin e procedimeve penale për kryerjen e krimeve të rënda apo që kanë sjellë pasoja të rënda, për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë së autorit të tyre sipas nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Masa e sigurimit arrest në burg e kërkuar nga prokurori ndaj të gjykuarit mund të çmohet nga gjykata si e papërshtatshme, vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg.

Tëmiturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale. Për këtëndalim nuk parashikohet asnjë përjashtim, prandaj çdo shkelje e tillë sjell vetvetiu pavlefshmërinë masës dhe për rrjedhojë edhe përgjegjësinë, si të atij që e ka kërkuar, ashtu edhe të atij që e ka caktuar. Po kështu, në bazë të nenit 225, pika 3, kur i arrestuari nëflagrancë ose i ndaluar është i mitur, prokurori mund të urdhërojë qëai të mbahet në ruajtje nëbanesën e tij ose nënjë vend tjetër të ruajtur.

Neni 231 “Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal”, i Kodit të Procedurës Penale:



1. Në rast shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese.

Në nenin 232 të Kodit të Procedurës Penale, janë përcaktuar llojet e masave shtrënguese. Ato janë:

- a) ndalimi i daljes jashtë shtetit;
- b) detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore;
- c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar;
- d) garancia pasurore;
- e) arresti në shtëpi;
- f) arresti në burg;
- g) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.

Disa nga masat e sigurimit personal kanë si qëllim të kufizojnë të drejtën e lëvizjes së lirë brenda dhe jashtë shtetit. Të tilla janë: ndalimi i daljes jashtë shtetit, detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore dhe ndalimi e detyrimi për të qëndruar në një vend të caktuar.

Si duhet ta interpretojmë këtë renditje të masave shtrënguese? Si një renditje kronologjike apo thjesht si një renditje rastësore?

Në sistemin e drejtësisë në Shqipëri është bërë e “modës” dhënia nga gjykata si masë sigurimi vetëm masën e sigurimit arrest me burg. Nga një anketim i bërë në dhomat e paraburgimit në qytetin e Vlorës, më datë 11.2014, ku secilit prej të anketuarve (gjithsej 10) iu parashtruan disa pyetje të tilla si arsyeja dhe rruga e marrjes së masës së sigurimit në përputhje apo jo me kushtet specifike personale të gjithsecilit prej tyre.

Qëllimi i këtij anketimi është për të treguar se kjo praktikë e ndjekur nga gjykatat në Shqipëri është e gabuar dhe rrugën drejt përmirësimit të saj. Në mënyrë të tillë që masa e sigurimit të plotësojë qëllimin e tij që është rehabilitimi i personit gjithashtu mos të rëndojë në aspekte të tjera jetësore atë dhe personat e tjerë të varur prej tij.

Nga ky anketim rezultoi se për asnjë të burgosur nuk ishte diskutuar rreth masës më të përshtatshme për të dhe si do ndikonte në jetën e tij dhe të personave të varur prej tij (të gjithë të anketuarit ishin kryefamiljar ose i vetmi burim të ardhurash për familjen).

Pa përjashtim të gjithë si të sinkronizuar kanë përdorur të njëjtën fjali “*masa e sigurimit ka ndikuar në shkatërrimin ekonomik të familjes sime, sepse jam i vetmi që punoj në familje*”,

ndonjëri prej tyre kishte situatë akoma më rënduese si për shembull praninë e një fëmije më sëmundje mendore në shtëpi.

Një dukuri që spikatet është shkak i vendosjes së masës së sigurimit jo i rëndë, çka e bën vendosjen e kësaj mase sigurimi të papërshtatshme në lidhje me situatën që e ka shkaktuar atë. Arsyet e vendosjes së masës së sigurimit arrest me burg ishin: vjedhje e energjisë elektrike, armëmbajtje pa leje në banesë, mbajtja e armëve të ftohta dhe shkelja e rregullores së qarkullimit rrugor. Ku shumë mirë në këto raste do të hynin në lojë llojet e tjera të masave shtrënguese.

Për një funksionim të drejtë të procesit gjyqësor, vlerësoj se gjykata duhet të marrë në konsideratë kushtet e personit ndaj të cilit merret një masë shtrënguese si edhe duhet të analizojë me kujdes përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkakun e marrjes së saj. Asgjë në procesin gjyqësor dhe në atë që quhet drejtësi nuk i lihet rastësisë. Logjika është ajo që duhet të na drejtojë edhe në ato momente kur kërkojmë gjithçka të bëjmë në këdo anë të trekëndëshit qofshim. Kjo është rruga drejt arritjes së një vendimi të drejtë. Një vendim i drejtë nuk është atëherë kur jepet masa më e rëndë përkundrazi pasojat mund të jenë të kundërtat e qëllimit të vendosjes së masës. Ligji mundëson masa shtrënguese të ndryshme për shkaqe të ndryshme dhe këto duhen shfrytëzuar më së miri nga ana e gjykatës.

Jam i bindur se, renditja e masave shtrënguese në nenin 232 nuk është e rastësishme por me një logjikë për ti shërbyer vendosjes së një vendimi të drejtë.

### **2.2.1. Ndalimi i daljes jashtështetit**

Neni 233 “*Ndalimi i daljes jashtështetit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin që urdhëron ndalimin e daljes jashtë shtetit gjyqtari urdhëron tëpandehurin tëmos largohet nga territori shtetëror shqiptar pa autorizimin e tij.
2. Gjykata cakton detyrat e nevojshme për të siguruar zbatimin e vendimit dhe për tëndaluar përdorimin e pasaportës e tëdokumenteve të tjera identifikuese tëvlefshme për daljen jashtështetit.

Mevendimin që cakton masën e ndalimit të daljes jashtë shtetit, të pandehurit i ndalohet largimi nga territori shtetëror shqiptar, pa autorizimin e gjyqtarit që ka caktuar masën.

Në këtë vendim përcaktohen masa konkrete për të siguruar zbatimin e tij, siç janë: njoftimi i përfaqësive të huaja që kanë të drejtën e dhënies së vizave për dalje jashtë shtetit, njoftimi i pikave të kalimit të kufirit, i Policisë Kufitare, Policisë Gjyqësore, i qendrës administrative të fshatit apo lagjes ku banon i akuzuari, i zyrave që lëshojnë pasaportat për jashtë shtetit, të cilat detyrohen të bëjnë shënimet përkatëse etj.

### **2.2.2. Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore**

Neni 234 “*Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, tëKodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin për paraqitje në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin tëparaqitet nënjë zyrë të caktuar të policisëgjyqësore.
2. Gjykata cakton ditët dhe orët e paraqitje, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e tëpandehurit.

Kur vendos masën e sigurimit të detyruar për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, gjyqtari urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të Policisë Gjyqësore në ditën dhe orën e caktuar prej tij, në varësi të punës që bën dhe largësisë së vendbanimit nga zyra e Policisë Gjyqësore. Si zyrë e tillë duhet kuptuar ajo që ka në kompetencë territoriale fshatin, lagjen apo qytetin ku ka vendbanimin personi ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit, e cila mund të mos jetë ajo që procedon, por është ajo që vepron për llogari të asaj që procedon.

Zyra e Policisë Gjyqësore ka të drejtë të caktojë rregulla suplementare për njoftimin e vendndodhjes së personit, ndaj të cilit është marrë masa, kur ka shkaqe të pamundësisë objektive për t'u paraqitur në zyrat e Policisë Gjyqësore, siç mund të jenë sëmundjet, fatkeqësitë, forca madhore etj.

### **2.2.3. Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit nënjë vend të caktuar**

Neni 235 “*Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit nënjë vend të caktuar*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin që disponon ndalimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos qëndrojë nënjë vend të caktuar dhe të mos shkojë atje pa autorizimin e tij.
2. Me vendimin që disponon detyrimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet pa autorizimin e saj nga territori i komunës ose bashkisë ku qëndron zakonisht. Kur, për shkak të personalitetit të të pandehurit ose të kushteve të terrenit, qëndrimi në këtë vend nuk garanton nevojat e sigurimit, detyrimi i qëndrimit mund të urdhërohet në territorin e një komune ose bashkie tjetër.
3. Kur vendos detyrimin e qëndrimit, gjykata tregon organin e policisë të cilit i pandehuri duhet t'i paraqitet pa vonesë dhe të deklarojë vendin ku do të caktojë

banesën e vet. Gjykata mund të urdhërojë të pandehurin t'u deklarojë organeve të policisë oraret dhe vendet ku mund të gjendet çdo ditë.

4. Për urdhrat e gjykatës njoftohet organi i policisë që të mbikëqyrë respektimin dhe t'i raportojë prokurorit çdo shkelje.

Me masën e ndalimit dhe të detyrimit të qëndrimit në një vend të caktuar, të akuzuarit i kufizohet e drejta e lëvizjes së lirë brenda shtetit. Këto janë dy forma të ndryshme të masës së

sigurimit, që kanë si qëllim të kufizojnë lëvizjen e lirë të personit ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit.

Në rastin e ndalimit të qëndrimit, personit i ndalohet qëndrimi ose vajtja në një vend të caktuar, i cili mund të jetë një ose shumë komuna apo bashki. Ai është i lirë të lëvizë në të gjithë territorin e shtetit, me përjashtim të vendeve në të cilat i ndalohet qëndrimi. Me qëndrim duhet kuptuar edhe vajtja në vendet që i ndalohet.

Në rastin e detyrimit të qëndrimit, masa e sigurimit e detyron personin të qëndrojë në një vend të caktuar, pra të mos largohet nga territori i komunës ose bashkisë, ku qëndron zakonisht. Kjo masë zbatohet sidomos ndaj endacakëve, të cilët dyshohet se kryejnë vepra penale në vende të ndryshme. Është e kuptueshme që masa e detyrimit të qëndrimit në një vend të caktuar e nënkupton edhe atë të ndalimit për të vajtur apo për të qëndruar në një vend tjetër, sepse ajo e ndalon lëvizjen nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm. Ndryshe qëndron puna me masën e ndalimit të qëndrimit ose të vajtjes në një vend të caktuar, e cila nuk e detyron personin të mos lëvizë në përgjithësi, por e ndalon të shkojë ose të qëndrojë në një vend të caktuar. Si e tillë ajo zbatohet vetëm kur nuk ka masë për detyrimin e qëndrimit në një vend të caktuar. Në vendimin që cakton masën e detyrimit të qëndrimit në një vend të caktuar, gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet, pa autorizimin e tij nga territori i komunës ose bashkisë ku qëndron zakonisht. Kur, për shkak të personalitetit të personit ndaj të cilit merret masa ose për shkak të kushteve të terrenit, qëndrimi në këtë vend nuk garanton nevojat e sigurimit, detyrimi i qëndrimit mund të

urdhërohet në territorin e një komune tjetër të afërt me të. Kuptohet, në një rast të tillë, shpenzimet e qëndrimit do të përballohen nga shteti. Kur vendos detyrimin e qëndrimit, gjyqtari tregon organin e policisë ku duhet të paraqitet i pandehuri për të deklaruar pa vonesë banesën e vet ose vendin ku do të caktojë banesën e tij si dhe oraret dhe vendet ku mund të gjendet çdo ditë.

Zbatimi i vendimit për ndalimin dhe detyrimin e qëndrimit zbatohet nga policia e vendbanimit të personit ndaj të cilit është marrë masa, e cila kontrollon respektimin e

detyrimeve që i janë caktuar atij nga gjyqtari dhe njofton prokurorin për çdo shkelje. Prokurori verifikon shkeljen dhe kur është rasti, kërkon zëvendësimin e masës me një tjetër më të rëndë.

#### **2.2.4. Garancia pasurore**

Neni 236 “*Garancia pasurore*”, i Kodit të Procedurës penale:

1. Garancia pasurore është depozitimi në bankë i një shume të hollash të caktuara nga gjykata, e cila do të kalojë në dobi të shtetit, nëse i pandehuri nuk paraqitet në organin procedues.
2. Paraprakisht gjykatës i paraqitet një deklaratë e nënshkruar nga i pandehuri ose një person tjetër që meriton besim, me të cilin ata deklarojnë se pranojnë të depozitojnë në bankë shumën e caktuar nga gjykata.
3. Pas paraqitjes së dokumentit të depozitimit të shumës dhe pas dëgjimit të prokurorit, gjykata urdhëron zbatimin e vendimit.
4. Në rast mosparaqitjeje shuma e depozituar kalon me vendim të gjykatës në dobi të shtetit.

5. Garancia pasurore është një masë sigurimi, e cila ka si qëllim të sigurojë paraqitjen e të pandehurit në organin procedues sa herë që kërkohet prej tij.

Personi që meriton besim është ai që merr përsipër dhe garanton paraqitjen e të pandehurit në organin që procedon, duke pranuar të depozitojë në bankë shumën e caktuar nga gjykata. I tillë mund të jetë prindi apo kujdestari, bashkëshorti, punëdhënësi dhe cilido tjetër që, për shkak të personalitetit të tij, meriton të besohet. Vlerësimi i këtij besimi bëhet nga gjykata, pasi dëgjohet edhe mendimi i prokurorit.

I pandehuri që ka nënshkruar deklaratën e garancisë pasurore nuk mund të pretendojë të vazhdojë procedimi në mungesë, me pjesëmarrjen e mbrojtësit të tij. Garancia pasurore është një alternative e zëvendësimit të heqjes së lirisë. Sipas nenit 28 të Kushtetutës “i paraburgosuri ka të drejtë ...të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit”.

Garancia pasurore ka si qëllim që i pandehuri të mos i shmanget procedimit dhe të paraqitet sa herë kërkohet nga organi procedues. Ky qëllim del nga vetë deklarata e tij, me të cilën ai merr përsipër të paraqitet sa herë kërkohet, duke e garantuar këtë premtim me shumën e depozituar në bankë. Në rast mosparaqitjeje ai duhet të përgjigjet me të gjitha pasojat që ka parashikuar deklarata e nënshkruar prej tij ose një personi tjetër që meriton besim.

Kur mosparaqitja ndodh gjatë hetimeve paraprake, vendimi për kalimin e shumës së depozituar në dobi të shtetit merret nga gjyqtari me kërkesën e prokurorit. Në të njëjtën kohë, në bazë të nenit 231 të K.Pr.Penale, prokurori kërkon edhe zëvendësimin e kësaj mase sigurimi me një masë tjetër më të rëndë, në përputhje me nevojat e sigurimit për rastin konkret.

Ka ndodhur që një i pandehur që gjykohet, ndaj të cilit është caktuar si masë sigurimi garancia pasurore, akuzohet për një veprë tjetër, të kryer pas caktimit të masës. Në një rast të tillë prokurori ka kërkuar nga gjykata që gjykon veprën penale, për të cilën është marrë masa e sigurimit, që të zëvendësohet masa e sigurimit të garancisë pasurore me atë të arrestit në burg, duke arsyetuar se lënia e të pandehurit në gjendje të lirë paraqet rrezikshmëri për shoqërinë.

Gjykata ka deklaruar moskompetencën për shqyrtimin e kërkesës, me arsyetimin se vepra penale e fundit nuk ka lidhje me atë që gjykohet. Sipas gjykatës, prokurori duhet ta paraqiste kërkesën për ndryshimin e masës së sigurimit në gjykatë për t'u shqyrtuar nga gjyqtar tjetër, si çdo kërkesë për masë sigurimi.

Në këtë rast nuk jemi para moskompetencës, e cila nuk mund të deklarohet për kërkesat që lidhen me masat e sigurimit, prandaj gjykata që është në vazhdim të gjykimit të këtij të pandehuri, duhet ta shqyrtojë kërkesën për ndryshimin e masës së sigurimit brenda pesë ditëve, duke respektuar rregullat e caktuara në nenin 260. Për këtë kërkesë dhe për datën e seancës

duhet të vihen në dijeni i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Në qoftë se i pandehuri paraqitet në seancë, gjykata e shqyrton kërkesën e prokurorit dhe vendos, sipas rastit, pranimin ose jo të saj. Kur gjykata pranon kërkesën për zëvendësimin e kësaj mase me atë të arrestit në burg, garancia pasurore bie dhe të pandehurit i kthehet shuma e depozituar në bankë. Kur kërkesa e prokurorit nuk pranohet nga gjykata, garancia pasurore vazhdon të mbetet si masë sigurimi për të garantuar paraqitjen e të pandehurit në organin që procedon.

Në rastin kur i pandehuri paraqitet në seancën e gjykimit, në të cilën do të shqyrtohet kërkesa për ndryshimin e masës së sigurimit, prokurori mund të kërkojë edhe gjykimin e akuzës së re bashkë me atë që është duke u gjykuar. Dhe gjykata vendos, sipas rastit, duke iu referuar rregullave për akuzat e reja, të parashikuara nga K.Pr.Penale.<sup>65</sup>

Ndryshe veprohet në rast se i pandehuri nuk paraqitet në seancë, pa arsye që e justifikojnë. Në këtë rast, gjykata, pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin, vendos revokimin e garancisë pasurore dhe, me kërkesë të prokurorit, e zëvendëson atë me një masë më të rëndë.

Në praktikë ka raste që kërkohet zëvendësimi i masës së arrestit në burg me garancinë pasurore dhe gjykatat kanë vepruar në varësi të rëndësisë së akuzës dhe rrezikshmërisë së të pandehurit. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.<sup>66</sup>

<sup>65</sup> Shih neni 373 "Akuza për një vepër tjetër" dhe Neni 374 "Akuza për një fakt të ri", të K.Pr.Penale.

<sup>66</sup> Shih Vendimi nr.24, datë 16.01.2002, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



### 2.2.5. Arresti në shtëpi

Neni 237 “Arrestimi në shtëpi”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga vendi i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë.
2. Kur është e nevojshme, gjykata i vë kufizime ose ndalime të pandehurit për të komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me atë.
3. Prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit.
4. Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin.
5. Koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit.

Arrestimi në shtëpi dhe arrestimi në burg janë masa që heqin lirinë, duke e izoluar të pandehurin në shtëpi ose në burg. Kuptohet që këto janë masat më të rënda të cilat zbatohen në rastet kur nuk është i mundur caktimi i masave të tjera. Për arrestin në burg janë parashikuar kritere të veçanta me qëllim që caktimi i tij të jetë i argumentuar dhe i arsyeshëm.

Arrestimi në shtëpi zbatohet zakonisht në rastet kur nevojat e sigurimit plotësohen edhe pa qenë i domosdoshëm burgimi i të akuzuarit. Në praktikë ai zbatohet më shumë ndaj grave, të sëmurëve, të moshuarve etj.

Masa e arrestit në shtëpi është detyrimi i të pandehurit që të mos largohet nga banesa e tij ose nga vendi i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë. Nga ky përcaktim del

që, me shtëpinë, barazohen edhe vendet ku i pandehuri banon përgjithmonë apo përkohësisht, siç janë hotelet, konvaleshencat, azilet, pensionet etj.

Me këtë masë i pandehuri nuk izolohet plotësisht nga shoqëria. Ai ruan të drejtën e komunikimit me personat që bashkëjetojnë me të, por i kufizohet ose i ndalohet komunikimi me persona të tjerë, në përputhje me nevojat e sigurimit. Në ligj nuk përcaktohet mënyra e ruajtjes së personit ndaj të cilit është caktuar masa e arrestit në shtëpi dhe kjo është e

kuptueshme. Janë organet e zbatimit të masave të sigurimit që përcaktojnë dhe zbatojnë rregullat e nevojshme në varësi të rrethanave të çështjes konkrete.

Në praktikë ka ndodhur që personi ndaj të cilit është vendosur arresti në shtëpi është larguar, dukeshkelur detyrimin për qëndrimin në shtëpi. Në këto raste, kur ai është kapur, prokurori ka urdhëruar ndalimin e tij dhe ka kërkuar zëvendësimin e masës me një masë tjetër.

Në rast shkeljeje të detyrimeve, që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes.<sup>67</sup> Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese. Në një rast të tillë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, është shprehur:<sup>68</sup> *“Vendimi i gjykatës duhet miratuar si i bazuar në ligj. Rezulton se i pandehuri G.F. ishte detyruar të qëndronte në banesë, por, në datën 26.11.2001, ai u largua nga vendi i qëndrimit. Nga ana e policisë, pasi u konstatua largimi ... u organizua kapja e tij. Prokurori ka kërkuar arrestin në burg dhe gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1380, datë 28.11.2001, ka vendosur arrest në burg për të pandehurin G.F.”*

Arresti në shtëpi barazohet me arrestin në burg lidhur me rregullat për afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit dhe me llogaritjen e kësaj kohe në caktimin e dënimit. Pra, arresti

<sup>67</sup> Shih neni 231 “Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal”, te K.Pr.Penale.

<sup>68</sup> Shih Vendimi nr.07, datë 03.01.2002, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

në shtëpi nuk mund të zgjatë më shumë se afatet e parashikuara nga ligji procedural<sup>69</sup> dhe kohëzgjatja e tij zbritet nga koha e caktuar në vendimin e dënimit.

Por, në ndryshim nga arresti në burg (paraburgimi), për të cilin një ditë barazohet me një ditë e gjysmë burgim, në bazë të nenit 57 të Kodit Penal, arresti në shtëpi barazohet me burgimin, pra çdo ditë arresti në shtëpi llogaritet një ditë burgim.<sup>70</sup> Masa e kompensimit për periudhën e arrestit në shtëpi nuk duhet të jetë më e madhe se një e dyta e shumës së caktuar për burgimin.<sup>71</sup>

### **2.2.6. Arresti nëburg**

Neni 238“*Arresti nëburg*”, i Kodit tëProcedurës Penale:

1. Me vendimin e arrestit në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore që ta kapë tëpandehurin dhe ta çojëmenjëherënjëinstitution paraburgimi për të qëndruar aty në dispozicion tëautoritetit procedues.
2. Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit.

Arrestit në burg është masa që zbatohet vetëm kur ekzistojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, për të cilat do të flitet më poshtë. Më hollësisht do të analizohen edhe të drejtat e të paraburgosurit.

---

<sup>69</sup> Shih neni 263“*Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit*”, të K.Pr.Penale.

<sup>70</sup> Ky dallim është saktësuar në nenin 7, të ligjit nr.7922, datë 03.05.1995, “Për zbatimin e kodit penal”.

<sup>71</sup> Shih Ligjin nr.. 9381, date 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, neni 6.

Masa e sigurimit arrest në burg konsiderohet si rezerva e fundit në dispozicion të gjyqtarit, megjithatë nga praktika rezulton se ajo zbatohet e para. Me anë të saj gjyqtari disponon me vendim që i pandehuri të kapet nga policia gjyqësore dhe menjëherë të dërgohet pranë një instituti paraburgimi dhe të qëndrojë aty në dispozicion të organeve proceduese. Me anë të arrestit në burg, liritë e personit janë të kufizuara në minimum.

Ajo çka duhet sanksionuar është fakti se masa e sigurimit arrest në burg i nënshtrohet parimit *ne bis in idem*, çka do të thotë se kjo masë mund të zbatohet vetëm një herë.

Gjykata e Lartë,<sup>72</sup> është shprehur se arresti në burg dhe arresti në shtëpi janë alternativa të njëra tjetrës. Kjo do të thotë se në momentin e zëvendësimit të arrestit në burg, për shkak të mbarimit të afateve, kur ekzistojnë ende arsyet për të cilat është caktuar masa e sigurimit, gjykata mund të vendosë zbatimin e arrestit në shtëpi, si dhe e kundërta arresti në shtëpi për shkak të shkeljes së detyrimeve që rrjedhin prej saj nga ana e të pandehurit apo kur nevojat e sigurimit rëndohen, mund të zëvendësohet me arrest në burg. Dhe praktika gjyqësore ka konfirmuar një ekzistencë të tillë.

### **2.2.7. Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik**

Neni 239 “*Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Kur personi qëduhet arrestuar është i sëmurë mendërisht dhe për këtë shkak përjashtohet ose pakësohet shumëzotësia e të kuptuarit ose e vullnetit, gjykata nëvend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm nënjë institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme për tëparandaluar rrezikun e ikje.

---

<sup>72</sup> Shih Vendimi nr.597, datë 04.07.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Shtrimi nuk mund të vazhdojë kur rezulton se i pandehuri nuk është më i sëmurëmendërisht.

Masë sigurimi me izolim është edhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik, e cila zbatohet në rastet kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht në atë shkallë që kjo sëmundje përjashton ose pakëson shumë zotësinë e të kuptuarit ose të shprehjes së vullnetit të tij. Nga përmbajtja e këtij neni del që, për caktimin e masës së shtrimit të përkohshëm në një spital psikiatrik, duhet të ekzistojnë njëkohësisht dy kushte:

Së pari, personi i akuzuar të ketë kryer një veprë penale dhe të ketë një personalitet të tillë që, po të mos ishte i sëmurë, do të arrestohej;

Së dyti, sëmundja mendore të jetë e tillë që ta bëjë atë të pazotin për të kuptuar çfarë i thuhet dhe për të shfaqur vullnetin e tij të lirë.

Në vendimin për shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, gjyqtari cakton edhe masat e nevojshme që duhet të merren për të parandaluar ikjen e të sëmurit. Kur rezulton që i pandehuri nuk është më i sëmurë mendërisht, masa e sigurimit për shtrimin e detyrueshëm në spital hiqet. Ky fakt duhet të vërtetohet rregullisht me aktin e ekspertimit për gjendjen mendore të të shtruarit.

### **2.3. Tipologjia e masave ndaluese**

Masat ndaluese parashikohen nga neni 240 i Kodit të Procedurës Penale. Ato janë:

- a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik;
- b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

Masat ndaluese zbatohen ndaj atyre që para procedimit për një veprë penale kanë kryer detyra apo shërbime publike ose që ushtronin veprimtari profesionale apo afariste. Zakonisht,

vepra penale e kryer prej tyre ka lidhje me detyrën apo shërbimin ose me veprimtarinë profesionale apo afariste. Kështu mund të jetë rasti i një nëpunësi të bashkisë që shpërdoron detyrën lidhur me dhënien e lejeve të ndërtimit, i një mjeku që kryen një vepër penale e cila ka lidhje me profesionin e tij, i një llogaritari të një firme private që falsifikon të ardhurat e firmës për t'iu shmangur tatimeve etj.

Neni 241 “*Kushtet e zbatimit tëmasave ndaluese*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit. Ato kanë karakter të përkohshëm dhe caktohen në formën e pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik ose të ndalimit të përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë profesionale ose afariste.

### **2.3.1. Pezullimi i ushtrimit të një detyrë a shërbimi publik**

Neni 242 “*Pezullimi i ushtrimit të një detyrë a shërbimi publik*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to.
2. Kjo masë nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral.

Pezullimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, pra për një pjesë të detyrave, shërbimeve apo veprimtarive, ose në tërësi për të gjitha ato. Kështu, nëpunësit të urbanistikës mund t'i hiqet e drejta për t'u marrë me lejet e ndërtimit, por i lejohet të merret me kontrollin e ndërtimeve pa leje; një mjeku kirurg i hiqet e drejta për të bërë operacione, por i lejohet të bëjë vizita e mjekime të zakonshme etj. Në vendimin e caktimit të masës ndaluese duhet të saktësohet nëse

pezullimi ose ndalimi është i plotë apo i pjesshëm dhe, në rastin e fundit, të tregohet se ç'lloj funksionesh pezullohen apo ndalohen.

Masa e pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik nuk mund të zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, pra kundër atyre që janë zgjedhur në organet e pushtetit qendror ose lokal. Këtu kemi të bëjmë një ndalim ligjor.

### **2.3.2 Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste**

Neni 243 “*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin që disponon ndalimin për të ushtruar profesion ose detyra të caktuara drejtuese në persona juridikë, gjykata e ndalon përkohësisht të pandehurin, plotësisht ose pjesërisht, të ushtrojë veprimtaritë që lidhen me to.
2. Ndalimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, pra për një pjesë të veprimtarive ose në tërësi për të gjitha.

### **2.4. Formaliteti i masave të sigurimit personal**

Ndryshimet që sjell Kodi i ri i Procedurës Penale, janë dy: së pari, është ndryshuar rrënjësisht rregullimi ligjor i Kodit të vjetër dhe praktika shumë vjeçare e caktimit të masave të sigurimit nga prokurori, rregullim ky që, jo vetëm nuk përputhet me vendin që zë prokurori në procedimin penal si palë, por është bërë dhe shkak për shkelje të rënda të lirive dhe të të drejtave të personave të proceduar. Në Kodin e ri të Procedurës Penale është pranuar rregulli i

njohur përgjithësisht dhe i sanksionuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që masat e sigurimit caktohen nga gjykata.<sup>73</sup>

Pasojat negative të këtij rregullimi nuk u shmangën plotësisht edhe me ndryshimet që iu bënë Kodit të vjetër në vitin 1992,<sup>74</sup> në bazë të të cilave i pandehuri mund të ankohej në gjykatë kundër masës së arrestit të caktuar nga prokurori. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i formës së prerë.

Së dyti, ndryshimi tjetër ka të bëjë me momentin e caktimit të masës së sigurimit: Kërkesa për caktimin e masës së sigurimit bëhet atëherë kur ekzistojnë nevojat e sigurimit, gjëqëdo tëthotëse ajo mund të bëhet në çdo fazë të procedimit ose mund të mos bëhet fare.

Caktimi i masës së sigurimit nuk lidhet me njoftimin e akuzës dhe pyetjen e të pandehurit. Masat e sigurimit, si rregull, caktohen përpara se të bëhet njoftimi i akuzës dhe kanë si qëllim të plotësohen nevojat e sigurimit ndaj personit në procedim. Vetëm pas zbatimit të tyre bëhet njoftimi i akuzës dhe vazhdohet me marrjen në pyetje. Kjo gjë del edhe nga Kushtetuta,<sup>75</sup> që parashikon se: “*Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet për akuzën që i bëhet*” ose, e thënë ndryshe, njoftimi i akuzës bëhet pas heqjes së lirisë.

---

<sup>73</sup> D.m.th. nga gjyqtari.

<sup>74</sup> Shih Ligji nr.7574, datë 24.06.1992 “*Për organizimin e drejtësisë dhe disandryshime në kodet e procedurave penale e civile*”.

<sup>75</sup> Shih neni 28 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



Mendimi, sipas të cilit masa e sigurimit mund të caktohet vetëm pasi personi të jetë marrë i pandehur është i gabuar. Që masa e sigurimit mund të caktohet edhe pa u marrë i pandehur, del nga disa dispozita të Kodit të Procedurës Penale dhe, konkretisht:

1. Në nenin 307 të Kodit të Procedurës Penale bëhet e qartë se masat e sigurimit mund të caktohen dhe të zbatohen, pa qenë nevoja që personi të jetë marrë i pandehur. Në këtë nen thuhet : *“Ai që ka marrë dajeni se ndaj tij zhvillohen hetime, ka të drejtë të paraqitet te prokurori dhe të bëjë deklaratime. Paraqitja vetë nuk pengon zbatimin e masave të sigurimit”*.

Pra del qartë që masa e sigurimit mund të caktohet para se personi, të cilit i atribuohet vepra penale, të pyetet si i pandehur dhe paraqitja e tij nuk pengon masën e sigurimit që është marrë me përpara.

Në nenin 245 të Kodit të Procedurës Penale, që bën fjalë për vendimin e gjyqtarit për caktimin e masës së sigurimit, thuhet shprehimisht: *“Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban: “gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë dhe, kur është e mundur, tregimin e vendit ku ndodhet”*. Nuk ka si thuhet më qartë që ai nuk është i pandehur, por person ndaj të cilit merret masa dhe se ai, jo vetëm mund të mos jetë marrë i pandehur, por mund të mos i dihen gjeneralitetet e tija, prandaj në vendim duhet të tregohet çdo gjë që vlen për ta identifikuar atë.

Në nenin 246, i cili bën fjalë për zbatimin e masave të sigurimit, thuhet: *“Oficeri ose agjenti i policisë, i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit, i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit...”*

Në nenin 248, i cili bën fjalë për marrjen në pyetje të personit të arrestuar, thuhet: *“Jo më vonë se 3(tri) ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi”*.

Përdorimi i fjalës “*i pandehur*”, në ndonjë dispozitë të Kodit shpjegohet me faktin që personi për të cilin është caktuar masë sigurimi mund të jetë edhe i pandehur, por jo se, pa qenë i tillë, ndaj tij nuk mund të caktohet masë sigurimi. Një përdorim i tillë i fjalës “*i pandehur*” ndeshet edhe në legjislacionet procedurale të shteteve që kanë rregullin e marrjes si të pandehur në fund të hetimeve, kur vendoset dërgimi i çështjes në gjykatë, pra shumë kohë më vonë se caktimi i masës së sigurimit.<sup>76</sup> Deri në atë kohë ai quhet person nën hetim.

Debati lidhur me caktimin e masës së sigurimit ndaj personit që nuk është marrë i pandehur u zgjidh përfundimisht me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,<sup>77</sup> në të cilin arsyetohet me të drejtë se: “*Kur personit i është hequr liria, në formën e ndalimit apo arrestimit në flagrancë apo kur ndaj tij është caktuar masë sigurimi personal, organi i prokurorisë nuk është i detyruar që, përpara marrjes së këtyre masave apo përpara se të paraqitet në gjykatë, për vleftësimin apo caktimin e masës së sigurimit personal, ta marrë atë me cilësinë e të pandehurit*”.

Neni 244 “*Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa.

Kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit gjatë hetimeve paraprake paraqitet në gjykatën që ka kompetencën lëndore dhe tokësore për gjykimin e veprës penale, duke respektuar rregullat e parashikuara për kompetencën në nenet 74-78 të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>76</sup> Shih neni 292 të K.Pr.Penale të Italisë, që bën fjalë për vendimin e caktimit të masës së sigurimit.

<sup>77</sup> Shih Vendimi nr. 3, datë 27.09.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Masa e sigurimit caktohet nga gjyqtari mbi kërkesën e prokurorit, së cilës i bashkohen të dhënat dhe aktet që tregojnë se ekzistojnë kushtet dhe plotësohen kriteret për caktimin e masës. Gjyqtari vendos mbi bazën e akteve të paraqitura nga prokurori, pa pjesëmarrjen e personit për të cilin kërkohet vendimi për caktimin e masës së sigurimit. Përgjashtimi nga ky rregull bëhet për arrestin në flagrancë dhe ndalimin e personit i cili dyshohet për kryerjen e një krimi, të cilat kryhen nga Policia Gjyqësore dhe, brenda dyzet e tetë orëve, vlerësohet nga gjyqtari me kërkesën e prokurorit. Për këtë përgjashtim do të flitet hollësisht më poshtë në kreun për arrestimin në flagrancë dhe ndalimin.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë sqaruar hollësisht rregullat për caktimin e masave të sigurimi, duke theksuar:<sup>78</sup> Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar dy mënyra për caktimin e masave të sigurimit personal.

1. Mënyra e parë dhe që është rregulli për caktimin e masave të sigurimit është ajo që parashikohet nga neni 244 e vijues i këtij Kodi. Sipas këtij rregullimi është prokurori, i cili, mbasi ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme se në ngarkim të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet për një vepër të caktuar penale ekziston dyshimi i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale, duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret që parashikon Kodi i Procedurës Penale, në nenet 228 e vijues të tij, i bën kërkesë gjykatës që të caktojë një masë sigurimi personal, me qëllim që të garantojë nevojat e sigurimit. Në këtë rast gjykata verifikon nëse ekzistojnë realisht nevojat e sigurimit dhe nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal dhe duke verifikuar rrethanat faktike përcakton llojin e masës së sigurimit në përputhje me kriteret ligjore, me kushtin e vetëm që masa të mos jetë më e rëndë se ajo që kërkohet nga prokurori.

---

<sup>78</sup> Shih Vendimi nr.4, datë 24.6.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ky rregullim ligjor është logjik, sepse në themel do të garantojë që një person që dyshohet të ketë kryer një vepër penale, të mos kryejë një vepër tjetër, të mos vërë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, apo t'i largohet dhe shmanget procedimit penal. Këto janë dhe shkaqet qëprokurori, edhe pse nuk kemi një gjykim me palë, duhet t'ia parashtrijë dhe provojë gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase të sigurimit personal.

- a) Së pari, nga përmbajtja e kësaj dispozite del qartë se qëllimi i ligjvënësit është të urdhërojë se masa e sigurimit caktohet vetëm nga gjykata.

Gjykata nuk disponon kryesisht, pra masa nuk caktohet nëse nuk paraqitet kërkesë nga prokurori, e cila duhet të jetë e mbështetur në prova dhe në ligj.

- b) Së dyti, kërkesa duhet t'i paraqitet *gjykatës kompetente*. Kjo dispozitë gjendet në Pjesën e Parë, Titullin V, Kreu II. Pra, jo vetëm nga vendi ku gjendet në Kodin e Procedurës Penale Titujve mbi, por edhe nga përmbajtja e saj, kjo dispozitë thjesht evidenton se duhet respektuar parimi procedural i disponimit nga organi që procedon.

Pa dyshim që, në fazën e gjyimit, i vetmi organ që procedon me çështjen penale të dërguar për gjykim, pra edhe për caktimin e masës së sigurimit, revokimin e zëvendësimin e saj, është gjykata, pikërisht vetëm ajo gjykatë e cila është caktuar për gjykimin e veprës penale deri në dhënien e vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit.

Kodi i Procedurës Penale,<sup>79</sup> parashikon gjykatat të cilat gjykojnë veprat penale. Gjithashtu, përcakton se me përbërje monokratike gjykohen kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, ku bëjnë pjesë edhe disponimet lidhur me masat e sigurimit. Dispozita e pikës 2 nuk

<sup>79</sup> Shih neni 13 “Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre”, të K.Pr.Penale.

tregon se kush disponon për kërkesa të palëve lidhur me masa sigurimi në fazën e gjykimit, as për përbërjen e gjykatës.

Kjo nuk është e rastit dhe as ndonjë orientim nga ana e ligjvënësit. Qëllimi i këtyre dispozitave nuk është të tregojnë a kufizojnë ushtrimin e së drejtës së paraqitjes të kërkesave të palëve apo ushtrimin e kompetencës së gjykatës mbi masat e sigurimit vetëm në fazën e hetimit apo edhe në atë të gjykimit. Dispozita thjesht tregon që, nëse kërkesat paraqiten në fazën e hetimit, vendos gjykata monokratike, e njëjta gjykatë që gjatë hetimit, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, disponon edhe për ecurinë e zbatimit të masës së sigurimit.<sup>80</sup>

Por edhe ky nen nuk shprehet dhe nuk e lidh zbatimin e urdhërimeve të saj vetëm me fazën e hetimit, sepse, gjatë fazës së gjykimit, është gjykata e themelit që vlerëson situatën e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar më parë gjatë hetimit paraprak apo në fazën e gjykimit.

Ndërkohë që, edhe kuptimi e zbatimi i dispozitave të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale nuk lidhet me ndonjë fazë gjykimi, por gjejnë zbatim kurdoherë “*kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit*” të një mase sigurimi të caktuar më parë. Madje pika 4 e këtij neni tregon qartë se për revokimin a zëvendësimin e masës ekzistuese disponon, jo vetëm gjyqtari i hetimit paraprak, por, në varësi të fazës së procedimit, edhe e njëjta gjykatë, pra ajo që shqyrton kërkesën për gjykim dhe zgjidh përfundimisht në themel çështjen.

As kjo dispozitë nuk tregon apo urdhëron se masat e sigurimit caktohen vetëm në fazën e hetimit paraprak.

Edhe kur gjykata deklaron moskompetencën e vet për çdo lloj shkak, nëqoftëse janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente.

---

<sup>80</sup> Shih neni 246 “Zbatimi i masave të sigurimit”, të K.Pr.Penale

Gjyqtari i caktuar për shqyrtimin e kërkesës për masën e sigurimit, fillimisht verifikon kompetencën dhe vendos lidhur me të. Kur deklaron moskompetencën ai ia dërgon kërkesën gjykatës kompetente. Por edhe në këtë rast, në qoftë se janë kushtet për marrjen e masës dhe ekziston urgjenca për zbatimin e saj, gjyqtari vendos caktimin e masës dhe këtë vendim bashkë me të gjithë dokumentacionin përkatës ia dërgon gjykatës kompetente.

Për rastin kur vepra penale është kryer jashtë shtetit nga një shtetas shqiptar, masa e sigurimit caktohet nga gjykata që është kompetente për të proceduar sipas nenit 77 të Kodit të Procedurës Penale.

Lidhur me këtë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke shqyrtuar ankimin e të pandehurit E.D., që kishte kryer një krim në Greqi dhe pretendonte moskompetencën e gjykatës së rrethit gjyqësor të Beratit për caktimin e masës së sigurimit, ka arsyetuar:<sup>81</sup> *“Neni 77 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se gjykata kompetente për të proceduar ndaj një personi që ka kryer një krim jashtë shtetit është gjykata e vendqëndrimit të të pandehurit. Pavarësisht se i pandehuri banon në Greqi, vendqëndrimi aktual i tij pas kthimit nga ai shtet ka qenë në Berat...Procedimi i tij në shtetin grek nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë dhe kjo tregon legjitimitimin e gjykatës së rrethit gjyqësor të Beratit për vendimin e dhënë”*. Gjkata kompetente, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e akteve, duhet të vendosë përmasën e sigurimit, përndryshe masa e caktuar e humbet fuqinë.

Sipas rastit, gjykata kompetente mund të pranojë po atë masë, mund të caktojë një tjetër ose mund të mos caktojë fare.<sup>82</sup> Gjkata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më tërëndësë ajo e kërkuar nga prokurori.

---

<sup>81</sup> Shih Vendimi nr. 01, datë 08.01.2001, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>82</sup> Shih neni 88 “Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente”, të K.Pr.Penale.

Këtu kemi të bëjmë me një ndalim ligjor. Kjo zgjidhje merr parasysh faktin që masa e sigurimit caktohet me kërkesë të prokurorit, i cili njih koncretisht nevojat e sigurimit dhe përshtatjen e tyre me interesat e hetimit. Mund të ndodhë që, për qëllimet e hetimit, në raste të caktuara mund të jetë më i dobishëm arresti në shtëpi apo paraqitja në polici se sa burgimi.

Për veprat penale që ndiqen me ankimin e të dëmtuarit akuzues, kërkesa e prokurorit për masën e sigurimit bëhet në fillim të gjykimit, në të cilin ai merr pjesë.<sup>83</sup>

Mund të ndodhë që i pandehuri të dërgohet për gjykim pa masë sigurimi. Si do të veprohet në qoftë se ai paraqitet dhe kërkon të marrë pjesë në gjykim, sidomos në rastin kur është hetuar në mungesë?

Në një rast të tillë, në qoftë se prokurori vlerëson se duhet caktuar masë sigurimi, duhet të bëjë kërkesë në gjykatë duke respektuar rregullat e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit. Kërkesa e prokurorit duhet të shqyrtohet nga gjyqtari apo trupi gjykues që gjykon çështjen, sepse, kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht të zëvendësojë ose të revokojë masën e sigurimit për të pandehurit që gjykohen.<sup>84</sup>

Një rast tjetër veçantë i caktimit të masës së sigurimit është ai kur:<sup>85</sup> *“Ndaj të pandehurit të liruar nga burgju për shkak të mbarimit të afateve, gjykata, kur ekzistojnë ende arsyet për të cilat është vendosur paraburgimi, cakton masa të tjera sigurimi në qoftë se janë kushtet e kërkuara”.*

Mbarimi i afatit të paraburgimit mund të ndodhë në çdo fazë të procedimit. Kur kjo gjë ndodh në fazën e hetimeve paraprake, prokurori duhet t'i kërkojë gjyqtarit caktimin e një mase tjetër sigurimi, duke argumentuar nevojën e caktimit të masës dhe llojin e saj. Në qoftë se afati i paraburgimit mbaron në fazën e gjykimit, gjykata që shqyrton çështjen, me kërkesë të

<sup>83</sup> Shih neni 59“I dëmtuari akuzues”, paragrafi 2, të K.Pr.Penale.

<sup>84</sup> Shih neni 260“Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit”, të K.Pr.Penale.

<sup>85</sup> Shih neni 266 “Disponimet në rastet e lirit nga burgju”, të K.Pr.Penale.

prokurorit, cakton masën tjetër të sigurimit. Në këtë rast asaj nuk i ndalohet një gjë e tillë, sepse nuk është fjala për caktimin fillestar të masës së sigurimit, por për zëvendësimin e një mase që është shuar me një masë tjetër, me kusht që “të ekzistojnë ende arsyet për të cilat është vendosur paraburgimi”.

Mënyra e dytë që K.Pr.Penale, parashikon për caktimin e masave të sigurimit përgjithësisht është nëpërmjet verifikimit të veprimeve me iniciativë të policisë gjyqësore në rastet e arrestimit në flagrancë, apo te ndalimit të personit të dyshuar për një vepër penale i cili ka rrezik ikje. Në këtë rast, gjykata kryen dy funksione brenda një gjykimi, së pari verifikon nëse veprimet për heqjen e lirisë së personit janë ose jo në përputhje me ligjin, nga ana tjetër,

mbi kërkesën e prokurorisë, gjykata verifikon nëse nevojat e sigurimit e kërkojnë ose jo që ndaj personit të caktohet një masë sigurimi personal.

Ky gjykim, si për fazën e parë të tij, ashtu dhe për fazën e dytë është një gjykim që bazohet mbi parimet e procedimit penal dhe gjykata e zhvillon gjykimin me prezencën si të prokurorit ashtu edhe të personit të ndaluar ose të arrestuar, ku të dyja palëve, si akuzës edhe mbrojtjes, i garantohet e drejta që pretendimet e tyre t’ia parashitjnë gjykatës në mënyrë të barabartë duke ju dhënë e drejta të paraqesin prova dhe të kundërshtojnë njëra tjetrën, bazuar në parimin e një procesi të rregullt gjyqësor.

Është e vërtetë se në rastin e caktimit të masës së sigurimit personal jo si përjashtim, pra jo në kushtet e flagrancës, kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës nuk i njoftohen personit ndaj të cilit kërkohet apo vendoset caktimi i një mase sigurimi. Këto janë veprime sekrete, të cilat për shkak se masa duhet të ekzekutohet dhe për shkak se marrja dijeni përpara ekzekutimit nga personi ndaj të cilit është caktuar një masë mund ta bënte të pamundur ekzekutimin e saj, nuk kërkojnë njoftimin paraprak të personit. Jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar që të drejtat,



personi ndaj të cilit është caktuar një masë sigurimi në këto kushte, mund t'i mbrojë gjatë gjykimit të vleftësimit të masës nga gjykata brenda tre ditëve nga ekzekutimi i saj.

Si çdo rregull dhe ky ka përjashtimin e tij, këtë ka parashikuar ligjvënësi në formulimin që:<sup>86</sup> *“palët, përfshi këtu edhe të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, kanë të drejtë që brenda një afati 10(dhjetë) ditor nga zbatimi ose njoftimi të vendimit të gjykatës, të ankojnë vendimin në gjykatën më të lartë”*.

Neni 245 *“Vendimi i gjykatës”*, i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban:

- a) Gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë dhe, kur është e mundur, tregimin e vendit ku ndodhet. Në kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit dhe në vendimin e gjyqtarit që e pranon ose e refuzon kërkesën duhet të shënohen gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa e sigurimit dhe, kur ato nuk janë të plota, tregohen të dhëna të tjera që vlen për ta identifikuar atë. Kur është e mundur, tregohet edhe vendi ku ai ndodhet.
- b) Parashtrimin përmbledhës të fakteve, duke treguar nenet e ligjit që konsiderohen të shkelura. Vendimi që pranon kërkesën për caktimin e masës së sigurimit duhet të përmbajë parashtrimin përmbledhës të faktit, të rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe të pasojave të ardhura. Mbi këtë bazë bëhet përcaktimi i nenit apo i neneve të ligjit penal që është shkelur. Në vendimin e gjyqtarit duhet të tregohen të dhënat konkrete dhe arsyet që për ligjin masën e sigurimit, e cila mund të jetë njëjtë me atë që ka kërkuar prokurori, por mund të jetë e ndryshme, me kusht që të mos jetë më e rëndë nga ajo që ka kërkuar prokurori.

---

<sup>86</sup> Shih Neni 249 *“Ankimi kundër masave të sigurimit”*, të K.Pr.Penale.

- c) Parashtrimin e shkaqeve tëposaçme dhe të të dhënave që përligjin masën e sigurimit.
- d) Caktimi i kohëzgjatjes së masës, kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës. Në këtë rast prokurori duhet t'i vërtetojë këto shkaqe që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, kurse gjyqtari duhet t'i verifikojë dhe arsyetojë ato. Nuk duhet të ndodhë që prokurori të kërkojë si masë sigurimi arrestin në burg për një kohë të caktuar, me arsyetimin se i duhet dhënë një afat për të gjetur prova dhe gjyqtari ta pranojë këtë. Ndodhemi para njëndalimi ligjor.
- e) Datën, nënshkrimin e kryetarit, të sekretarit që e asiston dhe vulën e gjykatës.

Vendimi për masën e sigurimit duhet të përmbajë datën, nënshkrimin e gjyqtarit dhe vulën e gjykatës. Kur vendimi është dhënë për masën e sigurimit arrest në burg ose në shtëpi, gjyqtari duhet të shprehet edhe për detyrimin e marrjes në pyetje nga gjyqtari të personit për të

cilin është vendosur arrestimi në burg ose në shtëpi, jo më vonë se 3(tri) ditë nga zbatimi i masës.<sup>87</sup> Ai duhet të kërkojë zbatimin e kësaj kërkesë ligjore nga prokurori dhe policia gjyqësore. Ky detyrim për të marrë në pyetje të arrestuarin buron nga parimi i famshëm i Habeas Corpus, sipas të cilit personi i arrestuar duhet të dëgjohet nga gjyqtari. Ky është një rregull i njohur përgjithësisht nga legjislacionet e shteteve dhe i zbatuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.

Neni 246 “Zbatimi i masave të sigurimit”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që të zgjedhë një mbrojtës, njofton menjëherë mbrojtjen e zgjedhur nga i pandehuri ose të caktuar kryesisht dhe mban procesverbal për të gjitha veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit;

<sup>87</sup> Shih neni 248 “Marrja në pyetje e personit të arrestuar”, të K.Pr.Penale.

2. Në rast se dyshohet për vërtetësinë e vendimit që ka caktuar masën e sigurimit ose përvërtetësinë e identitetit të personit ndaj të cilit është dhënë masa, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore tëngarkuar nuk e zbatojnë atë ;
3. Vendimet për masat e tjera të sigurimit i njoftohen tëpandehurit nga gjykata;
4. Pas njoftimit ose zbatimit tëtyre, vendimet depozitohen në sekretarinë e gjykatës që i ka dhënë. Për depozitimn njoftohen edhe mbrojtësit;
5. Kopja e vendimit, me të cilin është caktuar masa një masë ndaluese i dërgohet organit qëështëkompetent për të vendosur caktimin e një mase të tillë në rastet e zakonshme;
6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, gjykata që ka dhënë vendimin duhet tëinformohet nga prokurori për të arrestuarin. Informacioni jepet me shkrim dhe përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, për pyetjen e tëpandehurit dhe tëpersonave tjetërë, për përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të

akteve të fashikullit. Kur është rasti, gjykata mund tërevokojë ose të zëvendësojëmasën e sigurimit.

Brenda tre muajve mbrojtja e godet gjykatën pa fund, e nisme masat e sigurimit duke bërë ankim në gjykatën e apelit. Pas dy muajsh mbrojtja kërkon që prokurori të bëjë relacionin sipas këtij paragrafi, në të kundërt nëse prokurori nuk zbaton detyrimin ligjor që parashikohet në këtë dispozitë, mbrojtjes i jepet e drejta të kërkojë revokimin ose zëvendësimin, pas njëmuajji kemi zgjatjen e afateve, mbrojtja përsëri bën ankim në gjykatën e apelit, ndërkohë vjen koha e 2- mujorshit të relacionit të prokurorit para gjykatës. Kjo dispozitë na tregon qartë si futet mbrojtja aty ku është tabu e akuzës, si i bën “presion” gjykatës për të garantuar të drejtat kushtetuese tëtëpandehurit.

Në bazë të nenit 88, “*gjykata kompetente, brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, duhet të vendosë për masën e sigurimit*”, përndryshe masa e caktuar e humbet fuqinë. Sipas

rastit, gjykata kompetente mund të pranojë po atë masë, mund të caktojë një tjetër ose mund të mos caktojë fare.

Gjyqtari mund të pranojë ose të rrëzojë kërkesën e prokurorit, duke vepruar me pavarësi të plotë. Lidhur me këtë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë shprehur:<sup>88</sup>

*“Sipas pikës 1 të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori, me kërkesën e tij, vë në lëvizje gjykatën për të vendosur masat e sigurimit. Është kjo e fundit që, në përputhje me kërkesat e neneve 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale, cakton masën e sigurimit personal. Në pikën 1 të nenit 229 thuhet: Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret”.*

Neni 248 *“Marrja nëpyetje e personit të arrestuar”*, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Detyrimi për marrjen në pyetje e të arrestuarit buron nga parimi i njohur i *Habeas Corpus*, sipas të cilit personi i arrestuar duhet të dëgjohet nga gjyqtari. Ky është një rregull i njohur përgjithësisht nga legjislacionet e shteteve dhe i zbatuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.
2. Nëpërmjet marrjes në pyetje gjykata verifikon kushtet e zbatimit të masës së arrestit dhe nevojat e sigurimit. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Seanca e dëgjimit zhvillohet me pjesëmarrjen e palëve dhe pasqyrohet në procesverbal, i cili, pasi nënshkruhet nga gjyqtari dhe sekretari, i bashkohet fashikullit të gjykatës. Ky është akti që dokumenton seancën e dëgjimit të arrestuarit nga gjyqtari dhe me këtë përfundohet detyrimi i parashikuar nga neni 248, pa qenë nevoja për të marrë një vendim mbi vendim për të konfirmuar vendimin e parë të ekzekutuar. Qëllimi i seancës së dëgjimit nuk është caktimi i masës së

<sup>88</sup> Shih Vendimi nr. 46, datë 28.01.1999, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

arrestit, por verifikimi i kushteve dhe i nevojave të sigurimit mbi të cilat është bazuar vendimi i gjyqtarit që është ekzekutuar. Ndryshe veprohet kur nga verifikimet e bëra në seancën e dëgjimit del se kushtet e caktimit të masës së arrestit dhe nevojat e sigurimit nuk ekzistojnë ose kanë ndryshuar. Në këtë rast gjyqtari vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Këtë gjë ai e bën me vendim, me kërkesën e palëve ose kryesisht.

3. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës;
4. Kur pyetja e të arrestuarit duhet të bëhet në gjykatën e një rrethi tjetër, gjykata kërkon qëpyetja të bëhet nga një gjyqtar i asaj gjykate.

Të drejtat e të pandehurit për t'ju garantuar një proces i rregullt me zbatimin e normave kushtetuese dhe atyre ndërkombëtarë për tëmbrojtur dhe garantuar liritënjëprocedim penal,

ligjvënësi i ka përcaktuar në një fazë të dytë, sipas të cilit gjykata detyrohet që, jo me vonëse 3 (tri) ditë nga zbatimi i masës, të marrënë pyetje personin për të cilin është vendosur arresti nëburg ose në shtëpi dhe nëpërmjet kësaj të verifikojë kushtet dhe kriteret për zbatimin e kësaj mase në raport me nevojat e sigurimit.<sup>89</sup>

Neni 249 “*Ankimi kundër masave të sigurimit*”, i Kodit tëProcedurës Penale:

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit tëgjykatës nëbazëtëtcilit është marrë ose është refuzuar një masë sigurimi, prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim nëgjykatën më të lartë. Sipas këtij paragrafi, brenda dhjetë ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës në bazë të të cilit është marrë ose është refuzuar një masë sigurimi, prokurori, i

<sup>89</sup> Shih neni 248 “Marrja në pyetje e personit të arrestuar”, të K.Pr.Penale.

pandehuri dhembrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë. Për të pandehurin e ikur afati i ankimit fillon nga data e njoftimit të bërë sipas nenit 141.

2. Për të pandehurin e ikur afati fillon të ecë nga data e njoftimit të bërë sipas nenit 141. Kolegjet e Bashkuara, për të interpretuar kuptimin që ka kjo dispozitë e Kodit të Procedurës Penale, paragrafi i parë dhe i dytë, vlerëson se ajo duhet parë në unison me dispozita të tjera të K.Pr.Penale, dhe bazuar mbi parimet e procedimit penal, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut,<sup>90</sup>

si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,<sup>91</sup> parashikojnë të drejtën e ankimit efektiv ndaj vendimit të gjykatës. Te njëjtin qëndrim mban edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,<sup>92</sup> e cila ka parashikuar se: “*Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. Për të garantuar këtë të drejtë, ligji procedural ka një sërë dispozitash të cilat e bëjnë efektive atë. Sipas nenit 242 të K.Pr.Penale, kur personi ndaj të cilit është marrë një masë sigurimi personal nuk gjendet nga oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, mbahet një procesverbal, i cili duhet të tregojë në mënyrë të hollësishme veprimet që janë bërë me qëllim gjetjen e personit dhe

---

<sup>90</sup> Shih neni 8 të Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut: “*Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuar nga kushtetuta ose ligjet*”.

<sup>91</sup> Shih neni 13 “E drejta për zgjidhje efektive”: “*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare*”.

<sup>92</sup> Shih neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”.

vënien në ekzekutim të vendimit të gjykatës. Ky procesverbal i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila verifikon nëse kërkimet e bëra kanë qenë të plota ose jo dhe në eventualitetin se ato kanë qenë të mjaftueshme, gjykata vendos deklarin e ikjes së personit. Nga ky moment nuk ka më një vendim sekret për t'u vënë në ekzekutim dhe ky është momenti që gjykata, me aktin e deklarin të ikjes, është e detyruar që personit të deklaruar i ikur t'i caktojë mbrojtës dhe urdhëron depozitimin e vendimit në sekretarinë e gjykatës. Qëllimi që ligjvënësi ka bërë këtë rregullim është që ta garantojë individin nga një masë sigurimi që i privon lirinë personale, e cila nuk mundet të zgjasë pafundësisht pa ju nënshtruar verifikimit real të drejtësisë dhe ligjshmërisë së saj. Për të evituar këtë, ligjvënësi ka përcaktuar detyrime ndaj organit që merret me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ai duhet ta vendos në ekzekutim vendimin e caktimit të masës së sigurimit dhe në pamundësi të kësaj, të plotësojë procedurat për të bërë të mundur që vazhdimi i procedimit të jetë

në përputhje me të gjitha kërkesat që parashikon Kodi i Procedurës Penale për garantimin e një procesi të rregullt. Jo pa qëllim ligjvënësi e ka lidhur në paragrafin e dytë të nenit 249 të K.Pr.Penale me rregullimet që parashikon neni 141 i K.Pr.Penale, për mënyrën e njoftimit të personit ndaj të cilit është caktuar një masë sigurimi pa prezencën e tij dhe që është deklaruar i ikur me vendim gjyqësor. Këto dispozita duhen parë të lidhura me njëra-tjetrën dhe veprimet që kryhen kalojnë në disa faza. Bazuar sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal është një vendim ankimeshëm edhe nëse ai nuk është zbatuar, me kushtin që personi ndaj të cilit është dhënë vendimi të jetë vënë në dijeni pasi të jetë deklaruar me vendim gjykate ikja e tij.

3. Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimit, e cila detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve të dorëzojë aktet në gjykatën që do të

shqyrtojë ankimin. Sipas këtij paragrafi, kërkesa ankimore paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar, e cila detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve, të dorëzojë aktet në gjykatën qëdo të shqyrtojë ankimin. Kërkesa shqyrtohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

4. Data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, tëpandehurit dhe mbrojtësit tëtij të paktën tri ditë përpara. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, katheksuar se:<sup>93</sup> *“duke u nisur nga mënyra e ndërtimit tëpikës 4 tënenit 249, arrihet në përfundimin se duhet njoftuar në radhëtëparë i pandehuri dhe pastaj mbrojtësi i tij”*. Ligjvënësi në këtë rast ka përdorur lidhëzën “dhe” dhejo “ose”, që do të lejonte gjykatën tënjoftonte veç njërin prej tyre.

5. Kërkesa shqyrtohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja në dorëzim tëakteve. Është në detyrimin e vetë personit ose mbrojtësit të tij të provojë momentin e marrjes dijëni, e lidhur kjo me afatin 10 ditor për të ankimuar vendimin e gjykatës. Pranimi i të kundërtës do te sillte efekt negativ, ku edhe pse organet proceduese kanë detyrimin ta njoftojnë të pandehurin lidhur me vendimin, nuk e bëjnë, duke i mohuar të drejtën e një ankimi. Kjo bie ndesh me dispozitat e nenit 247, 249, si dhe nenit 43 te Kushtetutës. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: *“e drejta për të ankuar vendimin e caktimit të masës së sigurimit nga personi, ndaj të cilit është caktuar kjo masë në mungesë, lind brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi apo marrja dijëni e vendimit prej ti ose mbrojtësit”*. Në këtë përfundim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë bazuar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit, ndër të tjera, është theksuar se:<sup>94</sup> *“... moslejimi i mbrojtësit për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës,*

<sup>93</sup> Shih Vendimi nr.179, datë26.02.2002, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>94</sup> Shih Vendimi nr.15, datë 17.04.2003, të Gjykatës Kushtetuese.



*të dhënë në mungesë të të akuzuarit, në kushtet e nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, e ve njërën palë në pozitë të pabarabartë me palën tjetër”.*

6. Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Në bazë të këtij paragrafi, gjykata e shqyrton çështjen në tërësi, pavarësisht nga arsyet që janë parashtruar në ankim ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit të ankimuar. Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë duhet të shprehen edhe kur pretendohet ekzistenca ose jo e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, pra duhet të bëjnë analizën e provave të marra nga gjykata që ka caktuar masën e sigurimit. Gjykatës së apelit i lejohet të rimarrë prova dhe të kërkojë prova të tjera. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka ndryshuar ose ka prishur vendimet e gjykatave lidhur me vlerësimin e dyshimit të arsyeshëm. Në Lidhje me këtë Kolegji Penal, është shprehur:<sup>95</sup>

*“Gjykata haptas, në kundërshtim me të dhënat, dokumentet e administruara pranon në vendim se nuk ekzistojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 228 të K.Pr.Penale se nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova... Në ngarkim të të gjithë të pandehurve ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova se ata kanë kryer veprën penale të trafikimit të mjeteve motorike dhe se ndaj tyre duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg, e kërkuar nga prokurori”.* Gjykata që shqyrton ankimin, vendos, sipas rastit, shfuqizimin d.m.th prishjen, ndryshimin ose miratimin e vendimit. Në disa vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur ndryshimi i vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke e zëvendësuar atë masë me atë të arrestit në shtëpi ose me masë tjetër. Ndryshimi i vendimit për masën e sigurimit nga gjykata që shqyrton ankimin, duke caktuar një tjetër më të rëndë, mund të bëhet vetëm kur ka ankim të prokurorit. Ky rregullim bazohet në parashikimet e ligjit procedural që përcakton se gjykata nuk mund të caktojë një masë siguri më të rëndë se ajo e kërkuar nga

<sup>95</sup> Shih Vendimi nr.122, datë 06.09.2001, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

prokurori<sup>96</sup> dhe se zëvendësimi i masës së sigurimit me një tjetër më të rëndë bëhet vetëm me kërkesën e prokurorit.<sup>97</sup> Duke u bazuar në kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>98</sup> ka pranuar rekursin e prokurorit dhe ka zëvendësuar masën e arrestit në shtëpi me atë të arrestit në burg. Në vendimin e Kolegjit analizohet rasti konkret dhe, pasi tregohen të metat e vendimit të gjykatës lidhur me caktimin e masës së sigurimit, arsyetohet: *“Kjo masë duhet caktuar duke pasur parasysh shkallën e nevojave të sigurimit, rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e veçantë të veprës si dhe mundësinë e ikjes së të pandehurit”*.

7. Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë. Vendimi i gjykatës që shqyrton

ankimin duhet të shpallet brenda afatit të caktuar për shqyrtimin e ankimit, që është 10 (dhjetë) ditë. Shkelja e këtij afati për masat shtrënguese sjell humbjen e fuqisë së tyre. Ky afat është i shkurtër dhe në kushtet e vështirësive aktuale për të bërë njoftimet ai kundërshtohet si i perealizueshëm. Një mendim i tillë është i gabuar sepse vjen ndesh me rëndësinë e veçantë që ka caktimi i masave të sigurimit, sidomos i atyre që lidhen me liritë personale dhe zgjidhjen e shpejtë të ankimeve që bëhen kundër tyre. Siç dihet, në bazë të nenit 417, paragrafi i dytë, ankimet kundër vendimeve që lidhen me lirinë personale nuk kanë efekt pezullues. Për rrjedhojë, procedura vazhdon, prandaj çdo zvarritje në shqyrtimin e ankimeve do ta bënte pa efekt ankimin, sepse mund të ndodhë, siç ka ndodhur në të vërtetë, që të përfundojë më përpara gjykimi në themel sesa shqyrtimi i ankimit për masën e sigurimit. Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë dhe, kur i pandehuri është i arrestuar, lirohet menjëherë.

<sup>96</sup> Shih neni 244 “Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit”, paragrafi 3, të K.Pr.Penale.

<sup>97</sup> Shih neni 260 “Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit”, paragrafi 3, të K.Pr.Penale.

<sup>98</sup> Shih Vendimi nr.478, datë 06.09.2001, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

8. Kundër vendimit të gjykatës sëapelit mund tëbëhet rekurs për shkelje tëligjit nëGjykatën e Lartë;
9. Me kalimin e gjashtë muajve nga zbatimi i vendimit tëarrestit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnëankim në gjykatën më të lartë ;
10. Gjykata e Lartëvendos brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e akteve.

Neni 250 “ Llogaritja e afateve të kohëzgjatjes së masave”, të K.Pr.Penale. Në këtë nën janë parashikuar rregullat për llogaritjen e afateve të kohëzgjatjes së masave të sigurimit.

1. Efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose i ndalimit. Në bazë të këtij paragrafi, efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimitose i ndalimit. Zakonisht kjo gjë ndodh në kohën që i arrestuari ose i ndaluari izolohet në dhomat e paraburgimit, por kur personit i hiqet liria dhe shoqërohet si i tillë forcërisht për në vendin e izolimit, efektet fillojnë nga çasti kur i hiqet liria dhe kohëzgjatja e kësaj gjendjeje varet nga largësia e vendit ku është hequr liria me vendin ku mbahen të paraburgosurit.
2. Kur i pandehuri është paraburgosur për një vepër penale tjetër, efektet e masës fillojnë të ecin nga dita në të cilën është njohur vendimi.Duke qenë që i pandehuri është i paraburgosur, vendimi i arrestit për një vepër zbatohetduke iu njoftuar, me kusht që data e këtij njoftimi të dokumentohet. Përcaktimi i datës së njoftimit është i rëndësishëm, sepse mund të ndodhë që i pandehuri të lirohet nga burgu për veprën tjetër dhe afati i paraburgimit për masën e mëvonshme do të fillojë nga dita që është bërë ky njoftim.

3. Efektet e masave të tjera fillojnë të ecin nga çasti në të cilin vendimi është njoftuar. Efektet e masave të tjera, të ndryshme nga arresti në burg, fillojnë të ecin nga çasti në të cilin vendimi është njoftuar, sepse zbatimi i tyre bëhet nëpërmjet njoftimit.
4. Kur ndaj një të pandehuri janë dhënë disa vendime që caktojnë të njëjtën masë për të njëjtin fakt, afatet fillojnë të ecin nga dita në të cilën është zbatuar ose njoftuar i pari. Kjo mund të ndodhë atëherë kur, gabimisht, prokurorë të rretheve të ndryshme kanë kërkuar nga gjykatat e rretheve përkatëse caktimin e masës së sigurimit për të njëjtin fakt dhe, duke mos e ditur këtë fakt, gjykatat vendosin të njëjtën masë sigurimi. Kur është fjala për arrestin në burg kuptohet që afatet do të fillojnë nga dita në të cilën është zbatuar vendimi i parë.

## **2.5. Arrestimi nëflagrancë dhe ndalimi i tëdysshuarit**

Në rastet e arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të të dypshuarit për kryerjen e një krimi janë caktuar rregulla të veçanta për mënyrën e caktimit të masës së sigurimit. Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi i të dypshuarit për kryerjen e një krimi janë veprime me iniciativë të Policisë Gjyqësore dhe të prokurorit, që kryhen në rastet dhe kushtet e parashikuara në kreun III të titullit V të Kodit të Procedurës Penale. Arrestimi në flagrancë kryhet kur ekzistojnë kushtet dhe kriteret e

flagrancës, kurse ndalimi zbatohet vetëm në rastin e rrezikut të ikjes së personit që dyshohet për kryerjen e një krimi.

Në mbështetje të këtij aspekti, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar:<sup>99</sup> *“Kolegji i tërheq vëmendje gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, e cila e ka konsideruar arrestimin në flagrancë si masë sigurimi. Një masë e tillë sigurimi nuk njihet nga K.Pr.Penale, por arrestimi në flagrancë është veprim me initiative i organit procedues që konfirmohet i ligjshëm ose jo nga gjykata”*.

---

<sup>99</sup> Shih Vendimi nr. 489, datë 12.12.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Nga qëllimet që ndjekin dhe pasojat që sjellin, arrestimi në flagrancë dhe ndalimi duken si masa sigurimi, sepse, në të vërtetë, nëpërmjet tyre realizohet kapja e të dyshuarit dhe izolimi i tij. Megjithatë ato nuk janë masa sigurimi, por veprime procedurale që diktohen nga rrethanat konkrete, të flagrancës apo të ikjes. Ato janë veprime me iniciativë të Policisë Gjyqësore, të kontrolluara nga prokurori, të autorizuar nga ligji procedural. Rrethanat e flagrancës dhe të ikjes e bëjnë të pamundur zbatimin e rregullave të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit nga gjykata, prandaj ligji ka lejuar kryerjen e këtyre veprimeve procedurale nga Policia Gjyqësore. Vetëm pasi vleftësohen nga gjyqtari në seancë gjyqësore, me kërkesë të prokurorit, ndaj të arrestuarit apo të ndaluarit caktohet masa e sigurimi.

### **2.5.1. Arrestimi nëflagrancë**

Në rastet e flagrancës arrestimi kryhet nga oficerët dhe agentët e Policisë Gjyqësore duke respektuar kriteret dhe rregullat e caktuara në nenet 251 deri 259 të Kodit të Procedurës Penale. Procedura për zbatimin e kësaj mase është e ndryshme nga ajo që ndiqet në përgjithësi për caktimin e masave të sigurimit. Në këtë rast gjykata cakton masën e sigurimit vetëm pasi vleftëson arrestimin e kryer nga Policia Gjyqësore.

Që të kryhet një arrestim në flagrancë nga Policia Gjyqësore duhet:

1. Të mbahen parasysh kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masave të sigurimit;
2. Të ekzistojë gjendja e flagrancës;
3. Të jetë kryer një vepër penale nga ato që tregohen në nenin 251 të Kodit të Procedurës Penale.

Për kushtet dhe kriteret e përgjithshme të caktimit të masave të sigurimit si dhe për kriteret e veçanta të caktimit të arrestit në burg kemi folur hollësisht më lart. Ato janë përcaktuar

në nenet 228 deri 230 të Kodit të Procedurës Penale dhe janë të detyrueshme edhe për arrestin në flagrancë. Kështu, kur akti nuk përbën veprë penale, kur ka shkaqe padënueshmërie ose kur mungon dyshimi i arsyeshëm, personi i kapur në flagrancë nuk mund të arrestohet. Një i mitur që ka kryer një kundërvajtje penale nuk mund të arrestohet edhe pse është kapur në flagrancë. Po kështu, një grua shtatzënë nuk mund të arrestohet, me përjashtim të rastit kur akuzohet për një krim që dënohet jo më pak në maksimum se 10 (dhjetë) vjet burgim dhe ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për izolimin e saj. Pra kur ekzistojnë njëkohësisht të dyja këto kushte : *rëndësia e veprës dhe nevoja e veçantë e sigurimit.*

Neni 251 „ *Arrestimi nëflagrancë* ”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Oficerët dhe agentët e policisëgjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo qëkapet në flagrancëpër njëkrim më dashje, tëkryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet;

Arrestimi në flagrancë kushtëzohet nga rëndësia e veprës penale. Kur autori i veprës akuzohet për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet burgim, oficerët dhe agentët e policisë janë të detyruar të bëjnë arrestimin në flagrancë. Kuptohet që në këtë rast ata nuk kanë të drejtë të bëjnë vlerësim tjetër nga ai që ka bërë vetë ligji, prandaj detyrohen të bëjnë arrestin.

Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për gjykatën që shqyrton kërkesën e prokurorit për zhvlerësimin e arrestit. Ajo vendos në përputhje me kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit, duke i ballafaquar ato me rastin konkret. Ndaj një të sëmuri apo të moshuari ajo mund të vendosë arrestin në shtëpi, edhe pse ka kryer një krim të rëndë.

2. Oficerët dhe agentët e policisëgjyqësore kanë të drejtë të arrestojnëcilindo qëkapet nëflagrancëpër njëkrim me dashje, tëkryer ose tëmbetur nëtentativë , për tëcilin ligji cakton dënimin me burgim jo më tëulë t nëmaksimum se dy vjet ose për njëvepër penale tëkryer nga pakujdesia, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më tëulët nëmaksimum se dhjetë vjet.

Ndryshe veprohet nga Policia Gjyqësore kur është fjala për vepra penale me rrezikshmëri më të vogël. Në këto raste oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore nuk janë të detyruar të arrestojnë, por duhet të bëjnë vlerësim të gjithanshëm të rrethanave të faktit, të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të saj. Vetëm mbi këtë bazë ato duhet të vendosin nëse është rasti për të zbatuar ose jo arrestin në flagrancë.

3. Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak tërëndësisë së faktit ose tërrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.

Këtu është fjala për rastet në të cilat nevoja e sigurimit është e madhe, siç mund të ndodhë në veprat penale që mund të bëhen shkak për vepra të tjera ose kur, duke qenë i lirë, subjekti mund të thellojë pasojat e veprës etj. Pra mund të ndodhë të kryhet arrestimi në flagrancë edhe ndaj atij që ka kryer një kundërvajtje penale me dashje kur, për shkak të karakterit të veprës apo të rrezikshmërisë së tij, kjo masë shihet e domosdoshme. Por për këto raste ligji kërkon që oficeri apo agjenti i policisë ta motivojë veprimin e tij me akt të veçantë.

4. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin në flagrancë duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep njëkopje të tij.

Me qëllim që të luftohen krimet e dukshme me rrezikshmëri të madhe në këtë paragraf është parashikuar që çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për një krim me dashje që ndiqet kryesisht, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet. Në këtë rast arrestimi nënkupton heqjen e lirisë me çdo mënyrë qoftë për një kohë sa më të shkurtër dhe dorëzimin pa vonesë në Policinë

Gjyqësore. Marrja në dorëzim e të arrestuarit bëhet me procesverbal që mbahet nga oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, një kopje e të cilit i jepet atij që ka kryer arrestimin.

Neni 252 “Gjendja e flagrancës”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Është në gjendje flagrancë ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket qartë se ka kryer veprën penale.

Gjendja e flagrancës, si kusht për kryerjen e arrestimit në flagrancë, kushtëzohet nga disa faktorë. Nga zbatimimi i përmbajtjes së këtij neni, del se është në gjendje flagrancë ai që:

- a) është kapur në kryerje e sipër të veprës penale. Në këtë rast problemi është i qartë, sepse autori i veprës penale është parë dhe është kapur në vendin e kryerjes së veprës:
- b) menjëherë pas kryerjes së veprës penale ndiqet nga Policia Gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë.

Edhe në këtë rast përsëri është fjala për vepra të dukshme dhe autori është parë, por nuk është kapur, prandaj ndiqet. Gjendja e flagrancës do të vazhdojë për aq kohë sa zgjat ndjekja e

pandërprerë e autorit të veprës dhe, si kohëzgjatje, ajo mund të jetë disa orë, kurse, në raste të veçanta, edhe disa ditë. E rëndësishme është që ndjekja të jetë e pandërprerë dhe kapja e atij që ndiqet të mos njehet me gjetjen e atij që kërkohet, sepse dyshohet që ka kryer një veprë penale.

- c) është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Gjendja e flagrancës për shkak të kapjes me sende dhe prova materiale rezulton në momentin e kapjes. Ajo mund të ndodhë gjatë kontrollit personal, kontrollit të banesës, të zyrës, të makinës etj.



Neni 253 “Ndalimi i të dyshuarit për një krim”, i Kodit të Procedurës Penale:

Ndalimi i të dyshuarit për një krim nuk është i njëjtë me ndalimin që parashikohet nga Kodi i mëparshëm. Ai lidhet gjithmonë me flagrancën dhe kthehet në arrest, si masë sigurimi, me vendim të prokurorit, pa u kushtëzuar me ikjen për t’i shpëtuar procedimit, kurse ndalimi sipas Kodit të ri nuk lidhet me flagrancën, por me dyshimin për kryerjen e një krimi dhe me rrezikun e ikjes.

Ky kuptim i gabuar i ndalimit dhe dëshira për t’i dhënë mundësi prokurorit që të caktonte vetë masa sigurimi, u reflektua në ligjin nr.8175, datë 23.12.1996, “Për disa

ndryshime në ligjin nr. 7855, datë 27.01.1995, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, u bë një përpjekje e gabuar për të ndryshuar kuptimin kushtetues të ndalimit. Në këtë ligji u sanksionua:<sup>100</sup>

*“Për veprat penale të parashikuara nga ky ligj, organet që bëjnë ndalimin e autorëve të veprave penale brenda 48 orëve, duhet t’i kërkojnë prokurorit nxjerrjen e urdhrin për arrestimin e personave të ndaluar, i cili, menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, vendos arrestimin ose lirimin e tyre”.*

Gjykata e shkallës së parë, pas kalimit të 5(pesë) ditëve nga nxjerrja e urdhrin të arrestimit, me kërkesën e prokurorit ose në bazë të ankimit të personit të arrestuar, vlerëson urdhrin e arrestimit.

---

<sup>100</sup> Shih neni 43 të ligjit nr.8175, datë 23.12.1996, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7855, datë 27.01.1995, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Në rast se kundër vendimit të gjykatës për lirimin e personit të arrestuar bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë nga ana e prokurorit, atëherë vendimi për lirimin e menjëhershëm të personit të arrestuar pezullohet deri në marrjen e vendimit nga ana e gjykatës që shqyrton apelin ose rekursin e drejtpërdrejtë”.

Gjykata Kushtetuese, e ka shfuqizuar nenin 43 si antikushtetues me këtë arsyetim:<sup>101</sup> *“Përmbajtja e kësaj dispozite vjen në kundërshtim me nenin 5 të ligjit kushtetues nr. 7692, datë 31.03.1993, ku thuhet: “Askush nuk mund të mbahet i ndaluar më tepër se 48 orë”. Ky hark kohor fillon nga çasti i ndalimit dhe mbaron në çastin e vlerësimit të masës së sigurimit nga ana e gjykatës, gjë që ka gjetur pasqyrim të plotë edhe në dispozitat e neneve 257, 258 e 259 të Kodit të Procedurës Penale. Edhe më e theksuar bëhet shkelja e këtij ligji kushtetues si rezultat i formulimit jo të saktë të paragrafëve të tjerë të nenit 43...Siç del nga përmbajtja e paragrafit të dytë, duhet të kalojnë edhe 5 (pesë) ditë të tjera nga çasti i nxjerrjes së urdhrin të arrestimit, që gjykata të bëjë vlerësimin e tij.*

Është më se e qartë, thuhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se pezullimi i këtyre vendimeve gjyqësore,<sup>102</sup> përbën një nga shkeljet më flagrante të së drejtës së lirisë dhe të

sigurisë, të parashikuar nga neni 5 i ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993, dhe neni 5 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriu. Pas vendimit për lirimin nga gjykata, personi nuk mund të mbahet në gjendjen e privimit të lirisë. Një konkluzion i tillë del nga vetë përmbajtja e nenit 5 të ligjit kushtetues, i cili ka gjetur pasqyrim të plotë në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Madje, sipas këtyre dispozitave, personi i ndaluar ose i arrestuar duhet të lirohet menjëherë edhe në rastet kur gjykata nuk arrin të bëjë vlerësimin e këtyre masave brenda 48 orëve”.

<sup>101</sup> Shih Vendimi nr.58, datë 05.12.1997, të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>102</sup> Shih paragrafi 4 të nenit 43.

Ndalimi i të dyshuarit për një krim nuk duhet të ngatërrohet me shoqërimin dhe mbajtjen deri dymbëdhjetë orë në zyrat e policisë të personit që refuzon të identifikohet ose që jep dokumente identifikimi që dyshohet se janë të rreme.<sup>103</sup> Në këtë rast ka dyshime për identitetin, kurse në rastin e ndalimit personi është i identifikuar, por dyshohet se ka kryer një krim.

Për ndalimin e të dyshuarit për një krim zbatohen njëloj të gjitha rregullat e caktuara për arrestimin në flagrancë, për të cilat u fol më lart. Prokurori detyrohet ta verifikojë atë dhe të paraqesë kërkesë për vleftësim tek gjyqtari brenda 48 orëve.

1. Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet;

Ndalimi i të dyshuarit për një krim, i tillë është personi që dyshohet se është autor i një krimi të caktuar, për të cilin ligji cakton dënime me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet burg dhe që ka rrezik të ikjeje. Kërkohej ekzistenca e njëkohshme e dy kushteve: së pari, dyshimi se personi është autor i një krimi që dënohet jo më pak se dy vjet burgim dhe, së dyti, ekzistenca e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes së tij.

Kuptohet që i tillë është edhe ai që në të vërtetë ka ikur pas kryerjes së veprës penale dhe kërkohej për t'u proceduar penalisht. Mungesa e njërit nga këto shkaqe e bën ndalimin të paligjshëm. Prandaj duhet konsideruar e gabuar praktika që ndjek prokuroria, duke bërë ndalime, pa qenë rreziku i ikjes. Ka ndodhur që personi është ndaluar në shtëpinë e tij edhe pse ka qenë me masë sigurimi të caktuar nga gjykata, në vend që të kërkohej ndryshimi i masës së sigurimit.

---

<sup>103</sup> Shih Neni 295 "Identifikimi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet", të K.Pr.Penale.

Gjykata e shkallës së parë, pas kalimit të 5 ditëve nga nxjerrja e urdhrin të arrestimit, me kërkesën e prokurorit ose në bazë të ankimit të personit të arrestuar, vlerëson urdhrin e arrestimit.

Në rast se kundër vendimit të gjykatës për lirimin e personit të arrestuar bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë nga ana e prokurorit, atëherë vendimi për lirimin e menjëhershëm të personit të arrestuar pezullohet deri në marrjen e vendimit nga ana e gjykatës që shqyrton apelin ose rekursin e drejtpërdrejtë”.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.58, datë 05.12.1997, e ka shfuqizuar nenin 43 si antikushtetues me këtë arsyetim: *“Përmbajtja e kësaj dispozite vjen në kundërshtim me nenin 5 të ligjit kushtetues nr. 7692, datë 31.03.1993, ku thuhet: “Askush nuk mund të mbahet i ndaluar më tepër se 48 orë”. ...Ky hark kohor fillon nga çasti i ndalimit dhe mbaron në çastin e vlerësimit të masës së sigurimit nga ana e gjykatës, gjë që ka gjetur pasqyrim të plotë edhe në dispozitat e neneve 257, 258 e 259 të Kodit të Procedurës Penale. ... Edhe më e theksuar bëhet shkelja e këtij ligji kushtetues si rezultat i formulimit jo të saktë të paragrafëve të tjerë të nenit 43...Siç del nga përmbajtja e paragrafit të dytë, duhet të kalojnë edhe 5 ditë të tjera nga çasti i nxjerrjes së urdhrin të arrestimit, që gjykata të bëjë vlerësimin e tij.*

Është më se e qartë, thuhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se pezullimi i këtyre vendimeve gjyqësore (sipas paragrafit të katër të nenit 43), përbën një nga shkeljet më flagrante të së drejtës së lirisë dhe të sigurisë, të parashikuar nga neni 5 i ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993, dhe neni 5 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut...Pas vendimit për

lirimin nga gjykata, personi nuk mund të mbahet në gjendjen e privimit të lirisë... Një konkluzion i tillë del nga vetë përmbajtja e nenit 5 të ligjit kushtetues, i cili ka gjetur pasqyrim të plotë në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Madje, sipas këtyre dispozitave, personi i ndaluar ose i arrestuar duhet të lirohet menjëherë edhe në rastet kur gjykata nuk arrin të bëjë vlerësimin e këtyre masave brenda 48 orëve”.

1. Policia gjyqësore kryen ndalimin me iniciativën e vet kur nuk është e mundur, për shkak të gjendjes së ngutshme, të pritët urdhri i prokurorit.

Ndalimi i të dyshuarit kryhet nga Policia Gjyqësore me urdhër të prokurorit. Urdhri duhet të jepet me shkrim dhe të jetë i argumentuar. Policia Gjyqësore kryen ndalimin me iniciativën e vet kur, për shkak të gjendjes së ngutshme, nuk është e mundur të pritët urdhri i prokurorit.<sup>104</sup> Në këtë rast akti i ndalimit duhet të tregojë gjendjen e ngutshme që bëri të pamundur marrjen e urdhrit të prokurorit.

Kur personi i larguar kapet më vonë, pra jo menjëherë pas kryerjes së veprës penale, ai do të ndalohej si i dyshuar për kryerjen e një krimi, me urdhër të prokurorit ose me iniciativën e Policisë Gjyqësore në rast se, për shkak të gjendjes së ngutshme, nuk mund të pritët urdhri i prokurorit. Në një rast të tillë nuk do të kemi arrestin në flagrancë, por ndalimin e të dyshuarit për kryerjen e një krimi.

Gjykata e Lartë është shprehur:<sup>105</sup> *“nga hetimet e bëra për procedimin penal nr.283 është krijuar baza e nevojshme e të dhënave se ky shtetas ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 143/1 e 25 të Kodit Penal, vjedhje e pasurisë anë të mashtrimit në bashkëpunim. Avokati i të ndaluarit ka pretenduar se mungojnë elementët e veprës penale, nuk ekzistojnë*

*kriteret e nenit 253 të Kodit të Procedurës Penale, klienti i tij nuk ka marrë njoftimin e akuzës, ai nuk është marrë si pandehur. Prokurori i Durrësit bazuar në nenin 253/1 të Kodit të Procedurës Penale ka nxjerrë urdhrin për ndalimin e shtetasit V.Q për veprimin e mësipërm, me arsyetimin se në ngarkim të tij ekzistonin të dhëna të mjaftueshme dhe bindëse se ai kishte kryer në bashkëpunim dhe me të tjerë, veprën penale të vjedhjes me anë mashtrimi*

<sup>104</sup> Shih neni 253 “Ndalimi i të dyshuarit për një krim”, të K.Pr.Penale.

<sup>105</sup> Shih Vendimin Unifikues nr. 3/2002, të Gjykatës së Lartë.

tëparashikuar nga nenet 143/1 dhe 25 të Kodit Penal dhe se ekzistonte rreziku që ai t'i fshihej hetimit dhe gjykimit”.

Neni 254 “Moslejimi i arrestimit dhe i ndalimit në rrethana të caktuara”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Arrestimi dhe ndalimi nuk lejohet kur nga rrethanat e faktit del se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyre ose gjatë ushtrimit tënjë të drejte të ligjshme ose kur ekziston njëshkak padënueshmërie.

Para rasteve të tilla mund të ndodhemi kur, polici godet me armë dhe plagos apo vret atë që ka kryer veprën penale dhe tenton të largohet apo të kryejë vepra të tjera. Po kështu, nuk mund të arrestohet edhe ai që është në kushtet e mbrojtjes së nevojshme ose të nevojës ekstreme. Kuptohet që këto shkaqe duhet të jenë të qarta dhe evidente, përndryshe oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore duhet të kryejnë arrestin dhe të vazhdojnë grumbullimin e provave.

Neni 255 “Detyrat e policisë gjyqësore në rastet e arrestimit ose ndalimit”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim ose kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, njoftojnë menjëherë prokurorinë e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Ata i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklaratë dhe në qoftë se do të flasë, çfarë do që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori;

Në këtë nen janë përcaktuar në detaje detyrat e oficerëve dhe të agjentëve të Policisë Gjyqësore në rastet e arrestimit në flagrancë dhe të ndalimit të të dyshuarit për kryerjen e një

krimi. Oficerët dhe agjentët duhet të dokumentojnë arrestimin apo ndalimin me akt të veçantë, në të cilin të tregojnë me saktësi vendin, ditën dhe orën e arrestimit apo të ndalimit, gjeneralitetet e të arrestuarit apo të të ndaluarit, veprën që ka ndodhur dhe të dhënat që e vërtetojnë atë. Akti nënshkruhet nga pjesëmarrësit dhe, bashkë me të dhënat e tjera, i dërgohet prokurorit.

Përcaktimi i saktë i orës kur është kryer arrestimi apo ndalimi ka rëndësi të veçantë, sepse llogaritja e afateve për paraqitjen e kërkesës për vleftësimin e tyre dhe për caktimin e masës së sigurimit bëhet me orë.

Oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore detyrohen të njoftojnë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi apo ndalimi. Njoftimi duhet të jetë i saktë dhe i menjëhershëm me qëllim që t'i jepet mundësia prokurorit që, brenda 48 orëve, të marrë në pyetje të arrestuarin, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të paraqesë në gjykatë kërkesën për vleftësimin e arrestit. Çdo vonesë në zbatimin e kësaj detyre mund të sjellë si pasojë humbjen e efektit të masës për shkak të plotësimit të afatit të përmendur.

Oficeri apo agjenti i Policisë Gjyqësore që ka kryer arrestimin apo ndalimin e të dyshuarit për kryerjen e një krimi, i bën të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim tëbëjë deklarata dhe, në qoftë se do të flasë, çfarëdo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim.

Oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori.

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore e vënë të arrestuarin ose të ndaluarin nëdispozicion tëprokurorit, nëdhomat e paraburgimit, sa më shpejt, nëpërmjet dërgimit tëprocesverbalit përkatës;

Në kohën më të shkurtër, oficeri ose agjenti i policisë që ka kryer arrestimin në flagrancë e vë të arrestuarin në dispozicion të prokurorit dhe i dorëzon atij procesverbalin e arrestimit dhe dokumentet e tjera që lidhen me ngjarjen.

1. Kur i arrestuari ose i ndaluar është i sëmurë ose i mitur, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të ruajtur;

Kur i arrestuari është i sëmurë ose i mitur, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të sigurt që ruhet. Kjo është një masë provizore që zgjat deri në shqyrtimin e masës së sigurimit nga gjykata, pra jo më shumë se dyzet e tetë orë.

1. Policia gjyqësore, me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët. Kur i arrestuari ose i ndaluar është i mitur lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari.

Me pëlqimin e të arrestuarit, Policia Gjyqësore duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët, për arrestimin dhe vendndodhjen e të arrestuarit apo të ndaluarit. Kur i arrestuari është i mitur, lajmërimi i prindit ose kujdestarit është i detyrueshëm.

Neni 256 “*Marrja nëpyetje e të arrestuarit ose të ndaluarit*”, i Kodit të Procedurës penale:

1. Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin nëprani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarit ose të ndaluarit faktin për

të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat nën garkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet.

Prokurori e merr në pyetje të arrestuarin ose të ndaluarin në praninë e mbrojtësit të tij, të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Fillimisht, ai i njofton të arrestuarit ose të ndaluarit faktin për



të cilin është proceduar dhe arsyet e marrjes në pyetje. Prokurori i tregon të arrestuarit ose të ndaluarit të dhënat në ngarkim të tij, duke u bazuar në dokumentet që ka plotësuar Policia Gjyqësore. Kur nuk u shkaktohet dëm hetimeve, prokurori i tregon të arrestuarit edhe burimet e këtyre të dhënave, pra edhe nga cilët janë marrë ato.

Marrja në pyetje e të arrestuarit apo e të ndaluarit nga prokurori bëhet me procesverbal, në të cilin tregohet vendi, koha, pjesëmarrësit në pyetje, pyetjet e prokurorit dhe të mbrojtësit dhe deklaratimet e të arrestuarit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit.

Në bazë të Kushtetutës,<sup>106</sup> i arrestuari ose i ndaluar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase si dhe për akuzën që i bëhet.

Duhet të jetë e qartë se ky njoftim apo informacion nuk është i njëjtë me njoftimin e akuzës që i bëhet të pandehurit, sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin e parë njoftimi bëhet nga oficeri apo agjenti i policisë që kryen një arrestim në flagrancë, ndalon një të dyshuar apo ekzekuton një vendim të gjyqtarit për arrestimin e një personi, njoftim ky që ka si qëllim t'i bëjë të ditur verbalisht, me pak fjalë, personit të arrestuar apo të ndaluar shkakun pse arrestohet apo ndalohet dhe të drejtat kryesore që i njeh ligji. Në rastin e dytë njoftimi bëhet, si rregull, nga prokurori dhe me autorizim të tij nga oficeri i policisë. Ky njoftim bëhet me akt, “*në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur*”.<sup>107</sup>

Duke shpjeguar këtë dallim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se, në rastin e arrestimit dhe të ndalimit nga policia, “*informacioni i dhënë nuk ka nevojë të jetë po aq i hollësishëm sa ai i parashikuar nga neni 6/3 i Konventës*”, i cili parashikon të drejtën e të pandehurit që “*të informohet për natyrën dhe shkakun e akuzës që bëhet kundër tij*”.<sup>108</sup>

<sup>106</sup> Shih neni 28 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

<sup>107</sup> Shih neni 34 “Marrja e cilësisë së të pandehurit”, të K.Pr.Penale.

<sup>108</sup> Çështja “Van den Leer k.Vendeve të Ulëta”, viti 1990, Gj.E.D.Nj.

Nga ky dallim bëhet e qartë se për arrestimin dhe ndalimin nuk kërkohet paraprakisht njoftimi i akuzës apo marrja si i pandehur dhe, përgjithësisht, se arrestimi dhe ndalimi kryhen përpara këtij njoftimi, i cili mund të bëhet në fillim, në mes apo në fund të hetimeve paraprake, atëherë kur ekzistojnë “*të dhëna të mjaftueshme*”.

Neni 257 “*Rastet e lirimt të menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Kur del e qartëse arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi ose nuk janë respektuar kërkesat e ligjit ose kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vleftësimin e masës, prokurori urdhëron, me vendim të motivuar, që i arrestuari ose i ndaluarit të lirohet menjëherë. Në këto raste lirim i urdhërohet edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili njofton menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Në këtë nen janë parashikuar rastet kur prokurori dhe Policia Gjyqësore janë të detyruar të vendosin lirim të menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit. Këto raste janë:

- a) kur arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi, pra nuk është ai që mendohej;
- b) kur nuk janë respektuar kërkesat e ligjit, pra kushtet dhe kriteret për të cilat u fol më lart;
- c) kur shkelet afati i paraqitjes së kërkesës në gjykatë për vleftësimin e arrestimit apo të ndalimit, pra kur kalojnë 48 (dyzet e tetë) orë nga momenti i arrestimit apo i ndalimit.

Neni 258 “*Kërkesa e vleftësimit të arrestimit ose ndalimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

Kur nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, prokurori, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës nëgjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë.

Kur prokurori bindet se arrestimi apo ndalimi është i bazuar në prova e në ligj, kërkon vleftësimin e ligjshmërisë së arrestimit apo të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit nga gjykata. Kërkesa paraqitet në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi apo ndalimi brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i arrestimit ose ndalimit. Në qoftë se nuk arrihet të konkludohet brenda këtij afati, i arrestuari apo i ndaluari lirohet. Në një rast të tillë prokurori ka të drejtë që, sapo të ketë siguruar të dhënat e nevojshme, të bëjë kërkesë tek gjyqtari për caktimin e masës përkatëse të sigurimit, sipas rregullave të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit.<sup>109</sup>

Gjyqtari shqyrton aktet dhe merr vendimin, duke respektuar kërkesat e nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale.

Afati i paraqitjes së kërkesës për vleftësimin e arrestit apo të ndalimit fillon nga çasti kur të arrestuarit apo të ndaluarit i hiqet liria, kur izolohet kudoqoftë dhe jo nga çasti i mbylljes në dhomat e paraburgimit, siç mendohet nga disa. Pra, edhe kur arrestimi kryhet në një fshat që

është disa orë larg qendrës së rrethit, ky afat fillon nga çasti kur oficeri apo agjenti i Policisë Gjyqësore ka kryer arrestimin në fshat. Është detyra e tyre të njoftojnë menjëherë prokurorin dhe të marrin në dispozicion çdo mjet të përshtatshëm për të shpejtuar verifikimin dhe vleftësimin e arrestit.

---

<sup>109</sup> Shih neni 244 “Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit”, të K.Pr.Penale.

Afati i shkurtër për paraqitjen e të arrestuarit apo të ndaluarit tek gjyqtari është një standard i njohur dhe i pranuar përgjithësisht. Në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut thuhet se çdo person i arrestuar “*duhet të çohet brenda një afati sa më të shkurtër përpara një gjyqtari...*”.<sup>110</sup> Ndonëse Konventa nuk ka vendosur një afat minimal të përcaktuar, Gjykata Evropiane në jurisprudencën e saj është shprehur se: “*Katër ditë dhe gjashtë orë është një periudhë tepër e gjatë për të qenë në rregull me standardin, pavarësisht nga vështirësitë e veçanta që lidhen me hetimin e akteve të terrorizmit*”.<sup>111</sup>

Detyrimi i prokurorit për ta dërguar të arrestuarin, brenda 48 orëve përpara gjyqtarit është një rregull që buron nga e drejta për një Habeas Corpus,<sup>112</sup> që nënkupton trupin e personit të arrestuar apo të ndaluar, i cili duhet të paraqitet para një gjyqtari që të shqyrtojë vlefshmërinë e arrestimit apo të ndalimit.

Ky parim është shkruar për herë të parë më 1215-n, në Angli, në Magna Karta, kur u parashikua që “*asnjë person i lirë nuk do të konfiskohet ose të burgoset ... përveçse me një vendim të ligjshëm të të barabartëve me të (jurisë) ose sipas ligjit të vendit*”. E drejta për Habeas Corpus do të thotë, se para se personi të burgoset për më shumë se një minimum kohë, një gjyqtar i paanshëm duhet të shqyrtojë vlefshmërinë e burgosjes. I arrestuari apo i ndaluari duhet të paraqitet para një gjyqtari dhe shteti duhet të paraqesë arsyet ligjore të arrestimit. Në

qoftë se gjyqtari konstaton se i akuzuari është arrestuar në mënyrë të paligjshme, ai lirohet. Në këtë mënyrë kontrolli mbi të drejtën e arrestimit u besohet gjykatave, një degë e qeverisjes që ka pak të ngjarë të abuzojë me këtë kompetencë.

---

<sup>110</sup> Shih neni 5/3 të K.E.D.Nj.

<sup>111</sup> Shih çështjen “Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar”, të vitit 1988.

<sup>112</sup> Një term latin që do të thotë “ju keni trupin”.

1. Gjykata cakton seancën e vleftësimit sa më shpejt duke lajmëruar prokurorin dhe mbrojtësin.

Përdorimi i togfjalëshit “*sa më shpejt*”, tregon qartë se Kodi i Procedurës Penale respekton parimin e mbrojtur dhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, për një proces të rregullt ligjor. Shpejtësia procedurale nuk duhet kuptuar për ti bërë punët “shkel e shko” domethënë shpejt dhe pa cilësi, ajo do të thotë që duhet respektuar elementi kohë që nga arrestimi ose ndalimi i personit dhe deri në momentin e vleftësimit të tij. Kjo ka rëndësi pasi nuk mund t’i cenohet liria një personi pa u bazuar në ligj.

Neni 259 “*Seanca e vleftësimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Seanca e vleftësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër;

Në seancën e vleftësimit marrin pjesë domosdoshmërisht prokurori dhe mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri ose i caktuar kryesisht nga gjykata. I arrestuari njoftohet për të marrë pjesë, por refuzimi i tij për t’u paraqitur nuk pengon shqyrtimin e kërkesës. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër.

Kuptohet se pjesëmarrja e mbrojtësit është e domosdoshme kur i arrestuari nuk është paraqitur ose kur ai e kërkon mbrojtësin. Në rast se i arrestuari paraqitet dhe deklaron se nuk do që të ketë mbrojtës, sepse do të mbrohet vetë, seanca vazhdon normalisht, pa pjesëmarrjen e mbrojtësit. Mendimi i kundërt është jo i drejtë, sepse vjen në kundërshtim me rregullin e

përgjithshëm, të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, sipas së cilës i pandehuri ndihmohet nga mbrojtësi “*në qoftë se e kërkon atë*”.<sup>113</sup>

<sup>113</sup> Shih neni 49 “Mbrojtësi i caktuar”, i K.Pr.Penale.

2. Prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Pas kësaj gjykata dëgjon tëarrestuarin dhe mbrojtësin ose vetë m këtë të fundit, kur i arrestuari ose i ndaluari ka refuzuar të paraqitet. Provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim;

Seanca për vleftësimin e masës, fillon me paraqitjen e të dhënave dhe shkaqeve të arrestimit nga prokurori. Kuptohet se vlerë të veçantë kanë provat materiale, sendet që i përkasin veprës penale, deklaratimet dhe procesverbalet e mbajtura në çastin e flagrancës. Pas prokurorit dëgjohej i arrestuari, kur merr pjesë, mandej mbrojtësi i tij.

Është e kuptueshme që në seancë të vërtetohen kushtet e flagrancës, në rastin e arrestimit në flagrancë, apo të rrezikut të ikjes, për rastin e ndalimit, si dhe të paraqiten provat e nevojshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm që i arrestuari ose i ndaluari është autor i veprës penale. Vlerë të veçantë kanë provat materiale, gjurmët, këqyrjet, ekspertimet dhe dokumentet, por nuk përjashtohet edhe mundësia e marrjes së çdo lloj prove që kërkohet nga palët dhe ka rëndësi për zgjidhjen e drejtë të kërkesës që ka bërë prokurori.

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të paraqesin prova për të kundërshtuar akuzën si të pabazuar ose për të vërtetuar rrethana lehtësuese në favor të të pandehurit për të justifikuar mosmarrjen e masës së sigurimit ose caktimin e një mase më të butë se ajo që kërkon prokurori.

Është i gabuar mendimi, sipas të cilit në seancën e vleftësimin nuk vendoset për fajësinë e të pandehurit, prandaj nuk ka nevojë që të merren prova dhe se dyshimi i arsyeshëm nuk duhet

të kushtëzohet nga ekzistenca e provave. Për shkak të këtij mendimi ka prokuror që nuk paraqesin prova në seancë ose që vetëm i tregojnë ndonjë provë gjykatës, pa ia dorëzuar atë. Po kështu, ka gjyqtarë që nuk këmbëngulin në kërkesat e ligjit dhe nuk dokumentojnë si duhet seancën e vleftësimin dhe të caktimit të masës së sigurimit. Si prokurorët, ashtu edhe gjyqtarët

që veprojnë kështu, harrojnë që seanca e vleftësimit është seancë gjyqësore dhe duhet të zhvillohet sipas të gjitha rregullave të seancës gjyqësore të zakonshme, duke u marrë prova, duke i fiksuar ato në procesverbal, duke dëgjuar pretendimet e palëve dhe duke dhënë vendim të argumentuar në fakt e në ligj.

Në lidhje me këtë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar:<sup>114</sup> *“Në kuptim të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, për aplikimin e një mase sigurimi kërkohet vërtet një dyshim i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale, por, nga ana tjetër, ky dyshim i arsyeshëm duhet të mbështetet në prova dhe nuk duhet të jetë i supozuar”*.

Mbi bazën e provave të shqyrtuara dhe të debatit të palëve, gjyqtari vendos për pranimin ose jo të kërkesës së prokurorit për vleftësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit. Kur del se arrestimi është i bazuar në prova e në ligj, gjyqtarimerr vendim për vleftësimin e arrestit si të ligjshëm dhe cakton një masë sigurimi, që mund të jetë ajo që ka kërkuar prokurori ose një tjetër që gjykohet e përshtatshme për rastin e dhënë.

Por kemi të bëjmë më një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm,<sup>115</sup> në dispozitën ku shprehet se: *“Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”*. Dihet që masa e sigurimit caktohet me kërkesë të prokurorit, i cili njeh konkretisht nevojat e sigurimit dhe përshtatjen e tyre me interesat e hetimit. Për rrjedhojë, gjyqtari nuk ka arsye të tejkalojë kërkesën e prokurorit dhe të caktojë një masë sigurimi më të rëndë, e cila nuk është e nevojshme për nevojat e hetimeve që drejtohen nga prokurori.

Masa e sigurimit mund të jepet me afat vetëm në rastin e parashikuar në mënyrë eksplicite nga ligji procedural,<sup>116</sup> që ka të bëjë vetëm me rastet kur masa është urdhëruar për të

---

<sup>114</sup> Shih Vendimi nr.489, datë 12.12.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>115</sup> Shih neni 244/3 të K.Pr.Penale.

<sup>116</sup> Shih neni 245 “Vendimi i gjykatës”, gërma “c”.

garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës, të parashikuar nga neni 228, pika 3, germa a<sup>117</sup> dhe jo rastet e flagrancës. Është krejtësisht e gabuar që afati i masës së sigurimit të jepet për t'u dhënë kohë prokurorit dhe Policisë Gjyqësore që të gjejnë prova në ngarkim të të pandehurit, pasiduke vepruar në këtë mënyrë, i arrestuari mbahet në burg edhe pse nuk ka prova për të krijuar dyshimin e arsyeshëm se ai është autori i veprës penale.

Duke theksuar këtë kuptim të nenit 245 të K.Pr.Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>118</sup> ka shfuqizuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Berat dhe ka urdhëruar lirim të menjëhershëm të të arrestuarit S.S., me arsyetimin: *“Gjykata ka gabuar kur ka vendosur arrestimin me afat 20-ditor, duke mos pasur në konsideratë kërkesat e nenit 245 të K.Pr.Penale. Sipas këtij neni, germa “ç”, masa e sigurimit me arrest në burg mund të caktohet me afat vetëm atëherë kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës... Gjykata arsyeton se masa e sigurimit duhet dhënë me afat “për të verifikuar deri në fund pretendimet e të arrestuarit dhe për faktin se këto prova nuk janë shumë të plota”.* Një arsyetim i tillë, vazhdon vendimi i Kolegjit, nuk lidhet fare me konceptin e masës së sigurimit me kohëzgjatje të caktuar që parashikon neni 245, germa “ç” i K.Pr.Penale”.

3. Kur del se arrestimi apo ndalimi janë bërë në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e masës. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet apel në gjykatën më të lartë nga prokurori dhe i arrestuari ose i ndaluar dhe, kur ka kërkesë nga prokurori, gjykata cakton masën e sigurimit;

Në bazë të këtij paragrafi, akti i prokurorit duhet të përmbajë dy kërkesa: vleftësimin e arrestimit apo të ndalimit si të ligjshëm dhe caktimin e masës së sigurimit, që është e

<sup>117</sup> “Kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës”.

<sup>118</sup> Shih Vendimi nr.457, datë 20.07.2001, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



përshtatshme për rastin e dhënë, duke u argumentuar secila mbi bazën e provave dhe të dhënave për personin e arrestuar.

Në këtë rast gjyqtari vendos në një të një nga këto dy mënyra: Kur arrestimi apo ndalimi vleftësohet si i rregullt proceduralisht dhe vërtetohen kushtet për caktimin e masës së sigurimit, gjyqtari vendos ta caktojë atë sipas kërkesës së prokurorit ose më të lehtë, duke respektuar edhe kriteret e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.<sup>119</sup> Kur arrestimi apo ndalimi është kryer në përputhje me kërkesat procedurale, por nuk vërtetohen kushtet për caktimin e masës së sigurimit,<sup>120</sup> siç mund të jetë dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, gjyqtari e refuzon kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, pavarësisht se arrestimi në flagrancë, si veprim me iniciativë të Policisë Gjyqësore është vleftësuar si i ligjshëm.

4. Kur arrestimi apo ndalimi nuk është i ligjshëm, gjykata vendos lirin e menjëhershëm të të arrestuarit. Kundër vendimit mund të bëhet apel apo rekurs i drejtpërdrejtë nga prokurori;

Gjyqtari duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë të dyja kërkesat e prokurorit, duke u shprehur veças për secilën prej tyre. Kur konstatohet paligjshmëria e arrestimit në flagrancë apo e ndalimit për shkak se mungojnë kushtet e flagrancës apo rreziku i ikjes së të dyshuarit, ose kur ka kaluar afati i paraqitjes së kërkesës në gjykatë, gjyqtari duhet të shprehet për paligjshmërinë dhe të urdhërojë lirin e të arrestuarit apo të ndaluarit. Ndërkohë ai vazhdon seancën gjyqësore për të shqyrtuar pikën e dytë të kërkesës së prokurorit, atë për caktimin e masës së sigurimit,

---

<sup>119</sup> Shih neni 229 “Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal” dhe Neni 230 “Kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg”, të K.Pr.Penale.

<sup>120</sup> Shih neni 228 “Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal”, të K.Pr.Penale.

duke e lënë të paraburgosurin në seancë në gjendje të lirë. Kur vërtetohen kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, gjyqtari e cakton atë edhe pse arrestimi është vleftësuar i paligjshëm për shkak të shkeljeve procedurale.

Kundër vendimit për mënyrën e vleftësimit të arrestit në flagrancë apo të ndalimit dhe caktimit ose jo të masës së sigurimit, mund të bëhet ankimi në gjykatën e apelit. Por, siç kemi thënë edhe më lart, ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjyqtarit.

Në këtëparagraf dhe në nenin 259 nëtërësi, nuk është caktuar ndonjë afat për ankimin kundër vendimit të gjyqtarit për vleftësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit, si dhe për mënyrën e shqyrtimit të ankimit. Duke qenë se edhe në këtë rast vendimi i gjykatës cakton një masë sigurimi, zbatohen rregullat e parashikuara nga neni 249 i Kodit të Procedurës Penale për ankimin kundër vendimeve që caktojnë masat e sigurimit. Rregullat e caktuara në nenin 249 për afatin e ankimit kundër vendimit për caktimin e masës së sigurimit dhe mënyrën e shqyrtimit nga gjykata e apelit, për të cilat është folur më lart, zbatohen tërësisht nga gjykatat edhe në rastet e ankimit kundër vendimit për vleftësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit, sepse edhe në këtë rast vendimi i gjykatës cakton një masë sigurimi.

5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinëkur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk ështëshpallur brenda dyzet e tetëorëve tëardhshme nga çasti nëtëcilin kërkesa e prokurorit ështëparaqitur nëgjykatë .

Kur kërkesa paraqitet në afat, gjyqtari i caktuar për ta shqyrtuar atë cakton seancën e vleftësimit, e cila duhet të përfundohet brenda 48 orëve nga ora e regjistrimit të kërkesës në sekretarinë e gjykatës, me qëllim që të respektohet neni 28 i Kushtetutës që thotë se gjyqtari vendos paraburgimin ose lirimin e të arrestuarit apo të ndaluarit jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

Në goftë se vendimi i gjyqtarit për vleftësimin e masës së arrestit apo të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit nuk shpallet brenda 48 orëve nga ora e dorëzimit të akteve në

sekretarinë e gjykatës, arrestimi apo ndalimi e humbet fuqinë dhe i arrestuari apo i ndaluari lirohet. Kuptohet se, kur afati prej 48 orësh plotësohet para se të përfundojë shqyrtimi i të dhënave dhe debati i palëve, seanca vazhdon deri sa ato të përfundohen, por i arrestuari lirohet dhe merr pjesë në seancë në gjendje të lirë.

Mund të ndodhë që në seancën e vleftësimit të pretendohet *papërgjegjshmëria e të arrestuarit në flagrancë apo e të ndaluarit*. Kur kjo papërgjegjshmëri është e dukshme dhe e vërtetuar rregullisht, gjyqtari shprehet për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë apo të ndalimit dhe refuzon kërkesën për caktimin e masës së sigurimit. Por, në qoftë se ekspertët psikiatër thonë se lënia e tij e lirë është e rrezikshme për shoqërinë, gjyqtari vendos mbylljen e tij në spital.<sup>121</sup> Kur papërgjegjshmëria ka nevojë të vërtetohet, gjyqtari urdhëron kryerjen e ekspertimit psikiatrik dhe vendos mbylljen në spital psikiatrik, sipas rastit: si masë sigurimi kur ekzistojnë kushtet për caktimin e kësaj mase ose si izolim në bazë të ligjit “*Për shëndetin mendor*”, kur mungojnë kushtet për të caktuar masë sigurimi. Kur këto kushte mungojnë dhe izolimi i të arrestuarit nga shoqëria nuk është i nevojshëm, gjyqtari vendos lirin e tij.

Për shkak të ndryshimeve thelbësore midis Kodit të vjetër dhe Kodit të ri për mënyrën e caktimit të masave të sigurimit, në praktikën gjyqësore ka pasur paqartësi dhe, për pasojë, gjatë zbatimit të masave të sigurimit janë vërejtur gabime e keqkuptime. Me gjithë përmirësimet e arritura, kërkohet një punë e vazhdueshme sqaruese për një konceptim bashkëkohor të këtij instituti, që përbën aspektin më të rëndësishëm të procedimit penal.

## **2.6. Revokimi dhe shuarja e masave të sigurimit**

Revokimi, zëvendësimi dhe shuarja e masave të sigurimit kanë si qëllim të sigurohet në vazhdimësi përshtatshmëria e masave të sigurimit me kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre.

---

<sup>121</sup> Në bazë të ligjit nr.8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”.

Neni 260 “*Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre;

Mund të ndodhë që masa e sigurimit të caktuar të mos pajtohet me kushtet dhe kriteret e caktimit të saj. Kjo papajtueshmëri mund të ekzistojë që në kohën e caktimit të masës së sigurimit për shkak të vlerësimit të gabuar të kushteve dhe kriterëve të caktimit të saj. Në këtë rast revokimi imasës përbën korrigjimin e një gabimi dhe, si i tillë, ai duhet të bëhet edhe kryesisht nga gjykata në çdo gjendje të procedimit. Por, papajtueshmëria e masës së sigurimit me kushtet dhe kriteret për caktimin e saj mund të konstatohet më vonë, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktit ose të ligjit. Mund të ndodhë që, në vazhdim të procedimit, të dalë që vepra penale është kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme apo të nevojës ekstreme, ose që ndjekja penale është parashkruar, apo dispozita përkatëse e Kodit Penal është shfuqizuar, ose del që provat në të cilat ishte bazuar dyshimi i arsyeshëm, nuk janë të vërteta etj. Në këto raste, gjyqtari, me kërkesën e palëve ose edhe kryesisht, vendos revokimin e masës së sigurimit.

### **Jurisprudencë:**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>122</sup> ka shfuqizuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor të Mirditës<sup>123</sup> dhe ka revokuar masën e sigurimit të arrestit në burg për të pandehurin Gj.B, i cili akuzohej për krimin e vrasjes, me arsyetimin se nga verifikimi i provës, në të cilën ishte bazuar masa e sigurimit, kishte dalë se ajo nuk ishte e vërtetë. Në këtë vendim shprehimisht thuhet: “*Në kushtet kur ka rezultuar qartë se ekspertimi i kryer në shtetin italian nuk përcakton*

<sup>122</sup> Shih Vendimi nr.08, datë 3.01.2002.

<sup>123</sup> Shih Vendimi nr.109, datë 07.12.2001.

*qenien e të pandehurit si autor të mundshëm në kryerjen e veprës penale, nuk ekzistojnë më kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, të parashikuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal, në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Meqenëse mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të masave të sigurimit personal, në bazë të nenit 260/1 të K.Pr.Penale, masa e arrestit duhet revokuar”.*

Ndërsa në rastin e shqyrtimit të kërkesës së të pandehurit A.B, i cili akuzohej për krijim të organizatës për trafikim të lëndëve narkotike, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur një qëndrim tjetër, për revokimin e masës së arrestit në burg të caktuar nga gjykata e rrethit gjyqësor të Tiranës,<sup>124</sup> duke pretenduar se në marrjen e masës së sigurimit nuk ka pasur prova apo të dhëna të mjaftueshme dhe se masa e sigurimit është e padrejtë, pasi nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Kolegji Penal e ka refuzuar kërkesën me vendim,<sup>125</sup> në të cilin ka arsyetuar: *“Masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre.... Është detyrë e të pandehurit dhe e mbrojtësit të tij të paraqesin në gjykatë prova që vërtetojnë se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të masës së arrestit caktuar ndaj tij...(!?) Duke qenë para kërkesës për revokimin e masës së sigurimit arrest në burg nuk mund të bëhet analiza e provave mbi bazën e të cilave është caktuar ajo masë, as të kontestohet vendimi i marrë për caktimin e saj dhe as të diskutohet për provat që ka grumbulluar Prokuroria gjatë hetimit të çështjes. Analiza e tyre do të realizohet në përfundim nga organi i akuzës apo gjykata për të arritur në konkluzionet e nevojshme për bazueshmërinë ose jo të akuzës në ngarkim të të pandehurit”.*

Vlerësoj se ky qëndrim që ka mbajtur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i diskutueshëm, pasi nuk mund të thuhet se nuk mund *“të diskutohet për provat që ka*

<sup>124</sup> Shih Vendimi nr.142, datë 04.02.2001.

<sup>125</sup> Shih Vendimi nr.591, datë 1.11.2001.

*grumbulluar Prokuroria*”, pasi mund të ndodhë dhe këtë na i tregon praktika gjyqësore, që provat të jenë marrë në mënyrë të paligjshme ose të jenë përgënjeshtuar me prova të tjera, për interesa të caktuara. Gjithashtu, arsyetohet se nuk është e drejtë t’i kërkohet të pandehurit të vërtetojnë se mungojnë kushtet dhe kriteret për zbatimin e masës së arrestit.

Në çështjen me të pandehur A.H, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>126</sup> ka revokuar masën e sigurimit të arrestit në burg për këtë të pandehur, të caktuar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor të Tiranës,<sup>127</sup> me arsyetimin se: *“I pandehuri A.H. është kandiduar për deputet në Kuvendin e Shqipërisë në kohën që ndaj tij kishte filluar një procedim penal dhe ishte marrë masa e sigurimit me arrest në burg. Duke qenë se ndaj tij nuk ka pasur dhe nuk ka një vendim të formës së prerë që ta ketë deklaruar fajtor për veprën për të cilën është akuzuar, në bazë të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 4 të K.Pr.Penale, ai konsiderohet person i dyshuar për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet.... Zgjedhja e të pandehurit A.H. deputet në Kuvendin e Shqipërisë, bind gjykatën se kushtet e përmendura kanë ndryshuar dhe se nuk ekziston tashmë rreziku i ikjes dhe se nuk ka të dhëna që ky i pandehur mund të kryejë një veprë tjetër penale... Duke pranuar faktin se A.H. ka fituar imunitetin si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, gjykata nuk e sheh me vend të caktojë një masë tjetër sigurimi dhe pranon kërkesën e mbrojtjes për revokimin e masës së sigurimit... Sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë, çdo veprim i mëtejshëm procedural ndaj deputetit të akuzuar A.H. mund të ndërmerret nga gjykata vetëm pasi të jetë kërkuar më parë nga organi i akuzës dhe të jetë dhënë autorizimi për ndjekjen penale nga Kuvendi i Shqipërisë”*.

1. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet mërëndësisë sëfaktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë;

<sup>126</sup> Shih Vendimi nr.459, datë 23.07.2001.

<sup>127</sup> Shih Vendimi nr.69, datë 21.01.2001.

Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një tjetër, më të lehtë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo u caktua. Ndodhemi para një situatë të tillë, p.sh., kur, për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës, ulet rëndësia e faktit dhe praktika gjyqësore ka pranuar se *nevojat e sigurimit mund të zbuten edhe për shkak të gjendjes shëndetësore ose të rrethanave familjare të të pandehurit*, por duhet theksuar kur ato janë të tilla që pakësojnë mundësitë e tij për të ikur apo për të kryer vepra të tjera penale. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>128</sup> ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit Kukës,<sup>129</sup> për të pandehurin S.Th., të akuzuar për mbajtje pa leje të armës së gjahut, duke e zëvendësuar masën e sigurimit të arrestit në burg me atë të paraqitjes në Policinë Gjyqësore, me këtë arsytim: *“Gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e paraburgimit, gjendja shëndetësore e kërkuesit ka ardhur duke u keqësuar, mbasi që në fëmijëri ai vuan nga asthma bronchiale me kriza të përsëritura. Për këto arsye ai u transportua në qendrën spitalore të burgjeve, ku vazhdon të qëndrojë. Krizat e përsëritura, me gjithë kurat intensive, sikurse del nga akti mjekësor, nuk dominohen nga terapia dhe disa herë është dërguar në urgjencën e spitalit nr.1 Tiranë, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.. Duke pasur parasysh sa më sipër ..., në mbështetje edhe të kriterëve të veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, parashikuar në nenin 230/2, sipas së cilës nuk mund të vendoset arrest në burg ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë... gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë”*.

Theksoj, se jo gjithmonë gjendja shëndetësore mund të përbëjë shkak për ndryshimin e masës së sigurimit. Në mbështetje të këtij mendimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar:<sup>130</sup> *“Gjendja shëndetësore e të pandehurit është nën kujdesin e spitalit të burgut, i cili është një organ i ngarkuar me ligj për trajtimin e personave që presin apo kanë marrë një*

<sup>128</sup> Shih Vendimi nr.104, datë 21.02.2001.

<sup>129</sup> Shih Vendimi nr.2, datë 23.01.2001.

<sup>130</sup> Shih Vendimi nr.367, datë 03.11.2001.

*vendim dënimi nga gjykata dhe që janë në gjendje burgimi apo paraburgimi... Nuk ka rezultuar pamundësia e trajtimit të të pandehurit nga pikëpamja mjekësore nga personeli i spitalit të burgut apo nevoja për trajtim të specializuar dhe që nuk mund të ofrohet dot nga ky spital”.*

Praktika gjyqësore ka treguar se ekzistojnë vendime gjyqësore, në të cilat zëvendësimi i masës së sigurimit me një tjetër më të lehtë bëhet pa arsye të vërteta, por për favorizimin e të pandehurit. Po jap një rast, në një vendim të gjykatës së rrethit gjyqësor të Durrësit,<sup>131</sup> arsyetohet se të pandehurit N.Sh., i akuzuar për shitje të narkotikëve<sup>132</sup> dhe mbajtje pa leje të armëve,<sup>133</sup> i ishte caktuar si masë sigurimi arresti në burg, por kjo masë ishte zëvendësuar me arrest në shtëpi, masë kjo që i kishte dhënë mundësi për të ikur jashtë shtetit. Më vonë gjykohet në mungesë dhe dënohet gati me minimumin e parashikuar nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

2. Kur nevojat e sigurimit rëndohen, gjykata, me kërkesën e prokurorit, zëvendëson masën e zbatuar me një tjetër më të rëndë;

Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një tjetër, më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo u caktua. Zëvendësimi i masës së sigurimit me një tjetër më të rëndë bëhet nga gjyqtari, me kërkesën e prokurorit, i cili duhet të paraqesë të dhëna e fakte që vërtetojnë se nevojat e sigurimit janë rënduar. Një rast i tillë është ai, sipas të cilit, kur personi ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit shkel detyrimet që lidhen me atë masë, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes.<sup>134</sup>

<sup>131</sup> Shih Vendimi nr.143, datë 25.04.2002.

<sup>132</sup> Shih neni 283 të Kodit Penal.

<sup>133</sup> Shih neni 278 të Kodit Penal.

<sup>134</sup> Shih neni 231 “Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal”, të K.Pr.Penale.



Ndodhemi para këtij rasti, kur personi ndaj të cilit është marrë si masë sigurimi detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, kryen vepra të tjera ose nuk është korrekt me detyrat e caktuara për masën e marrë, duke mos u paraqitur në polici në kohën e caktuar. Nevojat e sigurimit mund të rëndohen edhe kur i pandehuri ndaj të cilit është caktuar një masë sigurimi, e ndryshme nga arresti në burg, kryen apo përgatitet të kryejë vepra të tjera penale apo kur ka të dhëna se, duke qenë i lirë, rrezikon marrjen ose vërtetësinë e provës. Kur ndodhemi para këtyre rasteve, prokurori duhet të kërkojë zëvendësimin e masës së caktuar me atë të arrestit në burg. Zgjidhja është e thjeshtë në qoftë se vepra tjetër penale kryhet kur procedimi është në fazën e hetimit paraprak, sepse prokurori do t'i hetojë bashkërisht të dyja veprat penale dhe kryerjen e veprës së re do ta paraqesë si argument në kërkesën për ndryshimin e masës së sigurimit. Kërkesa e prokurorit do të shqyrtohet sipas ligjit procedural.<sup>135</sup>

Ndryshe është situata kur vepra tjetër kryhet në kohën që vazhdon gjykimi i veprës për të cilën është caktuar masa e sigurimit. Në një rast të tillë prokurori do t'i kërkojë gjykatës që të zëvendësohet masa e sigurimi me një më të rëndë, duke paraqitur të dhënat që tregojnë se i pandehuri është akuzuar edhe për një vepër penale tjetër e, për rrjedhojë, lënia e tij në gjendje të lirë paraqet rrezikshmëri.

Gjykata e rrethit gjyqësor të Tiranës nuk e ka pranuar një kërkesë të tillë të prokurorit për të pandehurin K.L. me arsyetimin se kërkesa duhet të shqyrtohet nga një gjyqtar i caktuar dhe jo nga trupi gjykues që gjykon çështjen kundër këtij të pandehuri.<sup>136</sup>

### **Jurisprudencë:**

Mendoj seky arsyetim nuk duket i drejtë, sepse në rastin konkret nuk kërkohet caktimi i masës së sigurimit, por zëvendësimi i saj me një më të rëndë për shkak të ndryshimit të

<sup>135</sup> Shih neni 260 “Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit”, të K.Pr.Penale.

<sup>136</sup> Shih Vendimi datë 2002/2, të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

rrethanave që tregojnë se i pandehuri nuk duhet të lihet në gjendje të lirë. Për më tepër, po ky trup gjykues e kishte ndryshuar më përpara masën e sigurimit për këtë të pandehur, nga arrest në burg në arrest në shtëpi, për arsye shëndetësore.

1. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokim ose zëvendësimin e masës shqyrtohet nga gjykata brenda pesëditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti gjykata vendos edhe kryesisht gjatë procedimit për sigurimin e provës ose gjatë gjykimit.

Në këtë dispozitë del qartë drejta qëka gjykatapër tëndryshuar masën e sigurimit gjatë gjykimit. Arsyetimi i kundërt është se zëvendësimi i një mase të zbatuar me një masë tjetër më të rëndë mund të bëhet vetëm me kërkesë të prokurorit.<sup>137</sup> Për shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese.<sup>138</sup> Kështu p.sh, në qoftë se ndaj të pandehurit është caktuar si masë sigurimi ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarisë profesionale dhe ai nuk respekton këtë detyrim, gjykata, me kërkesën e prokurorit, mund ta zëvendësojë këtë masë ndaluese me një masë shtrënguese, siç mund të jetë ajo e arrestit në shtëpi ose mund ta bashkojë masën ndaluese me një masë shtrënguese, siç mund të jetë ajo e detyrimit për të qëndruar në një vend të caktuar.

### **Jurisprudencë:**

Është i palogjikshëm mendimi, sipas të cilit kërkesa për revokim ose zëvendësim të masës së sigurimit të shqyrtohet nga tre gjyqtarë. Nuk ka argumente që ta mbështetin këtë mendim, përkundrazi, ka shumë arsye për të pranuar se ky shqyrtim duhet të bëhet nga një gjyqtar. Revokimi apo ndryshimi i masës së sigurimit nuk është më i rëndësishëm se caktimi i

---

<sup>137</sup> Shih neni 260/3 të K.Pr.Penale.

<sup>138</sup> Shih neni 231 të K.Pr.Penale.

kësaj mase që i besohet një gjyqtari. Ky diskutim mund të konsiderohet i mbyllur me ndryshimin që iu bë neni 13 të Kodit të Procedurës Penale.<sup>139</sup> Sipas pikës 2, gërma “b” të këtij neni të ndryshuar, kërkesat e palëve gjatë hetimit paraprak gjykohen nga një gjyqtar. Shqyrtimi i kërkesës bëhet nga një gjyqtar ashtu siç veprohet edhe në rastin e caktimit të masës. Nuk ka ndalim që kërkesa të gjykohet nga gjyqtari që ka caktuar masën, por do të ishte më mirë që kjo gjë të bëhej nga një tjetër, për të siguruar një gjykim të paanshëm.

Mosrespektimi i afatit 5 (pesë) ditor përbën shkelje, por nuk sjell si pasojë shuarjen e masës së sigurimit. Nëlidhje me këtë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar ankimin e M.K kundër vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë,<sup>140</sup> është shprehur:<sup>141</sup> “*Është e vërtetë se gjykata në rastin në fjalë ka vepruar në kundërshtim me ligjin procedural,*<sup>142</sup> e cila e detyron atë ta shqyrtojë kërkesën për revokimin e masës së sigurimit brenda 5 (pesë) ditëve nga depozitimi i saj. Gjykata nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe për këtë shkak Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i tërheq vëmendjen asaj për mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji procedural. Nga ana tjetër, këtë shkelje ligji nuk e parashikon me pasojë shuarjen e masës së sigurimit.

Për këtë arsye, Kolegji nuk e gjen të bazuar pretendimin e ngritur në rekursin e të pandehurit. Kundër vendimit që pranon ose refuzon kërkesën për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, duke respektuar rregullat e ankimit për masat e sigurimit.<sup>143</sup> Gjykata, d.m.th gjyqtari, mund të vendosë edhe kryesisht për revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit, në rastet e parashikuara në ligj.

---

<sup>139</sup> Shih ligji nr.8813, datë 13.06.2002.

<sup>140</sup> Shih Vendimi nr.1229, datë 25.10.2001.

<sup>141</sup> Shih Vendimi nr.223, datë 03.04.2002.

<sup>142</sup> Shih neni 260/4 të K.Pr.Penale.

<sup>143</sup> Shih neni 249 të K.Pr.Penale.

Po jap nga një shembull për të tre rastet e parashikuara në ligj.

1. Së pari, p.sh në qoftë se gjatë pyetjes për sigurimin e provës del që nuk plotësohen kushtet dhe kriteret për masën e arrestit, gjykata mund të ndryshojë, edhe kryesisht, masën e arrestit në burg në një masë tjetër më të lehtë.<sup>144</sup>
2. Së dyti, po kështu, kur nga shqyrtimi, në seancë gjyqësore, i informacionit të bërë nga prokurori çdo dy muaj, del se nevojat e sigurimit nuk ekzistojnë ose kanë ndryshuar, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit.<sup>145</sup>
3. Së treti, në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin kur gjykata merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi.<sup>146</sup>

Neni 261 “*Shuarja e masave të sigurimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

Në këtë nen janë parashikuar rastet kur masat e sigurimit shuhen, pra humbasin fuqinë.

1. Masat e sigurimit shuhen:

- a) Kur për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë vendimi i pafajësisë;

Kuptohet që në këto kushte procedimi penal mbyllet dhe, për pasojë, të gjitha veprimet e kryera, përfshirë edhe masat e sigurimit, e humbasin fuqinë, bëhen të pavlefshme.

---

<sup>144</sup> Shih neni 260/4 të K.Pr.Penale.

<sup>145</sup> Shih neni 246/6 të K.Pr.Penale.

<sup>146</sup> Shih neni 248/2 të K.Pr.Penale.

Po si do të veprohet kur vendimi i gjykatës së shkallës së parë për pafajësinë e të pandehurit të paraburgosur dhe pavlefshmërinë e masës së sigurimit prishet nga gjykata e apelit?

Le t'i referohemi një rasti të praktikës. Gjykata e rrethit të Kolonjës, me vendimin nr.21, datë 08.09.2000, ka deklaruar të pafajshëm të pandehurit F.B. dhe A.V. si dhe ka deklaruar të pavlefshme masën e sigurimit të arrest në burg të marrë ndaj tyre. Gjykata e apelit Korçë, me vendimin nr.116, datë 02.11.2000, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor të Kolonjës dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, pa u shprehur për masat e sigurimit. Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs të pandehurit, duke pretenduar se masat e sigurimit kanë rënë, pasi gjykata e apelit nuk është shprehur për to. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.110, datë 23.02.2001, nuk e ka pranuar këtë pretendim dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke arsyetuar, midis të tjerave: *“Në kundërshtim me sa pretendohet në rekurs se masat e sigurimit kanë rënë, pasi gjykata e apelit nuk është shprehur për to dhe ato janë deklaruar të pavlefshme nga gjykata e rrethit, duhet pranuar se gjykata e apelit ka prishur në tërësi vendimin e gjykatës së rrethit nga del qartë se ka prishur edhe pjesën që bën fjalë për deklarimin e pavlefshëm të masave të sigurimit arrest në burg”*.

b) Kur dënimi i caktuar shpallet i shuar ose i pezulluar me kusht;

Në këtë rast masa e sigurimit shuhet për shkak se dënimi i caktuar shpallet i shuar ose i pezulluar me kusht. Ai mund të shpallet i shuar, p.sh., në rastin e një amnistie për dënimet e dhëna deri në një kufi të caktuar. Kur ekzekutimi i dënimit pezullohet me kusht për një kohë të caktuar, masa e arrestit në burg shuhet dhe nuk rivendoset më në qoftë se i akuzuari respekton kërkesat që cakton ligji penal për dënimin me kusht.

c) Kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit tëcaktuar;

Në këtë rast, masa e sigurimit të arrestit në burg shuhet në qoftë se kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar. Kuptohet, në këtë rast nuk mbetet çfarë të vuhet dhe i dënuari lirohet, pra, vetvetiu, masa e sigurimit e humbet fuqinë.

d) Kur pas mbarimit të afatit të parashikuar nga neni 245, paragrafi 1 pika “c” nuk është urdhëruar përsëritja, brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267.

Në këtë rast, masa e sigurimit shuhet kur ajo është marrë për të garantuar marrjen ose vërtetimin e provës dhe afati i caktuar për këtë qëllim ka mbaruar (neni 245, paragrafi i parë, shkronja "ç", i Kodit të Procedurës Penale), si dhe kur plotësohen afatet maksimale të kohëzgjatjes së masave të sigurimit, të parashikuara nga nenet 263 dhe 267 të Kodit të Procedurës Penale.

Ka pasur shkelje të kësaj dispozite nga prokurorë e gjyqtarë, dhe, për pasojë, i arrestuari nuk është liruuar edhe pse është plotësuar afati maksimal i kohëzgjatjes së masës. Në një rast të tillë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.140, datë 05.05.2000, është shprehur: “Masa e sigurimit duhet të shuhet pasi që nga koha e arrestimit të tij në datën 13.05.1999 e deri më sot kanë kaluar më shumë se 6 muaj dhe akoma gjykata nuk ka dhënë vendim dënimi lidhur me sa akuzohet i pandehuri. Rezulton se vetëm prej datës 21.01.2000 deri në datën 30.01.2000 gjykata ka marrë vendim për pezullimin e afateve ligjore për shkak të mungesës së një avokati në gjykim... koha e qëndrimit me masë sigurimi me arrest në burg e të pandehurit D.H. është më e gjatë se ajo që lejon neni 263/2 i K.Pr.Penale. Ndodhur në këto kushte, masa e sigurimit me arrest në burg duhet të shuhet, pasi ka humbur fuqia e aplikimit të saj”.

1. Paraburgimi i urdhëruar gjatëhetimeve paraprake humbet fuqinë në qoftëse gjykata nuk procedon në marrjen në pyetje brenda afatit të parashikuar nga neni 248.
2. Shuarja e masave të sigurimit nuk pengon ushtrimin e të drejtave që ligji i njeh gjykatës ose ndonjë autoriteti tjetër në zbatimin e dënimeve plotësuese ose masave të tjera ndaluese.

**Jurisprudencë:**

Në praktikën gjyqësore, ka ndodhur që i pandehuri i arrestuar është dënuar me vendim të formës së prerë dhe, pasi ka filluar ekzekutimi i vendimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim.<sup>147</sup>

Lind pyetja: *Ado të shuhet masa e sigurimit për shkak të prishjes së vendimit? Vlerësoj se vendimi nuk prek masën e sigurimit, por ligjshmërinë e vendimit, prandaj ajo mbetet e pandryshuar. Do të zbatohet rregulli i caktuar në ligjin procedural, sipas të cilit në rastin kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet një gjykate tjetër, fillojnë të ecin përsëri afatet e parashikuara për secilën shkallë të procedimit.*<sup>148</sup>

Ndodhemi në një situatë krejtësisht tjetër, kur Kolegji Penal shprehet në vendimin e tij për revokimin ose ndryshimin e masës së sigurimit, në këtë rast kemi të bëjmë me një përjashtim nga rregulli i mësipërm.

Gjithashtu është shtruar pyetja: Si do të vepohet kur i pandehuri ka qenë me një masë sigurimi të ndryshme nga arresti në burg dhe, për shkak se vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë, ai është burgosur për të vuajtur dënimin, por ky vendim është prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë? Vlerësoj, duke qenë se vendimi i formës së prerë në bazë të të cilit ai është burgosur është prishur dhe kjo do të sjell rigjykimin e tij, ai duhet të lirohet dhe të vazhdojë gjykimin në gjendje të lirë. Në qoftë se do të ndodheshim para një situatë të ndryshme nga kjo, pra në qoftë se i pandehuri do të qëndronte në burg, atëherë do të ndodheshim para një situatë të paligjshme, të pabazuar në një akt gjyqësor, sepse ai është burgosur në zbatim të një vendimi dënimi, i cili është prishur, dhe jo të një mase sigurimi, prandaj duhet të urdhërohet lirimi i tij.

---

<sup>147</sup> Shih neni 441/c të K.Pr.Penale.

<sup>148</sup> Shih neni 263/4 të K.Pr.Penale.

Neni 262 “*Pasojat e shuarjes sëmasave tësigurimit*”, i Kodit tëProcedurës Penale:

1. Kur arrestimi e humbet fuqinë, për arsytet e treguar më lart, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të personit ndaj tëcilit është marrë masa.

Kur arrestimi e humbet fuqinë, për arsytet e treguara më lart, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të personit ndaj të cilit është marrë masa.

2. Në rastet e humbjes së fuqisë së masave të tjera të sigurimit, gjykata vendos heqjen e menjëhershme të tyre.

Për masat e tjera të sigurimit gjykata vendos heqjen e menjëhershme të tyre.

## **2.7.Kohëzgjatja e masave tësigurimit**

Në ndryshim nga Kodi i mëparshëm që nuk njihnte afate për kohëzgjatjen e masave të sigurimit, Kodi i ri i ka përcaktuar me hollësi këto afate dhe ka vënë rregulla, me plotësimin e të cilave, masat e sigurimit e humbasin fuqinë. Për masat shtrënguese, kohëzgjatja e tyre është specifikuar për çdo fazë të procedimit, duke i diferencuar sipas karakterit të masës dhe rrezikshmërisë së veprës penale.

Neni 263 “*Afatet e kohëzgjatjes sëparaburgimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Paraburgimi e humbet fuqinëëqoftëse nga fillimi i zbatimit tëtij kanëkaluar afatet, pa u dorëzuar aktet nëgjykatë :
  - a) Tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
  - b) Gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;



- c) Dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm.

Në këtë nen të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, janë bërë përcaktime të hollësishme për afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.

Për fazën e hetimeve paraprake deri në dorëzimin e akteve në gjykatë, afatet e paraburgimit caktohen si vijon:

- a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Për fazën e hetimeve paraprake paraburgimi mund të zgjatet nga gjykata vetëm një herë derinë tre muaj, me kërkesë të prokurorit, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje.

### **Jurisprudencë:**

Në praktikë ka ndodhur që, në kohën e përfundimit të afatit të paraburgimit, prokurori bën akuzë të re ose ndryshon cilësimin ligjor të veprës nga kundërvajtje në krim apo nga krim që dënohet deri në dhjetë vjet burgim, në krim që dënohet në minimum me dhjetë vjet burgim. Me këtë veprim është justifikuar tejkalimi i afatit të paraburgimit me arsyetimin se, për shkak të këtyre ndryshimeve, duhet të zgjatet edhe afati, duke u përshtatur me afatin e veprës së re më të rëndë.

Vlerësoj se ky arsyetim është i gabuar, sepse justifikon qëndrimet e padrejta dhe shmang kontrollin e gjykatës mbi masat e sigurimit. Në raste të tilla prokurori duhet të kërkojë nga gjykata një afat të ri paraburgimi, në përputhje me akuzën e re. Gjkata verifikon veprimet e prokurorit dhe, sipas rastit, vendos pranimin ose jo të kërkesës së tij. Kur kërkesa bëhet për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës, afati caktohet sipas sanksioneve të veprës penale që parashikon akuzën e re, por duke mos u ndryshuar fillimi i afatit të parë, ndërsa kur ngrihet një akuzë e re për një fakt të paditur më përpara nga prokurori, gjykata cakton një afat të ri që fillon nga dita e njoftimit të akuzës për këtë fakt.

Kjo situatë u rregullua përfundimisht me ligjin nr. 8813, datë 13.06.2002, i cili shtoi në nenin 263 paragrafët 7 dhe 8.

1. Paraburgimi e humbet fuqinëqoftëse nga dita e dorëzimit tëakteve në gjykatë kanëkaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënëvendimi i dënimit nëshkallë tëparë:
  - a) Dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
  - b) Nëntëmuaj, kur procedohet për krime që dënohen nëmaksimum deri në dhjetë vjet burgim;
  - c) Dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak sëdhjetëvjet burgim ose me burgim tëpërjetshëm.

Në këtë paragraf kemi të bëjmë me afatet e paraburgimit, për fazën e gjykimit në shkallë tëparë .

1. Paraburgimi e humbet fuqinëqoftë se nga dita e dhënies sëvendimit tëdënimit nëshkallë të parë kanë kaluar afatet e më poshtme pa u dhënë vendimi i dënimit nëgjykatën e apelit:
  - a) Dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

- b) Gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen nëmaksimumin deri nëdhjetë vjet burgim;
- c) Nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimumin jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim tëpërjetshëm.

Përdorimi i termave “*në maksimum deri në dhjetë vjet*” dhe “*në minimum jo më pak se dhjetë vjet*”, nuk është i saktë, prandaj edhe në rastin e dytë duhet përdorur fjala “maksimum”. Duket se është një gabim në shkrim.

Respektimi i këtyre afateve kërkon të eliminohen detyrimisht zvarritjet që vihen re për dërgimin e dosjeve në gjykatën e apelit. Shtrohet çështja që kjo punë e karakterit administrativ të kryhet në kohën më të shkurtër, sepse ndryshe do të ndodhë që paraburgimi do ta humbasë fuqinë përpara se çështja të gjykohet rregullisht në gjykatën e apelit.

1. Në rastin kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet gjykatës sëshkallë së parë ose të apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dërgohet gjykatës sëshkallës së parë, nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit, fillojnëpërsëri afatet e parashikuara, për secilën shkallë të procedimit.

Kur çështja i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, afatet e paraburgimit do të fillojnë nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit dhe do të vazhdojnë sipas përcaktimeve të bëra në nenin 263 për gjykatën e shkallës së parë, ndërsa kur çështja dërgohet në gjykatën e apelit, afati i ri do të jetë ai që është caktuar në nenin 263 për gjykimin e apelit.

1. Në rast ikjeje të të pandehurit të paraburgosur, afatet fillojnëtëecin përsëri nga çasti në tëcilin ai paraburgoset përsëri.

Në rast se i pandehuri i paraburgosur ikën nga vendi ku është izoluar, afatet e paraburgimit fillojnë të ecin përsëri nga çasti në të cilin ai paraburgoset përsëri.

2. Kohë zgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrëparasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:

- a) Dhjetëmuaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) Dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen nëminimum deri nëdhjetë vjet burgim;
- c) Tre vjet, kur procedohet për krime qëdënohen nëmaksimum jo mëpak se dhjetëvjet burgim ose me burgim tëpërjetshëm.

Në bazë të nenit 264, pika 3, tëKodit tëProcedurë s Penale, *“kohëzgjatja tërësore e paraburgimit nuk mund të kalojë gjysmën e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprënpenale që procedohet”*. Kjo do të thotë që në rast se një i pandehur akuzohet për një krim që dënohet deri në tre vjet burgim, ai nuk mund të mbahet i paraburgosur më shumë se një vit e gjysmë, edhe pse rregulli i përgjithshëm është që, kur procedohet për një krim që dënohet deri në dhjetë vjet burgim, paraburgimi mund të zgjatë deri në dy vjet.

Me plotësimin e afatit të paraburgimit, i pandehuri lirohet në çdo fazë të procedimit. Kështu, një i paraburgosur që akuzohet për një kundërvajtje penale, me plotësimin e tre muajve në fazën e hetimeve paraprake lirohet edhe pse hetimi vazhdon.

### **Jurisprudencë:**

Në praktikën tonë gjyqësore është hasur fenomeni, ku i pandehuri është mbajtur i paraburgosur, edhe pse afatet janë plotësuar. Kështu p.sh., gjykata e rrethit gjyqësor të Vlorës,

me vendim<sup>149</sup> ka zgjatur afatin e paraburgimit për të pandehurin G.V, edhe pse afati ishte plotësuar dhe ishte zgjatur një herë, me arsyetimin se “*vepra për të cilën akuzohet i pandehuri është veprë që paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore*”.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka prishur këtë vendim, dhe ka arsyetuar: “Afatet e paraburgimit janë parashikuar si garanci për mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit, të cilat e detyrojnë organin procedues të përfundojë hetimin ose gjykimin e çështjes në një kohë të arsyeshme, por kurdoherë jo më vonë se maksimumi i kohës së parashikuar me ligj. Gjykata është e detyruar t’i marrë në konsideratë këto afate, të cilat janë taksative në maksimumin e kohëzgjatjes së tyre dhe jo të bëjë vlerësime të tjera që ta çojnë atë në tejkalimin e tyre”.<sup>150</sup>

Në çështjen e të pandehurit D.H, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka pranuar rekursin e tij dhe ka shfuqizuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, me arsyetimin: “*Kërkesa e të pandehurit është e drejtë dhe duhet pranuar. Masa e sigurimit duhet të shuhet pasi që nga koha e arrestimit të tij, në datën 13.05.1999, e deri më sot, kanë kaluar më shumë se 6 muaj dhe gjykata ende nuk ka dhënë vendim dënimi lidhur me sa akuzohet i pandehuri*”.<sup>151</sup>

Në çështjen e të pandehurit A.N, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për të njëjtat arsye si më sipër, ka prishur vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor të Matit, që rrezonte kërkesën e të pandehurit A.N, për shuarjen e masës së sigurimit dhe ka vendosur pranimin e rekursit, duke deklaruar shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg për të këtë të pandehur, dhe caktimin ndaj tij si masë sigurimi arrest në shtëpi.<sup>152</sup>

<sup>149</sup> Shih Vendimi nr.19, datë 14.10.1999

<sup>150</sup> Shih vendimi nr.187, datë 06.07.2000.

<sup>151</sup> Shih Vendimi nr.140, datë 25.04.2000.

<sup>152</sup> Shih Vendimi nr.33, datë 18.01.2001.

Lidhur me kohëzgjatjen tërësore të paraburgimit, në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 11.11.2003, është theksuar: “ *Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se afatet e paraburgimit janë kaluar, si përrsa i përket atyre që lidhen me fazat e gjykimit, ashtu edhe afati tërësor që parashikon neni 263/6, gërma “b” e K.Pr.P..*”

Dispozita e ndryshuar e nenit 263 te K.Pr.P., ka sjellë dy elementë të reja krahasuar me atë të mëparshmen: së pari, përcaktimi i kohëzgjatjes së paraburgimit lidhet me masën e dënimit që parashikon dispozita, dhe së dyti, përcakton afate kohore më të gjata paraburgimi për fazat e procedimit, ashtu edhe atë tërësor.

Po ashtu, lidhur me afatet e paraburgimit, element i ri i kësaj dispozite është fillimi i tyre jo vetëm kur vendimi priset dhe kthehet për rigjykim nga Gjykata e Lartë, por edhe kurkëtë e vendos Gjykata e Apelit.

Neni 264/2 i K.Pr.P., të cilës i referohet dispozita e mësipërme, parashikon që afati i paraburgimit në fazën e hetimit paraprak mund të zgjatet për një kohë jo më shumë se tre muajt dhe vetëm një herë.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykatës së Lartë, çmojnë se në kohëzgjatjen tërësore të paraburgimit nuk duhet të llogariten afatet e paraburgimit të pezulluara me vendim te gjykatës.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se në rigjykim, afatet e paraburgimit nuk mund të rinisin në qoftë se kohëzgjatja tërësore është konsumuar plotësisht. Në rastet e tjera, kohëzgjatja e paraburgimit rifillon për çdo shkallë të procedimit, me kushtin që kohëzgjatja tërësore e paraburgimit të mos tejkalohet.

Kur çështja kthehet për rigjykim, pavarësisht nga afatet e paraburgimit që parashikon ligji për çdo fazë të gjykimit, këto afate nuk llogariten më nga e para si bashkim aritmetik i

tyre, por në dispozicion të gjykatës mbetet pjesa e pa konsumuar nga afati tërësor i paraburgimit.

Ligji, duke përcaktuar maksimalet e këtyre afateve, tregon kufijtë e pa kalueshëm për organin procedues, por kjo nuk do të thotë se ato detyrimisht janë përcaktuar për t'u konsumuar plotësisht. Parimi i gjykimit të pandërprerë, apo shpejtësisë së hetimit, detyrojnë si gjykatën, ashtu edhe organin e prokurorisë të përfundojnë çështjet në një kohë sa më të arsyeshme. Konsumimi deri në maksimum i kohës për hetimin dhe gjykimin e çështjeve, lë pa vlerë rifillimin e afateve të paraburgimit, kur vendimet e gjykatave më të ulëta prishen nga ato më të larta. Marrë për bazë sa më sipër dhe faktin se kjo ka ndodhur edhe në çështjen në shqyrtim, *Kolegjet e Bashkuara tërheqin vëmendjen lidhur me atë se organi procedues në hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale nuk duhet të kenë si pikë referimi maksimumet e afateve të paraburgimit sipas fazave të procedimit, por zgjidhjen në kohën më të shpejtë të mundshme të çështjes prej tyre.*

Në nenin 264, pika 3 të K.Pr.P., është përcaktuar se *“kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë gjysmën e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale që procedohet”*.

Duke u nisur nga kjo, Kolegjet arrijnë në përfundimin se *kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë 1/2 e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale për të cilën procedohet*, edhe pse afati tërësor i përcaktuar nga neni 263 i K.Pr.P., e lejon paraburgimin tej kësaj kohe.

Më e dukshme kjo është në rastet e kundërvajtjeve penale, kur megjithëse kohëzgjatja tërësore në maksimum mund të shkojë deri në dhjetë muaj paraburgim, vetë dispozitat e vecanta, parashikojnë dënime të ulëta me burgim, të cilat shkojnë me aplikimin e 1/2 më pak se sa kohëzgjatja tërësore e parashikuar nga neni 263 i K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se “ *periudha e kaluar me paraburgim tej afatit maksimal të tij, në ekzekutim të vendimit të dënimit duhet të llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 57 të K.Penal*”.

1. Kur nëmbarim tëafatit tëparaburgimit prokurori i komunikon tëpandehurit njëakuzëtë re, për të cilën parashikohen afate më të gjata paraburgimi se ato të akuzës së parë, ai i kërkon gjykatës të caktojë afatin e ri të paraburgimit. Gjykata vendos në seancë gjyqësore pasi tëketë dëgjuar palët.

Në bazë të kë tij paragrafi, gjykata vendos në seancë gjyqësore, pasi të ketë dëgjuar palët. Kështu mund të ndodhë, bie fjala, kur një të pandehuri të akuzuar për një krim që dënohet deri në 10 vjet burgim, i njoftohet një akuzë e re për një krim që dënohet jo më pak se 15 vjet burgim.

2. Kur akuza e re lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimin ligjor të veprës, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes sëafatit ështëai i masës së mëparshme të sigurimit.

Në këtë paragraf, bëhet sqarimi i plotë i akuzës së re. Kur akuza e re, thuhet në këtë paragraf, lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimi ligjor i veprës penale, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes së afatit është ai i masës së mëparshme të sigurimit.

Neni 264 “*Zgjatja e paraburgimit*”, i Kodit tëProcedurës Penale:

1. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur është urdhëruar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit, afatet e paraburgimit zgjaten për kohën që është caktuar për kryerjen e ekspertimit. Zgjatja vendoset nga gjykata, mbi kërkesën e prokurorit,



pasi dëgjohe mbrojtësi. Kundër vendimit mund të bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë .

Në këtë paragraf, kemi të bëjmë rastin e parë për zgjatjen e afatit të paraburgimit. Është fjala për zgjatjen e afatit *kur vendoset ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit*. Kjo zgjatje vendoset nga gjykata në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit me kërkesën e prokurorit, pasi dëgjohe edhe mbrojtësi i të pandehurit dhe vazhdon për gjithë kohën që është caktuar për kryerjen e ekspertimit. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.

2. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin merr vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm njëherë dhe nuk mund më shumë se tre muaj.

Në rastin e dytë, zgjatja e paraburgimit lejohet për fazën e hetimeve paraprake kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikime veçanërisht komplekse që e bëjnë të domosdoshme zgjatjen. Kërkesa bëhet nga prokurori dhe shqyrtohet nga gjykata e cila vendos pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin e të pandehurit. Zgjatja nuk mund të jetë më shumë se tre muaj dhe kërkesa nuk mund të përsëritet. Në këtë paragraf kemi të bëjmë një dalim ligjor, ku ligji na i përcakton qartë sa herë mund të realizojmë zgjatjen dhe afatit e saj.

3. Kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë gjysmën e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale që procedohet.

### **Jurisprudencë:**

Duke u bazuar në këtë paragraf, Kolegjet arrijnë në përfundimin se *“kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë 1/2 e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën*

*penale për të cilën procedohet*”, edhe pse afati tërësor i përcaktuar nga ligji procedural,<sup>153</sup> e lejon paraburgimin tej kësaj kohe. Kjo do të thotë që në rast se një i pandehur akuzohet për një krim që dënohet deri në tre vjet burgim, ai nuk mund të mbahet i paraburgosur më shumë se një vit e gjysmë, edhe pse rregulli i përgjithshëm është që, kur procedohet për një krim që dënohet deri në dhjetë vjet burgim, paraburgimi mund të zgjatë deri në dy vjet. Me plotësimin e afatit të paraburgimit, i pandehuri lirohet në çdo fazë të procedimit. Kështu, një i paraburgosur që akuzohet për një kundërvajtje penale, me plotësimin e tre muajve në fazën e hetimeve paraprake lirohet edhe pse hetimi vazhdon.

Neni 265 Pezullimi i afateve tëparaburgimit”, i Kodit tëProcedurës Penale:

Pezullimi i afateve të paraburgimit duhet parë si një fenomen i cili në disa raste mund të bëjë që kohëzgjatja e përcaktuar nga neni 263 paragrafi 6 të kapërcehet. Pezullimi ndodh vetëm në rastet e një shqyrtimi gjyqësor dhe vetëm në rastet e përcaktuara në mënyrë eksplicite nga legjislatori.

1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:

- a) Për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta të bëra nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, përveç rasteve kur kërkesa bëhet për marrjen e provës;

Në këtë paragraf ndodhemi para rastit të parë të pezullimit të afateve tëparaburgimit. Të tilla mund të jenë kërkesat e pabazuara në ligj e në fakt për përjashtimin e gjyqtarit, ato për kompetencën apo juridiksionin etj.

---

<sup>153</sup> Shih neni 263 “Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit”, të K.Pr.Penale.

- b) Për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmënjë a më shumë të pandehur.

Gjykata duhet të shprehet për këtë pezullim dhe të përcaktojë saktë afatin që pezullohet. Siç theksohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,<sup>154</sup> *“afatet nuk pezullohen vetvetiu, por me vendim të gjykatës, duke iu referuar atyre dispozitave që e çojnë gjykatën në këtë përfundim”*.

Gjykata e Lartë nuk ka pranuar si shkak për pezullimin e afateve të paraburgimit mungesën e të pandehurit kur ai nuk është paraqitur në seancë jo për fajin e tij. Në vendimin e Kolegjit Penal,<sup>155</sup> me të cilin priset vendimi i ndërmjetëm i gjykatës së rrethit Fier<sup>156</sup> dhe pranohet rekursi i të pandehurit A.N. për deklarimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit, është theksuar: *“Gjykimi i çështjes është shtyrë 9 herë, nga të cilat 3 herë për shkak se i pandehuri nuk është shoqëruar për në gjykatë. Mungesa e të pandehurit në asnjë rast nuk ka qenë për faj të tij... ai nuk është paraqitur në gjykim për shkakun e vetëm se nga organet e policisë nuk janë marrë masat e nevojshme për shoqërimin e tij në gjykatë... mungesa e të pandehurit në gjykim, jo për faj të tij, nuk përbën shkak për pezullimin e afateve të paraburgimit”*.

Nëpërmjet pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 265, synohet t’u pritët rruga përpjekjeve të disa të pandehurve ose mbrojtësve të tyre për të zvarritur shqyrtimin gjyqësor me qëllim që të plotësohet afati maksimal i paraburgimit dhe, për rrjedhojë, ai të humbasë fuqinë dhe i arrestuari të lirohet.

<sup>154</sup> Shih Vendimi nr.140, datë 25.04.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>155</sup> Shih Vendimi nr.365, datë 07.11.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>156</sup> Shih Vendimi i datës 10.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Fier.

Duke vënë në dukje këtë aspekt të pezullimit të afateve të paraburgimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë theksuar:<sup>157</sup> “Pezullimi është ndërprerje e afateve për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj”, dhe sipas të drejtës penale, këto afate rifillojnë pasi të ketë mbaruar, ose të jetë hequr shkaku i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pa konsumuar të tyre. Kur gjykata disponon për një nga shkaqet që ligji parashikon për pezullim të afateve të paraburgimit, këto afate nuk ecin, por rifillojnë pas heqjes së pezullimit. Kjo do të thotë, se vete afati maksimal i paraburgimit nuk tejkalohet proceduralisht, por koha fizike e paraburgimit mund të jetë më e gjatë se afati tërësor. Qëllimi i ligjvënësit me riformulimin e dispozitës së nenit 265 të K.Pr.Penale., ka qenë frenimi i veprimeve spekulative në fazën e gjykimit, për të plotësuar afatet e paraburgimit nëpërmjet mënyrave dhe kërkesave të paligjshme. Po t’i referohemi shkaqeve të pezullimit të afateve të paraburgimit, ato lidhen me veprime dhe kërkesa të padrejta të mbrojtësit apo të pandehurit, apo me mosparaqitjen apo largimin e mbrojtësit nga gjykimi. Pra, pezullimi i afateve të paraburgimit vendoset për shkaqe që kanë të bëjnë me sjelljen e të pandehurve embrojtësve të tyre dhe jo me ato të organit të akuzës apo të gjykatës.

Ligjvënësi, për të evituar qëndrimet jo ligjore dhe për t’i dhënë një kuptim më të drejtë dispozitës, ka shtuar dy elemente të rëndësishëm me riformulimin e nenit 265 të K.Pr.Penale.

Së pari, përcaktohet në mënyrë eksplicite se për pezullimin e afateve të paraburgimit, gjykata duhet domosdoshmërisht të shprehet me vendim dhe këtë, ajo e bën kur shtyn seancën gjyqësore. Pra, vetë shtyrja e seancës gjyqësore, nuk është e mjaftueshme për efekte të pezullimit të afateve të paraburgimit, në qoftëse nuk është shoqëruar edhe me vendimin përkatës të pezullimit të këtyre afateve.

Së dyti, ka përcaktuar se kundër vendimit që pezullon afatet e paraburgimit mund të bëhet ankim në gjykatën më të lartë veçmas dhe jo së bashku me vendimin përfundimtar. Me këtë, ligjvënësi ka dashur të garantojë nëpërmjet verifikimit nga gjykatat më të larta, se afatet e

---

<sup>157</sup> Shih Vendimi nr.6, datë 11.11.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

paraburgimit janë pezulluar për ato shkaqe të posaçme të parashikuara në ligj dhe jo për të tjera arsye, tej atyre që përcakton neni 265 i K.Pr.Penale.

Vendimi i pezullimit, si vendim i ndërmjetëm dhe që ankimohet veçmas, duhet të merret i arsyetuar nga gjykata dhe duhet t'u njoftohet palëve në proces. Në veçanti, rëndësi ka njoftimi i të pandehurit që nuk ka marrë pjesë në seancën ku është vendosur pezullimi i afateve të paraburgimit, me qëllim që të bëhet e mundur që ai të përfitojë nga e drejta e ankimit të vendimit në gjykatën më të lartë dhe që ligji ia njeh.

### **Jurisprudencë:**

Në jurisprudencën tonë, kemi mangësi për sa i përket një vendimi unifikues për njehsimin e praktikës gjyqësore, për sa i përket afatit të ankimit dhe nëse gjykimi i çështjes në themel kur vendimi i pezullimit ankimohet vazhdon pavarësisht nga ankimi, apo edhe ai pezullohet. Megjithëse në dispozitë nuk është përcaktuar afati kohor i ankimit, bazuar në ligjin procedural,<sup>158</sup> por edhe në dispozita të tjera që rregullojnë raste të ankimeve veçmas të vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, Kolegjet çmojnë se afati i ankimit kundër vendimit të pezullimit do të jetë 10 (dhjetë) ditë, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes ose njoftimit të vendimit. Vetë ankimi kundër vendimit nuk pezullon gjykimin e çështjes në themel.

### **Jurisprudencë:**

Praktika gjyqësore na ofron jo rrallë, që kur pezullohen afatet e paraburgimit dhe shtyhet seanca gjyqësore për shkaqet e parashikuara nga K.Pr.Penale,<sup>159</sup> gjykatat caktojnë datë relativisht të largët për seancën e ardhshme. Vlerësoj, se ky qëndrim është i pa mbështetur në ligj dhe i pa motivuar në raport me shkakun e shtyrjes së seancës. Kur flitet për pezullim të

---

<sup>158</sup> Shih neni 415 të K.Pr.Penale.

<sup>159</sup> Shih neni 265 i K.Pr.Penale.

afateve të paraburgimit ato janë të lidhura me ndodhjen e një fakti, i cili e shtyn gjykatën të vendosë pezullimin e afateve. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e pezullimit duhet të vazhdojë derisa të hiqet pengesaose shkaku i pezullimit, dhe jo kur gjykata në mënyrë të njëanshme të vendosë një afat sipas gjykimit të saj subjektiv. Ky veprim përben një ndalim ligjor. Gjykatat, megjithëse seancën e ardhme e caktojnë ndonjëherë edhe pas një afati kohorrelativisht të largët që shkon deri në dy muaj, ato nuk argumentojnë arsyet e kësaj kohëzgjatje, apo bazohen në shkaqe të pa justifikuar ligjërish. Vlerësoj, se ky qëndrim është i gabuar edhe po t'i referohesh parimeve të përgjithshme të gjykimit, ku një ndër ato më të rëndësishmet dhe që garanton një procedim të shpejtë dhe afërsinë e dhënies së drejtësisë nga koha e ndodhjes së krimit, është gjykimi i pandërprerë.

Në K.Pr.Penale , është përcaktuar qartë se kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme për disa arsye, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.

Gjykata lejohet ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor deri në 15 ditë, vetëm për raste të veçanta.<sup>160</sup> Pra afati maksimal i shtyrjes duhet të jetë pesëmbëdhjetë ditë. Kjo dispozitë e marrë në raport me rëndësinë e faktit që ka privimi i lirisë së individit, është mjaft e rëndësishme për t'u zbatuar nga gjykatat në shtyrjen e seancave gjyqësore, kur ato vendosin pezullimin e afateve të paraburgimit.

### **Jurisprudencë:**

Në praktikën gjyqësore ndodh dhe madje shumë shpesh fenomeni kur procedimi është ndaj disa të pandehurve, mjafton që të mungojë njëri prej mbrojtësve në seancë, i cili lë pa mbrojtës njërin nga të pandehurit, që gjykata të vendosë pezullimin e afateve të paraburgimit për të gjithë të pandehurit. Vlerësoj, se ky qëndrim është i gabuar nga ana e gjykatës, pasi

---

<sup>160</sup> Shih neni 342 të K.Pr.Penale.

mungesa e mbrojtësit të njërit të pandehur nuk është shkak për pezullimin e afateve të paraburgimit për të pandehurin tjetër, mbrojtësi i të cilit ndodhet në seancë. Një mënyrë e tillë të vepruari nga ana e gjykatës, çon në zvarritjen e çështjes në mënyrë të padrejtë për një të pandehur që është konform ligjit për sa i përket rregullave të seancës gjyqësore. Gjykata ka mundësi të tjera për të vepruar në qoftëse ndodhet para një situatë të tillë, një mundësi që ta ofron vetë ligji është ndarja e çështjes.

Ajo çfarë duhet të theksojmë është se, pezullimi i afateve të paraburgimit duhet të përfundojë në kohë gjithmonë para së të përfundojë vetë afati i paraburgimit. Ecja e afateve të paraburgimit vepron në mënyrë automatike pa pasur nevojë për vendim nga ana e gjykatës, ndërsa për pezullimin e afateve të paraburgimit kërkohet gjithmonë vendim, i cili është një kusht *sine quanon* për të pasur vlefshmëri ligjore. Pezullimi i afateve të paraburgimit zgjat nga data në të cilën është shtyrë në seancë gjyqësore deri në datën e caktuar prej saj për zhvillimin e seancës pasardhëse të seancës së shtyrë.

Në rastin e procedimit si rezultat i dërgimit të akteve në Gjykatën Kushtetuse, nga gjyqtari si rezultat i gjykimit incidental, sjell si pasojë pezullimin e afateve të kohëzgjatjes maksimale të arrestit në burg. Gjithmonë në këtë rast kur gjykimi incidental nuk ndërhyt në gjykimin principal. Në rastin e kundërt është afirmuar fakti se pezullimi i afateve të paraburgimit, nuk vepron atëherë, kur gjyqtari, si pasojë e kërkesave të të pandehurit, shikon të nevojshme verifikimin konstitucional të normës objekt kërkesë, dërgon aktet në Gjykatën Kushtetuse, duke pezulluar në kohë të gjithë procedimin. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,<sup>161</sup> përcakton se kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast ato pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Neni 266 “Disponimet në rastet e lirimit nga burgu”, i Kodit të Procedurës Penale:

---

<sup>161</sup> Shih neni 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1. Ndaj të pandehurit të liruar nga burgu për shkak tëmbarimit të afateve, gjykata, kur ekzistojnë ende arsyet për të cilat ishte vendosur paraburgimi, cakton masa të tjera sigurimi në qoftë se janë kushtet e kërkuara.

Në qoftë se i paraburgosuri lirohet për shkak të plotësimit të afatit të paraburgimit dhe procedimi ndaj tij vazhdon, me kërkesën e prokurorit, në bazë të këtij paragrafi gjyqtari cakton një masë tjetër sigurimi, të ndryshme nga paraburgimi, por gjithmonë në qoftë se janë kushtet dhe kriteret e caktuara me ligj.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar që në rastin: “*kur shuhet masa e arrestit në burg mund të caktohet si masë tjetër sigurimi ajo e arrestit në shtëpi*”.<sup>162</sup> I liruari duhet të respektojë urdhrat e dhënë me rastin e caktimit të masës tjetër të sigurimit.

2. Paraburgimi, kur është i nevojshëm, rihet në fuqi:

- a) Kur i pandehuri i ka shkelur me dashje urdhrat e dhëna në lidhje me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, por gjithnjë kur ekzistojnë nevojat e sigurimit;
- b) Me vendimin e dënimit, kur ekziston nevoja e sigurimit e parashikuar nga neni 228, paragrafi 3.

Kur jepet vendim dënimi dhe vërtetohen nevojat e sigurimit, të parashikuara nga kjo pikë, që janë: rreziku i dëmtimit apo marrjes së provës, rreziku i ikjes së të pandehurit apo i kryerjes nga ana e tij e krimeve të rënda ose të njëjtit lloj me atë për të cilin dënohet.

3. Me rivënien në fuqi të paraburgimit, afatet fillojnë të ecin përsëri, por për efekt të llogaritjes së afatit të kohëzgjatjes së përgjithshme të paraburgimit mbahet parasysh edhe paraburgimi i vuajtur më parë .

---

<sup>162</sup> Shih Vendimi nr.172, datë 08.11.2004.



Me vendim të gjyqtarit për rivënien në fuqi të paraburgimit afatet fillojnë të ecin përsëri, por në llogaritjen e kohëzgjatjes tërësore të paraburgimit mbahet parasysh edhe paraburgimi i vuajtur më përpara. Kështu, një i pandehur që akuzohet se ka kryer një krim që dënohet deri dhjetë vjet burgim dhe ka qëndruar i paraburgosur një vit e gjysmë, pas rivënies së paraburgimit nuk mund të mbahet në burg më shumë se gjashtë muaj, sepse kohëzgjatja tërësore e paraburgimit kur procedohet për një krim të tillë nuk mund të kalojë dy vjet.

4. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore mund të ndalojnë të pandehurin, i cili, duke shkelur urdhrat që lidhen me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, ka ikur. Zbatohen, për aq sa pajtohen, dispozitat mbi ndalimin e personit të dyshuar për veprën penale.

Në rast se i pandehuri ikën, oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore kanë të drejtë ta ndalojnë atë, duke zbatuar dispozitat për ndalimin e personit që dyshohet për kryerjen e një krimi (neni 266, pika 4).

Neni 267 ‘Afatet e kohë zgjatjes maksimale tëmasave tjetjere tësigurimit’, i Kodit tëProcedurës Penale:

1. Masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar njëkohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263.

Kohëzgjatja maksimale e masave të tjera shtrënguese, të ndryshme nga arresti në burg, të cilat parashikohen nga neni 232, është sa dyfishi i afateve të parashikuara për paraburgimin. Kështu p.sh., masa e detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, e marrë ndaj një të pandehuri që akuzohet se ka kryer një krim, që dënohet në maksimum deri 10 vjet, për fazën e gjykimit në shkallë të parë, nuk mund të zgjatë më shumë se 18 muaj. Në bazëtëkë tij paragrafi, afati fillon nga momenti i zbatimit të masës së sigurimit.

2. Masat ndaluese e humbasin fuqinëkur kanë kaluar tre muaj nga fillimi i zbatimit të tyre. Kur ato janë marrë për arsye që të mos dëmtohen provat, gjykata mund të urdhërojë përsëritjen e tyre deri në kufijtë e parashikuar nga paragrafi 1.

Në bazë të kësaj pike, masat ndaluese nuk mund të vazhdojnë më shumë se tre muajnga fillimi i zbatimit të tyre. Por, kur marrja e tyre është motivuar me rrezikun e dëmtimit të provave, gjyqtari mund të urdhërojë përsëritjen e tyre deri në dyfishin e afateve të parashikuara për paraburgimin, pra deri në kufijtë e parashikuar për masat shtrënguese, të ndryshme nga arresti në burg.

#### *Kompensim për burgim të padrejtë*

Termi “*kompensim*” që është përdorur kur është fjala për rehabilitimin jo në kuptimin e gjerë të kësaj fjale, por për rehabilitimin në kuptimin e përmirësimit të arsyeshëm të nivelit të gjendjen ekonomike të kësaj kategorie personash, e cila padyshim që është dëmtuar gjatë kohës që ata kanë qëndruar padrejtësisht në burg, për shkak të një akti të paligjshëm të organeve shtetërore.

Akte të tilla, mund të jenë ose vendime të gabuara të gjykatave për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, ose vendime të gabuara të prokurorit ose të oficerit të policisë gjyqësore për arrestimin në flagrancë ose ndalimin e personit, ose deri edhe vendime të gjykatave që deklarojnë fajtor dhe dënojnë me burgim persona që kur gjykohen janë në gjendje të lirë dhe që më vonë deklarohen të pafajshëm ose pushohen çështjet në ngarkim të tyre, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr.3, datë 27.3.2003, kanë konkluduar se kompetente për shqyrtimin e kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë është gjykata civile dhe kërkesa drejtuar asaj duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e parashikuar nga dispozitat e përfshira në titullin e V-të të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me ngritjen e padisë. Gjithashtu dhe me rregullat procedurale që duhet të ndiqen nga

gjykatat, gjatë shqyrtimit të çështjes me objekt kërkesat për kompensimin për burgim të padrejtë, pavarësisht nga fakti që si shkak për ngritjen e padisë të këtij lloji, shërben vendimi penal i formës së prerë me të cilin pushohet çështja në ngarkim të të pandehurit ose ai deklarohet i pafajshëm se nuk provohet se është autor i veprës penale për të cilën është akuzuar, si dhe vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes për të njëjtat shkaqe, gjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve duhen zbatuar kërkesat e Kodit të Procedurës Civile, duke filluar që nga ato për hartimin dhe paraqitjen e padisë, shqyrtimin e saj dhe deri tek ankimet kundër vendimeve të dhëna, paraqitja dhe shqyrtimi i tyre.

Ndërsa në lidhje me palët, që do të formojnë ndërgjyqësinë në proceset gjyqësore të kësaj natyre, Kolegjet çmojnë se ato, veç ish-të pandehurit ose trashëgimtarëve të tij që legjitimohen të jenë paditës, si të paditur do të jenë përfaqësuesit e organeve ose institucioneve shtetërore që, me akte nënligjore ngarkohen për të ndjekur dhe zbatuar procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit (i tillë sipas vendimit nr.355, datë 2.6.1998 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë shkronja “c” e tij, aktualisht është institute i Ministrisë së Financave dhe strukturat e saj, sikurse janë aktualisht zyrat e thesarit nëpër rrethe).

Neni 268 “*Kushtet e zbatimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar qëvendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

Kolegjet e Bashkuara, janë shprehur, gjykata të cilës i paraqitet kërkesa për kompesim të padrejtë, gjatë shqyrtimit të saj, përveç verifikimit të respektimit ose jo të afateve të paraqitjes së saj dhe ekzistencës ose jo të ndonjëres prej rrethanave, prania e të cilave, sipas ligjit, përjashtojnë të drejtën për kompensim, bën edhe llogaritjen dhe përcakton përfundimisht masën, të shprehur në të holla, të kompensimit që do të përfitojë kërkuesi.

Sipas kësaj pike, personi që ka marrë pafajësi ose ndaj të cilit është pushuar çështja, përjashtohet nga e drejta për kompensim për burgim të padrejtë kur:

- a) është provuar që vendimi është i gabuar, tërësisht ose pjesërisht, për fajin e tij;
- b) moszbulimi në kohën e duhur i fakteve të panjohura, administrimi i të cilave, nga gjykata penale, nuk do ta çonte atë në marrjen e një vendimi fajësie për kërkuesin, ka ndodhur tërësisht ose pjesërisht për fajin e këtij të fundit.

Në rastin kur kërkesa për kompensim për burgim të padrejtë është bërë nga personi që ka marrë pafajësi pas rishikimit të vendimit penal të formës së prerë me të cilin ai ishte deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim, sipas përmbajtjes së pikës 1 të nenit 459 të K.Pr.Penale, personi që ka marrë pafajësi, përjashtohet nga e drejta për kompensim për burgim të padrejtë, kur kishte dhënë shkak me dashje ose pakujdesi të rëndë për gabimin gjyqësor që u vërtetua mbas rishikimit të çështjes, se kishte qenë ai që kishte ndikuar në marrjen e vendimit të fajësisë në dëm të tij. Evidentimi, administrimi dhe konkretizimi, rast pas rasti, i ekzistencës së këtyre rrethanave është detyrë e gjykatës penale ose prokurorit që, përkatësisht, jep vendimin e pafajësisë ose pushon çështjen.

Nga sa u parashtrua më lart, vërehet se, në të gjitha rastet e kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë, ndodhemi para vendimeve të gabuara të organit procedues (gjykatës, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore), por personit që është dëmtuar nga ky vendim duke u burgosur padrejtësisht, i lind e drejta për t'u kompensuar për këtë burgim vetëm në qoftë se ai nuk ka vepruar me faj (dashje ose pakujdesi e rëndë) në dhënien e vendimit të fajësisë në dëm të tij. Ky është kusht i domosdoshëm për të përfituar nga kjo e drejtë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin datë 24.11.2011, vlerëson se: *“gjykatat kanë arritur në përfundimin se për paditësin nuk është provuar ekzistenca e ndonjë prej rrethanave, prani e të cilave sipas ligjit, përjashtonte të drejtën e paditësit për kompensim për burgim të padrejtë”*.

2. E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenëkushtet e parashikuara nënenet 228 dhe 229.
3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në favor të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vlerëson se:<sup>163</sup> *“me të drejtë të dyja gjykatat kanë pranuar se në kushtet e ekzistencës së një vendimi pushimi të çështjes në ngarkim të paditësit ( të pandehur në hetim) Tonin Gjinaj, jemi përpara kushteve të nenit 268/3 të K.Pr.Penale, i cili parashikon të drejtën e kompensimit të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga prokurori”.*

4. Kur me vendim të gjykatës është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atëpjesë tëparaburgimit tëvuajtur para shfuqizimit;

Duke u bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat bëjnë fjalë drejtpërdrejtë ose që kanë lidhje me kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se rrethi i personave që legjitimohen të ngrenë padi me objekt kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë, përbëhet nga:

- a) Personat që deklarohen të pafajshëm me vendim të formës së prerë.
- b) Të dënuarit që kanë qenë të paraburgosur me vendim të formës së prerë, kur vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa e sigurimit personal arrest në burg, është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 e 229 të K.Pr.Penale që

---

<sup>163</sup> Shih Vendimi datë 24.11.2011.

bëjnë fjalë, respektivisht, për kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal.

- c) Të paraburgosurit, që ishin arrestuar në flagrancë, me vendim të oficerit ose agjentëve të policisë gjyqësore, kur çështja në ngarkim të tyre është pushuar nga gjykata ose prokurori, përjashtoj rastet e pushimit të çështjes për shkak amnistie.
- d) Të paraburgosurit që ishin ndaluar me urdhër të prokurorit kur çështja në ngarkim të tyre është pushuar nga gjykata ose prokurori, përjashtoj rastet e pushimit të çështjes për shkak amnistie.
- e) Të paraburgosurit që lirohen me vendim të gjykatës, sipas të cilit vërtetohet që fakti për të cilin ata ishin arrestuar, nuk përbën veprë penale për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, të cilët kompensohen për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur pas shfuqizimit të dispozitës.
- f) Personat që marrin pafajësinë gjatë rishikimit të një vendimi penal të formës së prerë dhe trashëgimtarët e personit të burgosur padrejtësisht, kur i dënuari vdes gjatë, mbas ose dhe para procedimit të rishikimit penal të formës së prerë me të cilin ai ishte deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim.

Neni 269 “*Kërkesa për kompensim*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Kërkesa për kompensim duhet të bëhet, ndryshe nuk pranohet, brenda tre viteve nga data në të cilin vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë.

Paditësi legjitimohet në kërkimin e tij për kompensimin e burgimit që ai ka vuajtur padrejtësisht duke respektuar me pasojë mospranim afatin e përcaktuar nga legjislacioni i cili

është brenda tre viteve. Kjo e drejtë e paditësit sanksionohet nga neni 44 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që shprehimisht thotë se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”*, si dhe neni 9 i K.Pr.Penale, që parashikon se: *“Personave që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë u kthehen të drejtat dhe shpërblehen për dëmin e pësuar...”*.

2. Masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin nështëpi caktohen me ligj të veçantë .

E drejta e kompensimit për burgim të padrejtë, mënyra e llogaritjes së tij, si dhe procedurat për kërkimin, dhe pagesën e kompensimit gjejnë rregullim të posaçëm në Ligjin nr.9381, datë 28.4.2005, *“Për kompensimin e burgimit të padrejtë”*.

Masa e kompensimit për burgim të padrejtë gjen rregullim në nenin 5 të këtij ligji në të cilin përcaktohen kriteret që duhen mbajtur parasysh për këtë lloj dëmshpërblimi.

Në vendimin e datës 10.4.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është shprehur se të dyja gjykatat më të ulëta kanë përcaktuar masën e kompensimit për burgim të padrejtë që i takon paditësit, në mënyra të ndryshme, vetëm duke iu referuar pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji ku shprehimisht thuhet: *“...për personat që përfitojnë nga ligji i mësipërm dhe kanë qenë të papunë të paktën një muaj para datës së burgimit, (rezulton që paditësi ka qenë i papunë para se të ndalohej dhe kur është vendosur masa e sigurimit arrest në burg), merret parasysh paga minimale në shkallë vendi, pa iu referuar pikës 2 të të njëjtit nen, ku parashikohet shprehimisht se: “Kompensimi caktohet deri në 2.000 lekë për një ditë burgim dhe deri në 3.000 lekë për një ditë paraburgim”*.

Në analizë sa më sipër, zgjidhja që gjykatat i kanë dhënë mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi gjyqësor është në kundërshtim me ligjin nr.9381, datë 28.04.2005, *“Për kompensimin*

*e burgimit të padrejtë*”, dhe si rrjedhojë e kërkimeve të paditësit në këtë gjykim nuk i është dhënë zgjidhje e drejtë në përputhje me ligjin.

Në rastin konkret, vlerësoj se duhet të merret në analizë dhe konsideratë e gjithë përmbajtja dhe parashikimet që ligjvënësi ka bërë në nenin 5 të këtij ligji, dhe jo vetëm një pjesë e kësaj dispozite, siç është a i pagës minimale në shkallë vendi. Në rast se sa më sipër, do të ishte e mjaftueshme, ligjvënësi nuk kishte përse të parashikonte dhe të përcaktonte në mënyrë eksplicite faktin që masa e dëmshpërblimit për një ditë paraburgim vlerësohet deri me 3.000 Lekë.

Vlerësoj se ligjvënësi ka përcaktuar këtë kufi për vlerësimin e masës së kompensimit, pasi ky lloj dëmshpërblimi, nuk përbëhet vetëm nga humbja ekonomike që ka pësuar individ apo familja e tij nga burgimi i padrejtë, por dhe nga dëmi moral dhe social që ka pësuar ky individ apo familja e tij nga kjo ngjarje, si dhe rivendosja e të gjitha të drejtave të shkelura apo të mohuara gjatë kësaj periudhe. Të njëjtin qëndrim mban dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

Në këto kushte, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vlerëson se parashikimet e nenit 5 të këtij ligji, duhet të vlerësohen nga gjykatat më të ulëta së bashku dhe në harmoni të plotë me pikën 2 të këtij ligji duke pasur parasysh që sa më sipër përbën kufirin maksimal të kompensimit për burgim të padrejtë. Gjykatat në përcaktimin e masës së dëmshpërblimit duhet të vlerësojnë drejt të gjitha kriteret e parashikuara në ligj, dhe jo t'i veçojë ose ndajë ato nga njëra-tjetra.



## KAPITULLIII

### MASAT E SIGURIMIT PASUROR

#### 3.1. Tipologjia e masave të sigurimit pasuror

Regjimi juridik i masave të sigurimit pasuror gjen vend në një kre të veçantë, dedikuar këtyre masave. Kjo zgjedhje sistematike, vë në dukje dhe ka për qëllim nënvizimin e faktit të karakterit specifik dhe finalist të masave të sigurimit pasuror, duke qenë se këto masa dallojnë nga masat e tjera. Ky dallim konsiston në qëllimin që ndjekin këto masa, i cili është i ndryshëm nga a i sigurimit personal.

Qëllimi i masave të sigurimit pasuror është i drejtuar drejt pasurisë së personit ndërsa qëllimi i masave të sigurimit personal është i drejtuar drejt vetë personit ndaj të cilit merret kjo masë. Masat e sigurimit pasuror duhen dalluar nga sekuestro penale, parashikuar në seksionin e tretë, të kreut të tretë, të titullit të katërt, të K.Pr.Penale. Këto dy institute dallojnë nga njëri tjetri nga qëllimi që ato ndjekin. Sekuestro penale është mjet kërkimi i provave të lidhura me veprën penale, të cilat merren dhe nga prokurori e jo vetëm nga gjyqtari, ndërsa sekuestro konservative dhe preventive janë masa sigurimi pasuror, të cilat në çdo rast duhen marrë nga gjykata.

Qëllimi i sekuestros penale është akumulimi i sa më shumë provave që kanë lidhje dhe vërtetojnë veprën penale, ndërsa qëllimi i masave të sigurimit pasuror është sekuestrimi i pasurisë të pandehurit, për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin për të nga vepra penale dhe për të disponuar nga i pandehuri pasurinë në mënyrë të lirë.

Masat e sigurimit pasuror i klasifikojmë në dy lloje: sekuestro konservative dhe sekuestro preventive. Që të dyja këto masa sigurimi merren vetëm me vendim të disponuar nga gjyqtari në bazë të kërkesës së prokurorit, apo dhe kërkesës së paditësit civil në rastin e sekuestros konservative.

### 3.2. Sekuestroja konservative

Neni 270 “Kushtet dhe efektet e masës”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre.

Praktika gjyqësore ka treguar se, ka shumë raste ku është marrë vendimi për vendosjen e masës së sigurisë sekuestro konservative jo në zbatim korrekt të këtij neni. Jo çdo rast përbën nevojën për ta marrë këtë masë, pasi duhet të ekzistojnë shkaqet që e justifikojnë atë dhe çka është shumë e rëndësishme interpretimi i saktë i fjalës “caqe”.

2. Paditësi civil mund të kërkojë sekuestron konservative të pasurisë së të pandehurit ose të të paditësit civil, kur janë arsye të parashikuara në paragrafin 1.

Në këtë paragraf na tregohen subjektet e legjitimuara për të bërë kërkesë për marrjen e masave të sigurimit pasuror, të cilët janë prokurori dhe paditësi civil.

3. Sekuestroja e vendosur me kërkesën e prokurorit është e vlefshme edhe për paditësin civil.

Kur ndodhemi para rastit, ku kërkesa është bërë vetëm nga prokurori dhe jo nga paditësi civil, një kërkesë e tillë është e vlefshme dhe për të. Pra ai do të përfitojë nëse kërkesa pranohet nga gjykata.

Në rastin kur kërkesa është bërë nga prokurori dhe nga paditësi civil njëkohësisht, ajo do të paraqitet sikur është bërë nga prokurori por duke pasur efekt për të dy. Kjo lidhet me faktin se prokurori është ai që merret me hetimin dhe ka informacion të plotë në lidhje me rrethanat e faktit.

Kemi dhe rastin kur kërkesa është paraqitur vetëm nga paditësi civil, kjo kërkesë do të jetë e vlefshme vetëm për të dhe prokurori nuk mund të përfitojë nga e drejta për t'iu drejtuar gjykatës në lidhje me kërkesat e tij, për sa kohë nuk ka paraqitur kërkesë pranë gjykatës.

Neni 271 “*Vendimi i gjykatës për sekuestron*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Sekuestroja konservative vihet me vendim të gjykatës kompetente.
2. Kur është dhënë vendim në shkallë të parë, sekuestroja vihet para se aktet t'i dërgohen gjykatës së apelit.
3. Sekuestroja zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor në mënyrat e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile.
4. Efektet e sekuestros pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë .

Në këtë nen tregohen qartë subjektet kompetentë për vendosjen e një mase sigurimi sekuestro konservative, për vënien në zbatim të saj, gjithashtu dhe kur kjo masë e humbet fuqinë për shkaqet e cituara më lart. Një masë e tillë vendoset nga gjykata civile duke respektuar njëkohësisht këto nene dhe nenet e K.Pr.Civile në lidhje me vendosjen e kësaj mase sigurie.

Neni 272 “*Oferta për garantimin e detyrimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Kur i pandehuri ose i padituri civil ofron një mjet të përshtatshëm ligjor për të garantuar detyrimin (peng, dorëzani, kapar, hipotekë), gjykata nuk e vë sekuestron konservative ose e revokon atëdhe cakton mënyrën e ekzekutimit të detyrimit.
2. Kur oferta propozohet bashkë me kërkesën e ankimit, gjykata revokon sekuestron nëqoftë se çmon se oferta e garantimit është në përpjesëtim me vlerën e sendeve tësekuestruara.

Neni 273 “*Ekzekutimi i masës sësekuestrros*”, i Kodit tëProcedurës Penale:

1. Sekuestroja konservative shndërrohet në sekuestro të ekzekutueshme kur merr formëtëprerë vendimi i dënimit me gjobë apo ai i detyrimit të të pandehurit dhe tëpaditurit civil me shpërblimin e dëmit.
2. Ekzekutimi i detyrueshëm i pasurisë së sekuestruar bëhet në mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Nga të ardhurat e shitjes së pasurisë së sekuestruar dhe nga ato të mjeteve të ofruara për garantimin e detyrimit, paguhen, sipas radhës, shumat që i takojnë paditësit civil për shpërblimin e dëmit dhe shpenzimet gjyqësore, dënimet me gjobë, shpenzimet e procedimit dhe çdo shumë tjetër në favor të shtetit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është shprehur se:<sup>164</sup> “*Me të drejtë nga të dyja gjykatat e faktit, duke u konstatuar se kërkesa e paditësit për sigurimin e padisë ishte e bazuar në dispozitën e nenit 202 e vijues të K.Pr.Civile është vendosur vënia e sekuestrros conservative mbi një sërë pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme të të paditurit. Me këtë vendim, gjykatat kanë krijuar të gjitha garancitë për paditësin që në eventualitet të zgjidhjes së konfliktit ne favor të tij të bëhej i mundur edhe ekzekutimi i detyrimit nga ana e të paditurit duke mos i dhënë atij mundësinë që të tjetërsonte pasuritë e tij.*

<sup>164</sup>Shih vendimin nr. 08.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

*Por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, çmon se të njëjtat garanci që gjykatat i kanë dhënë paditësit duke vendosur sekuestro mbi pasuritë e të pandehurit, duhet ti jepen edhe të paditurit i cili në eventualitetin që padia do të rrëzohet duhet të ketë të gjitha garancitë që të shpërblehet lidhur me dëmin e mundshëm që do t'i shkaktonte qenia nën sekuestro e pasurive të tij monetare e materiale. Në këtë frymë është edhe dispozita e nenit 202 të K.Pr.Civile, sipas të cilës edhe kur paditësi e mbështet padinë në prova me shkresa, gjykata mund të vendosë ndaj tij edhe një garanci për dëmin e mundshëm që do t'i shkaktohej të paditurit nga sigurimi i padisë”.*

Vlerësoj se Gjykata e apelit që e ka vendosur këtë garanci gjithashtu edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë që e ka lënë në fuqi, nuk përbën kusht thelbësor që ligji kërkon në mënyrë të domosdoshme për marrjen e masës së sigurisë. Në mënyrë që ajo e drejtë, të cilën paditësi do të kërkojë ta arrijë me padinë do të paraqesë në gjykatë, të moj jetë e kërcënuar nga një dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, ligjvënësi i ka dhënë të drejtë këtij të fundit të kërkojë në gjykatë marrjen e masave për sigurimin e saj edhe përpara ngritjes së padisë.<sup>165</sup>

Ligjvënësi ka parashikuar sigurimin e padisë jo vetëm për të siguruar të drejtën, e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve të paditësit, por në të njëjtën kohë këtë parashikim e ka bërë dhe me qëllimin që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor që është duke u realizuar mes palëve.

Vlerësoj se, në gjykime të këtij lloji në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një mase sigurimi padie duhet të hetojë ekzistencën e dy kushteve thelbësore:

- a. ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë;

---

<sup>165</sup> Shih neni 204 të K.Pr.Civile.

- b. ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Për të krijuar bindjen në lidhje me mundësinë e ekzistencës të së drejtës që kërkohet të rivendoset, për gjykatën është e mjaftueshme që padia të jetë e mbështetur në prova shkencore, pasi këto të fundit i lejojnë gjykatës që të krijojë një njohje të shpejtë të së drejtës që pretendohet se është shkelur. Në rastin konkret gjykatat e faktit kanë pohuar dhe pranuar se nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore, të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor ka rezultuar se pala paditëse kërkimin e saj e ka mbështetur mbi provat shkencore të tilla si, praktikatat e dërgimit të mallit të palës së paditur nga ana e palës paditëse dhe pasqyra financiare etj.

Nisur nga këto prova, gjykatat janë bindur se ekziston mundësia e një të drejtë, e cila sipas paditësit është mohuar dhe shkelur, të drejtë të cilën paditësi ia kërkon ta njohë dhe rivendosë nëpërmjet gjykimit të padisë së themelit.

Gjykata e apelit edhe pse pranon në vendimin e saj ekzistencën e të gjitha provave shkencore vendos plotësimin e vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke vendosur garanci për kërkimin që pala paditëse ka bërë.

Nga një interpretim dhe analizë të nenit 202, vlerësoj se nuk është e domosdoshme plotësimi në mënyrë të menjëhershme dhe të kondicionuar i të dyja kushteve të parashikuara në këtë normë procedurale.

Në lidhje me kushtin e dytë që duhet plotësuar për marrjen e një mase sigurimi padie, vlerësoj se në çështjen objekt gjykimi, marrja e kësaj mase është e domosdoshme, duke pasur parasysh dhe pretendimet e ngritura nga pala paditëse gjatë gjykimit dhe të vërtetuara me prova shkencore se ekziston mundësia që ekzekutimi i vendimit që do të marrë gjykata për të drejtën e pretenduar mund të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Në të njëjtën kohë pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë provë që të hedhë poshtë pretendimin dhe provat e palës paditëse për mosekzistencën edetyrimit apo shlyerjen e tij, por janë administruar vetëm provat e palës paditëse, nga shqyrtimi it ë cilave, çmojnë se palës mund ti vijë si pasojë rreziku i mosekzekutimit të vendimit në rast se kërkimet do të mund të pranohen.

Gjithashtu e vlerësoj të pabazuar vendimin e gjykatës së apelit edhe për faktin se nëse kjo gjykatë do kishte dashur që me vendosjen e garancisë, për të garantuar edhe palën e paditur, do kishte vënë një garanci në masën e detyrimit që ka pretenduar pala paditëse se ekziston, pasi ajo masë garancie e caktuar nuk është as e arsyetuar dhe as e justifikuar, duke pasur parasysh që është pranuar vendosja e masës për sigurimin e padisë për një detyrim shumë herë më i lartë.<sup>166</sup>

### 3.3. Sekuestroja preventive

Neni 274 “*Objektivi i sekuestros preventive*”, i Kodit të Procedurë s Penale:

1. Kur ka rrezik që disponimi i lirëi njësendi qëlidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

Pra del qartë se kjo masë vendoset për të bërë të mundur zëvendësimin e dëmit të shkaktuar nga kryerja e një veprë penale, duke bërë të mundur ruajtjen e pasurisë nga çdo lloj tjetërsimi, por gjithmonë kjo pasuri të jetë produkt i veprës penale, d.m.th. të ketë të dhëna që ajo është krijuar si pasojë e realizimit të veprës penale.

---

<sup>166</sup> Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe pakica në këtë vendim.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

Në këtë dispozitë përcaktohet se sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K.Penal.<sup>167</sup>

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Kjo dispozitë na tregon se sekuestro gjithmonë i shërben qëllimit të vendosjes së saj. Në momentin kur ka mbaruar shkaku i marrjes së sekuestros preventive me kërkesë të subjekteve të tilla si prokurori ose të të interesuarve që këtu nuk kemi përcaktim specifik, por që vlerësohet rast pas rasti, gjykata ka detyrimin ligjor ta heqë atë.

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: *“Vendimi nr.35, datë 10.03.2011 i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.337, datë 15.12.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë marrë në aplikim të gabuar të dispozitave ligjore që bëjnë fjalë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive e për pasojë duhet të ndryshohen.*

*Nga aktet e administruara rezulton, se në datën 11.12.2010 është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit Gentian Hoxha me detyrë specialist marketingu pranë BKT-se Vlorë, si i dyshuar për veprën penale të vjedhjes me anë të shpërdorimit të detyrës, falsifikimit të dokumenteve, pastrimit të produkteve të veprës penale kryer në bashkëpunim, ndërhyrjes në të dhënat kompjuterike, të parashikuara nga nenet 135, 186, 287 e 25 dhe 293 të Kodit Penal dhe ndaj shtetasit Fatjon Hoxha si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve*

---

<sup>167</sup> Shih neni 36 të Kodit Penal.



të veprës penale në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287-25 i K.Penal. Mbi këtë bazë me datën 14.12.2010 prokuroria ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë caktimin e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive ndaj të dy të dyshuarve. Me vendimin nr.337, datë 15.12.2010 gjykata e rrethit ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale, ka vendosur sekuestron preventive mbi aktivitetin e sh.p.k “ADION”, bar-kafe, bibliotekë, sallë konferencash, studio incizimi këngësh, si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me këtë aktivitet tregtar, aktivitetin e kësaj shoqërie për bar-kafe Franksi, investimi i realizuar ne Lagjen “Uji i Ftohtë”, Hotel “Aliko” investimi realizuar në Pallatin e Sportit Vlorë si dhe çdo send tjetër me këtë investim në vlerën 32.971.190 lekë.

Në vendimin e marrë, gjykata e rrethit arsyeton se nga kontrollet e ushtruara në ambientet e shtetasve Gentian Hoxha dhe Fatjon Hoxha, ndodhur në ambientet e sh.p.k “ADION” me përfaqësues dhe administrator Fatjon Hoxha, janë gjetur e sekuestruar një sërë dokumentesh dhe kontrata qiraje dhe sipërmarrjeje të lidhura midis Fatjon Hoxhës dhe shtetasve të tjerë dhe Bashkia Vlorë, duke kryer investime në pallatin e sportit, hotel “ALIKO”, bar-kafe “Franksi”, bar-kafe, sallë konferencash “ADION”. Më tej gjykata arsyeton se ekzistojnë plotësisht dyshime se i gjithë aktiviteti dhe asetet e shoqërisë “ADION” janë produkt i aktivitetit kriminal të të dy të dyshuarve Gentian e Fatjon Hoxha dhe në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale duhet të vendoset masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive, e cila duhet të vendoset edhe për sendet produkt i veprës penale si dhe çdo lloj pasurie që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K.Penal, sipas të cilit konfiskimi i jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen e kalimin në favor të shtetit të produkteve të veprës penale ku përfshihet dhe çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumente që vërtetojnë tituj ose interesa të tjera në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt, ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kanë paraqitur ankim (pasi kanë marrë dijeni për të) shtetasit Mynyr e Paqyze Çeçi, me pretendimin se vendosja e sekuestron preventive mbi objektet ishte i pabazuar sepse ato ishin pronë e tyre dhe ishin dhënë me qira për ushtrimin e aktivitet të Shoqërisë “ADION”, Fatjon Hoxhës. Ankimi i tyre është

*bërë ne bazë të nenit 276/1 të K.Pr.Penale, sipas të cilit “kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros, cilido që ka interes mund të bëjë ankim”.*

*Në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, ankuesit kanë paraqitur dokumente për të vërtetuar pronësinë e tyre dhe kontratat përkatëse të dhënies me qira duke kërkuar heqjen e sekuestros mbi to, ndërsa prokurori, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, arsyeton se shoqëria ka bërë investime të konsiderueshme që kanë shtuar vlerën e objekteve, investime që mund të tjetërsohen dhe se heqja e sekuestros në momentin që ka filluar të zbardhet aktiviteti kriminal është e dëmshme për zëvendësimin e dëmit të shkaktuar.*

*Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.35, datë 10.03.2011 ka vendosur miratimin e vendimit nr.337, datë 15.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me arsyetimin se ishte i bazuar në ligj e në prova (theksojmë se vendimi i gjykatës së rrethit ishte i miratuar edhe me vendimin nr.233, datë 28.12.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e shtetasit Fatjon Hoxha). Së pari në vendim arsyetohet nëse janë kushtet për vendosjen e masës së sigurimit të pasurisë sekuestro preventive dhe thuhet se, si në rastin e vendosjes së masave të sigurimit personal edhe për vendosjen e sekuestros preventive, kriteri i nevojshëm që të vendoset kjo masë është dyshimi i arsyeshëm dhe në rastin konkret janë sekuestruar me cilësinë e provës dokumente, llogari bankare, librezat e banke, etj, si dhe kontrata qiraje e sipërmarrjesh të lidhura midis shtetasit Fatjon Hoxha me shtetas të tjerë, duke përfshirë dhe ankuesit ambientet e të cilëve janë marrë me qira dhe në to janë kryer investime të shumta në vlera të mëdha. Pavarësisht se ekziston termi masë sigurimi personal dhe masë e sigurimit të pasurisë, për vendosjen e tyre nuk janë të njëjtat kritere. Është e domosdoshme që për vendosjen e masës së sigurimit personal të ekzistojnë dyshime të bazuara në prova për kryerjen e një veprë penale nga personi i dyshuar, ndërsa sekuestroja preventive vendoset mbi objekte që ka të dhëna se janë produkt i një veprë penale dhe në nenin 274/1 të K.Pr.Penale theksohet se “Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të*

arsyetuar”. Pra del qartë se kjo masë vendoset për të bërë të mundur zëvendësimin e dëmit të shkaktuar nga kryerja e një vepre penale, duke bërë të mundur ruajtjen e pasurisë nga çdo lloj tjetërsimi, por gjithmonë kjo pasuri të jetë produkt i veprës penale, d.m.th. të ketë të dhëna që ajo është krijuar si pasojë e realizimit të veprës penale dhe në pikën 2 të nenit 274 të K.Pr.Penale përcaktohet se sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K.Penal. Në shqyrtimin gjyqësor të çështjes në gjykatën e apelit, ankuesit Paqyze e Mynyr Çeçi kanë pretenduar se objektet mbi të cilat gjykata e rrethit ka vendosur sekuestron preventive kanë qenë në pronësi të tyre para shumë vitesh se t’i jepeshin me qira Fatjon Hoxhës, duke paraqitur dhe dokumentet përkatëse të pronësisë e të dhënies me qira për t’u përdorur prej qiramarrësit në përputhje me interesat e shoqërisë e duke bërë investimet përkatëse për përshtatjen e destinacionit shërbyes. Kështu janë paraqitur nga ankuesit dhe janë administruar nga gjykata certifikata për vërtetimin e pronësisë, lëshuar nga Z.R.P.P. me 04.10.2005 nga ku del se në pronësi të shtetasit Mynyr Çeçi, në Lagjen “28 Nëntori” të qytetit të Vlorës, në regjistrin përkatës me nr.22/84 është një ndërtesë me sipërfaqe 45 m2 dhe dokumentet e plotësuar për vetëdeklarim për legalizim datë 15.03.2009 plotësuar nga Mynyr Çeçi për një shtëpi banimi dykatëshe me sipërfaqe 200 m2, ndërsa në Lagjen “28 Nëntori” një ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 150 m2. Gjithashtu janë administruar kontrata e qirasë me nr.464 Rep., e nr.247 Kol., datë 10.03.2008 lidhur midis qiradhënësve Paqyze e Mynyr Çeçi dhe qiramarrësit Gentian Hoxha, për ndërtesën me sipërfaqe 45 m2 e ndërtesat në proces legalizimi. Kontrata ku përcaktohen kushtet përkatëse, kryerja e investimeve sipas destinacionit, si dhe fakti se me përfundimin e afatit të qiradhënies objektet bashkë me gjithë ndryshimet e investimet e bëra, mbeteshin në pronësinë e qiradhënësve, ankuesve Paqyze e Mynyr Çeçi.

Nga aktet rezulton edhe kontrata e sipërmarrjes lidhur me Bashkinë e Vlorës, nga personat nën hetim Gentian e Fatjon Hoxha, aktet për themelimin e Sh.P.K. “ADION” me ortak të vetëm Fatjon Hoxhën, në datë 10.06.2010, për regjistrimin e Sh.P.K. “ADION”, në bar-kafe, në godinën dykatëshe me 21.01.2010, formulari i garancisë së B.K.T. Vlorë datë 11.06.2010 nga del se Fatjon Hoxha ka ngurtësuar pranë kësaj banke shumë prej 3.000.000 lekë, si kapital themelor për njohjen e Sh.P.K. “ADION”.

*Duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur para gjykatës së apelit, kjo gjykatë arsyeton se në pronësi të ankuesve figuron që para vitit 2005 një dyqan me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> në lagjen “Lef Sallata”, ndërsa për sa i përket godinës dykatëshe përbërë nga një banesë në katin e dytë me sipërfaqe 190 m<sup>2</sup>, apartament banimi në katin e parë me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> dhe për sa i përket një objekti njëkatësh me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, ankuesit janë në proces legalizimi prej vitit 2005 e këto pasuri të paluajtshme i janë dhënë me qira prej ankuesve Shoqërisë “ADION” në vitin 2008. Por gjithashtu në vendim arsyetohet se provohet dyshimi se paratë e vjedhura në bankë nga Gentian Hoxha shkojnë deri në 2.000.000 Euro, janë investuar në disa aktivitete biznesi, pra investimet janë kryer në sendet e paluajtshme në pronësi të ankuesve e këto investime nëpërmjet përdorimit të produkteve të veprës penale nuk mund të veçohen e nuk mund të hiqen, se ekziston rreziku, ose disponimi i lirë i investimeve të kryera do të rëndonte dhe zgjaste pasojat e veprës penale, si lind rreziku që ato të dëmtohen ose të zhduken, gjë që do të vështirësonte mundësinë e rikthimit të vlerave të tyre subjektit të dëmtuar dhe se fakti që këto investime janë kryer në objekte të marra me qira në pronësi të ankuesve nuk përbën kusht për të vendosur masën e sigurimit pasuror sekuestro preventive.*

*Ky vendim i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit e në kapërcim të kërkesave të vendosjes së masës së sigurimit të pasurisë sekuestro preventive. Është vërtetuar dhe pranohet nga gjykata pa asnjë ekuivok se sendet mbi të cilat është vendosur sekuestroja preventive janë objekte në pronësi të kërkuesve që ju janë dhënë me qira personave nën hetim për të kryer aktivitet tregtar e derisa ato janë në pronësi të personave të tjerë, dhe nuk ka prova apo dyshime se midis tyre ka lidhje në kryerjen e aktivitetit kriminal, mbi to nuk mund të vendoset sekuestro preventive. Këto objekte janë ndërtuar disa vjet para se të dyshuarit Gentian e Fatjon të fillonin aktivitetin e tyre kriminal, janë dhënë me qira me një afat përdorimi prej 9 vjetësh, pjesa e investimeve është bërë për t’u përshtatur për veprimtarinë e shoqërisë e nuk ndryshon tërësinë e objekteve që në përfundim të afatit të qirasë mbeteshin në pronësi të ankuesve, së bashku me investimet e bëra pa shpërblim.*

*Meqenëse sekuestroja preventive është vendosur në kundërshtim me kërkesat e nenit 274 të K.Pr.Penale, mbi sende që nuk mund të vendosej sekuestro, vendimet e gjykatave janë të cenueshme e duhet të ndryshohen”.*

Neni 275 “*Humbja e fuqisë së sekuestros*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t’i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë që në prodhim ose përfitim nga vepra penale.
2. Kur është dhënë vendimi i dënimit, efektet e sekuestros vazhdojnë në rast se është vendosur konfiskimi i sendeve të sekuestruara.
3. Sendet e sekuestruara nuk kthehen kur gjykata vendos që të mbahet sekuestroja për garantimin e kredive.

Neni 276 “*Ankimi kundër vendimit*”, i Kodit të Procedurës Penale:

1. Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim.

Subjektet që mund të ankimojnë këtë vendim nuk kufizohen, kjo do të thotë se ankimi mund të bëhet nga cilido që ka interes. Këto subjekte që kanë interes mund të jenë: i pandehuri ose mbrojtësi i tij, i padituri civil, paditësi civil, prokurori, trashëgimtarët e paditësit civil etj, si dhe çdo person që pretendon të drejta pronësie mbi sendin e sekuestruar.

2. Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita qëi interesuari ka marrë dijeni për sekuestrimin e vënë .

Kërkesa e personit që ankimon vendimin duhet të jetë e motivuar, ai duhet të paraqesë ato arsye që e bëjnë atë të ankimojë këtë vendim, gjithashtu arsyet duhet të jenë të reja, pra jo ato të paraqitur më parë në proces nga pala.

Kërkesa duhet të paraqitet brenda afatit dhjetë ditor, dhe ky afat fillon nga e nesërmeja e vendimit apo njoftimit. Ky afat i është lënë në dispozicion të interesuarit, që të përgatis arsyet në të cilat ai do të mbështetet për të ankimuar vendimin, në momentin kur kërkesës nuk i është bashkangjitur arsyetimi, ajo nuk pranohet.

3. Kërkesa paraqitet në sekretarinë gjykatës qëka dhënë vendimin.

4. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës.

5. Mbi kërkesën e ankimit vendos gjykata e apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.

Gjykata në lidhje me këtë kërkesë duhet të vendosë brenda pesëmbëdhjetë ditëve, nga dita që aktet janë depozituar pranë sekretarisë së saj.

6. Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit të ankimit.

Gjykata disponon me shfuqizim, ndryshimin ose miratimin e vendimit të ankimit. Kjo varet sipas rastit konkret, me të vetmin kusht që vendimi në çdo rast të jetë i motivuar.

7. Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, vendimi për vënien e sekuestros e humbet fuqinë.

Gjykata ka një afat që duhet ta respektojë për sa i përket kohës së shpalljes së këtij vendimi.

## KAPITULLI IV

### ZHVILLIMI HISTORIK DHE TEORIK I TE DREJTËS PENALE NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT

#### **4.1. Masat e sigurimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1979**

K.Pr.Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.6609, datë 25.12.1979, ka hyrë në fuqi me datë 01.04.1980. ky kod mbeti në fuqi deri më datë 01.08.1995, kur me ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, u miratua Kodi i Ri i Procedurës Penale. Kodit të vitit 1980 me ligjin nr.7086, datë 08.05.1990, iu bë ndryshim në lidhje me lejimin e mbrojtjes me avokat, me ligjin nr.7536, datë 17.12.1991, u shfuqizua dispozitat që politizonin procesin penal. Me ligjin nr.7574, datë 24.06.1992, “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale dhe civile”, u ndryshua sistemi gjyqësor dhe u krijua gjykata e kasacionit dhe gjykata e apelit. Këto ndryshime erdhën si pasojë e ndryshimit të sistemit politik në Shqipëri.

K.Pr.Penale i Rep. Popullore të Shqipërisë, ashtu si dhe aktet apo ligjet e tjera në fuqi gjatë periudhës komuniste, ishte tërësisht i politizuar dhe i doktrinuara nga fryma socialiste që mbizotëronte në vend. Në këtë kod pasqyrohen dhe sanksionohen parimet revolucionare të udhëheqjes dhe politikës së partisë, lufta e klasave dhe zbatimi i vijës së masës. Ky kod shpalli varësinë e gjykatave nga politika, i hoqi prokurorit funksionet e ndjekjes penale, mohoi mbrojtjen me avokat, rikonfirmoi të drejtën e hetuesit për marrjen e masave të sigurimit dhe kontrolleve, duke mos i njohur gjykatës të drejtën e kontrollit dhe miratimit të veprimeve procedurale më të rëndësishme për fazën e hetimit paraprak. Në këtë kod u mohuan të gjitha parimet dhe standardet demokratike të procedimit penal dhe u pranuan rregulla të kundërta me to.

Qëllimet që ndiqte zbatimi i masave të sigurimit dhe masave shtrënguese shtetërore në të drejtën procedurale ishin këto:

1. Realizimi me sukses i detyrimeve të drejtësisë socialiste në fushën e hetimit dhe gjyqimit.
2. Demaskimi i dëmit të fajtorëve.
3. Në tërësi parandalimi i kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit. Pra qëllimi kryesor që ndiqte legjislatori nëpërmjet masave të sigurimit ishte mbrojtja e drejtësisë socialiste, duke e vendosur atë në një plan superior dhe të paprekshëm, kjo gjithmonë në frymën e një jete dhe shoqërie tërësisht kolektive në të cilën mbizotëronte vullnetarizmi. Në plan të parë raporti midis autorit të dyshuar për veprën penale dhe shtetit. Lihet tërësisht në plan të dytë raporti midis autorit të dyshuar për kryerjen e veprës penale dhe viktimës, raporti midis autorit të dyshuar dhe vetë veprës penale të kryer prej tij.

K.Pr.Penale, e vitit 1980, i ndan masat e sigurimit, në masa sigurimi dhe masa të tjera shtrënguese.

Në grupin e parë të masave të sigurimi hyjnë:

1. Arrestimi
2. Deklarata për moslargim

Në grupin e dytë, atë të masave të tjera shtrënguese hyjnë:

1. Ndalimi;
2. Sekuestrimi i pasurisë;
3. Sekuestrimi i korrespondencës së post-telekomunikacionit;
4. Largimi nga detyra;
5. Largimi i të pandehurit dhe personave të tjerë nga salla e gjyqit;



6. Sjellja me detyrim;
7. Këqyrja e personit;
8. Kontrolli;

Në grupin e parë bëjnë pjesë vetëm dy masa sigurimi, ajo e arrestit dhe e deklaratës për moslargim, ndërsa në grupin e dytë listohen 8 masa të tjera shtrënguese, ku ndër të tjera përfshihen veprime procedurale, të cilat Kodi i Ri i Procedurës Penale, i parashikon si mjete me anën e të cilave mund të kërkohen provat.

Masat e sigurimit sipas këtij kodi, kanë të bëjnë kryesisht me kufizimin e lirisë së personit që si rregull është marrës i pandehur për kryerjen e veprës penale, ndërsa masat e tjera shtrënguese procedurale zbatohen për të zbuluar, mbledhur, fiksuar provat material, për të garantuar rregullin në seancë gjyqësore, për të garantuar paraqitjen e të pandehurit dhe të personave të tjerë në hetuesi apo gjykatë, për të parandaluar vazhdimin e veprimtarisë kriminale. Disa nga këto masa (ndalimi, sjellja me detyrim, largimi i personave nga salla e gjyqit), ndryshe nga masat e sigurimit mund të zbatohen edhe ndaj personave që nuk janë marrë më parë si të pandehurit. Masat e sigurimi zënë një vend mjaft të rëndësishëm në sistemin e masave shtrënguese procedurale. Në nenin 47 të K.Pr.Penale të 1980 thuhet se: *“Për të siguruar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të hetimit e gjykimit, gjykata, gjyqtari i vetëm dhe hetuesi kanë të drejtën të marrin masat e sigurimit përkundrejt një personi që është marrë si i pandehur”*.

Në rastet e jashtëzakonshme masat e sigurimit mund të zbatohen ndaj një personi edhe para se ky të merret si i pandehur brenda 14 ditëve, masat e sigurimit hiqen.

Masat e sigurimit janë:

1. Detyrimi për moslargim
2. Arresti

Nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme rezulton se subjekti i cili mund të vendosë marrjen e masave të sigurimit është gjykata, gjyqtari i vetëm dhe hetuesia. Gjykata dhe gjyqtari i vetëm janë subjekte klasike në marrjen e masave të sigurimit, ndërsa hetuesia dhe hetuesi dalin si subjekte të veçanta që mund të kërkojnë dhe vendosin masat e sigurimit. Neni 7 i K.Pr.Penale të Rep.Popullore të Shqipërisë, thekson se hetuesia është organi që zhvillon hetimin për çështjen penale dhe se hetuesi vepron me iniciativë për drejtimin dhe zhvillimin e hetimeve për zbulimin e veprës penale dhe fajtorit si dhe për marrjen e çdo vendimi. Në veprimet që hetuesi kryen me iniciativë dhe në kuadër të zhvillimit të hetimit është marrja e masave të sigurimit. Ajo që rezulton nga përmbajtja e nenit 47 është se prokurori nuk përfshihet në kategorinë e subjekteve që mund të marrin, vendosin ose kërkojnë marrjen e masave të sigurimit. Në nenin 6 përcaktohet që prokurori është një organ që kontrollon zbatimin e përpiktë dhe të njëllojtë të ligjeve në të gjithë veprimtarinë procedurale penale dhe merr masa që të mos veprohet në kundërshtim me ligjin. Pra, roli i prokurorit është më tepër a i një supervizori teknik të veprimtarive procedurale të organeve. Në këtë mënyrë shkapëputet lidhja ndërmjet prokurorisë dhe veprës penale, hetimit, gjykimit duke përqendruar vëmendjen vetëm tek organi i hetuesisë.

Subjekti mbi të cilin mund të vendoset masa e sigurimit, është vetëm i pandehuri, vendim të cilin sipas nenit 35, e merr gjykata, gjyqtari i vetëm ose hetuesi. Megjithatë, në paragrafin e dytë të nenit 47, përcaktohet se në raste të jashtëzakonshme masat e sigurimit mund të zbatohen edhe ndaj një personi edhe para se ky të jetë marrë si i pandehur, në këtë rast është e domosdoshme që ky person brenda 14 ditëve të merret si i pandehur, në të kundërt masa e sigurimit e humbet fuqinë. Arsyeja mbi të cilin mbështetet fakti që masat e sigurimit mund të vendosen vetëm ndaj të pandehurit është fakti se kufizimi i sigurisë personale të shtetasit mund të bëhet vetëm pasi për çështjen në fjali të jenë mbledhur prova të mjaftueshme të cilat lejojnë marrjen e një mase të caktuar.

Megjithatë, marrja e një personi si të pandehur dhe komunikimi i akuzës në vetvete akoma nuk mund të shërbejë si bazë për zbatimin e masës së sigurimit. Përjashtimi nga rregulli sipas paragrafit të dytë të këtij neni, mbështetet në faktin se kemi të bëjmë me krime të rënda

për të cilat kërkohet izolim i menjëhershëm i autorit nga shoqëria, ndërprerja e vazhdimit të veprimtarisë kriminale dhe pasojave që mund të vijnë prej saj.

Studimi i të dhënave për personalitetin e personit që ka kryer veprën penale është i domosdoshëm që të fillojë që pa filluar hetimi, duke qenë se studimi i personalitetit luan një rol mjaft të rëndësishëm në lidhje me rrezikshmërinë shoqërore të tyre dhe të veprës penale të kryer prej tyre. Si rrethanë për tu vlerësuar është dhe gjendja shëndetësore e të pandehurit. Ku si gjendje shëndetësore të të pandehurit kuptohen jo vetëm sëmundje që ai mund të ketë por edhe shtatzënia. Si rrethanë për tu vlerësuar është përhapja e veprës penale, gjendja familjare e të pandehurit, mundësia e vazhdimësisë së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, mospasja e një vend qëndrimi etj. Masa më e rëndë është arresti, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me parimin kushtetues të paprekshmërisë së personit dhe që në thelb nuk është gjë tjetër veç provim i lirisë së personit, izolim nga shoqëria.

Doktrina e kohës ka bërë dallimin midis masave shtrënguese procedurale dhe dënimit nga ana tjetër. Këto dallime janë në tre drejtime:

1. Së pari, arresti zbatohet ndaj të pandehurit në rastet e jashtëzakonshme ndaj të dyshuarit, ndërsa dënimi zbatohet vetëm ndaj personave të deklaruar fajtorë me një vendim gjykate dënimi;
2. Së dyti, arresti merret edhe nga hetuesia ndërsa dënimi kurdoherë merret nga gjykata;
3. Së treti, qëllimi kryesor i arrestit është zhvillimi i drejtë dhe i shpejtë i hetimeve dhe gjykimit ndërsa qëllimi i dënimit është ndalimi i veprimtarisë së mëtejshme keqbërëse të fajtorit, edukimin e tij si dhe ndikimin e tij tek shtetasit e tjerë me frymën e respektimit të ligjeve.

K.Pr.Penale i vitit 1980, nuk njeh dhe nuk parashikojnë institutin e kohëzgjatjes së masave të sigurimit, duke bërë kështu që këto masa të kenë një kohëzgjatje të pacaktuar, duke lënë të pandehurin në dispozicion të hetuesisë, për të gjithë kohën që ajo e konsideron të

nevojshme. Ky kod parashikon dy institute mjaft të rëndësishëm, atë të heqjes dhe ndryshimit të masave të sigurimit. Në nenin 51 të tij, parashikohet se masa e sigurimit mund të hiqet vetëm kur një gjë e tillë përcaktohet nga gjykata ose hetuesit. Në momentin e ndryshimit të masave të sigurimit nga hetuesi, duhet kurdoherë miratimi i prokurorit, megjithatë nga ajo që rezulton nga përmbajta e nenit 6, ky miratim ka të bëjë vetëm me anën procedurale të mënyrës së veprimit të hetuesisë dhe nuk ka të bëjë me miratimin nga prokurori të faktit nëse jemi në kushtet për të ndryshuar ose jo masën e sigurimit.

Si përfundim, duhet thënë se K.Pr.Penale i Rep.Popullore Socialiste të Shqipërisë, është një kod ku të drejtat themelore të njeriut si dhe të drejtat që i takojnë organit të prokurorisë janë tërësisht të cenuara, duke suprimuar në këtë mënyrë shkeljen e këtyre të drejtave, duke sanksionuar gjithashtu të drejtat absolute të hetuesisë dhe gjykatës, duke i vendosur ato në një pozicion superior.

## KAPITULLIV

### ANALIZË KRAHASUESE E MASAVE TË SIGURIMIT SIPAS DISA LEGJISLACIONEVE

#### 5.1.Masat e sigurimit sipas Kodit te Procedurës Penale Italiane

Kodi Italian i Procedurës Penale është miratuar në vitin 1988 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1989. Ky kod është i ndarë në 11 libra, ku masat e sigurimit përfshihen në librin e katërt, i cili është i ndarë në dy tituj, ku në të parin janë përfshirë masat e sigurimit personal, ndërsa në të dytin masat e sigurimit pasuror. Ky kod në mënyrë ironike është quajtur si “kodi i profesorëve”, gati i pamundur për t’u zbatuar në praktikë, megjithatë ky kod ka arritur t’i bëjë ballë ndryshimeve të shpeshta të tij.

Kodi ynë i procedurës penale është miratuar në vitin 1995 dhe ka hyrë në fuqi po atë vit, ky kod duhet cilësuar si një variant bashkëkohor dhe si model të tij legjislatori ka zgjedhur pikërisht kodin Italian të procedurës penale, megjithatë ky kod është studiuar me kujdes dhe është ballafaquar me situatën, me traditat dhe me kushtet konkrete të vendit tonë. Duke qenë se kodi ynë i procedurës penale është ndërtuar mbi bazën e kodit të procedurës penale italiane, ndryshimet do të jenë të pakta, pasi ngjashmëritë dominojnë.

Kodi ynë i procedurës penale në nenin 227 të tij, i cili është neni që nis titullin e masave të sigurimit, bën ndarjen tradicionale të masave të sigurimit personal konkretisht në masa shtrënguese dhe masa ndaluese. Një dispozitë e tillë mungon në kodin e procedurës penale italiane, ku dispozita e parë e librit të masave të sigurimit nis me dispozitën e përgjithshme, në të cilën sanksionohet fakti se liria e personit mund të kufizohet vetëm sipas dispozitave të këtij kodi dhe vetëm me anë të masave të sigurimit. Një parashikim të tillë në kodin tonë e gjejmë vetëm në nenin 5 pika 1. Vlerësoj se parashikimi më i duhur është ai sipas kodit të procedurës

penale italiane, pasi një parashikim i tillë është në funksion të të drejtave dhe lirive themelore të të pandehurit.

Ashtu si në kodin tonë të procedurës penale dhe në kodin e procedurës penale italiane, në masat e sigurimit personal përfshihen masat shtrënguese dhe masat ndaluuese. Por kodi i procedurës penale italiane në kapitullon VII, në kuadër të masave të sigurimit personal përfshin dhe masat e sigurimit, të cilat kanë karakter të përkohshëm dhe janë pararendëse të masave të sigurimit personal. Një dispozitë të tillë nuk e gjejmë në kodin tonë të procedurës penale. Në nenin 273 të kodit të procedurës italiane, parashikohen kushtet e përgjithshme për marrjen e masave të sigurimit, këto kushte janë: ekzistenca e indiceve të rënda fajësie (*gravi indizi di colpevolezza*); ekzistenca e veprës penale; moszbatimi i masave të sigurimit kur ekzistojnë shkaqet e padënueshmërisë apo shuarjes së veprës penale. Këto kushte i gjejmë dhe tek kodi ynë i procedurës penale, por me ndryshimin që kodi Italian kërkon ekzistencën e “gravi indizi di colpevolezza”, që nuk është gjë tjetër veçse referimi në elementët e nevojshëm të provës dhe të mjaftueshëm për afirmimin e veprës penale. Në kodin tonë ky element është përkthyer në ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova. Kriteret e veçanta për marrjen e masave të sigurimit janë të njëjta në të dy kodet, por me një ndryshim ku në kodin Italian në rastin e largimit apo rrezikut të largimit të të pandehurit parashikohet që vepra penale për të cilën i pandehuri dyshohet të parashikoj dënim me burg jo më të ulët në maksimum se dy vjet. Ky parashikim nuk gjendet në kodin tonë dhe se vetëm në rastin e ndalimit të të dyshuarit për kryerjen e veprës penale kërkohet një gjë e tillë. Në shkronjën c) të nenit 274 të kodit të procedurës penale italiane, ku parashikohet mundësia që personi mund të kryej një vepër tjetër penale më të rëndë, renditen një nga disa vepra penale që personi mund të kryej, përsëri një parashikim i tillë mungon në kodin tonë. Vlerësoj se një parashikim i tillë nuk është i nevojshëm për t’u sanksionuar, pasi në momentin kur parashikohet mundësia që personi të kryej një vepër penale më të rëndë apo një tjetër të të njëjtit lloj, do të thotë se në këtë tërësi përfshihen një numër i madh veprash penale dhe se parashikimi i tyre sipas kodit të procedurës italiane ka jo më shumë se rol përcaktues dhe orientues, por asnjëherë shterues. Që të dy kodet janë të udhëhequr në momentin e arrestit në burg, nga parimi i proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë, si dhe përjashtimi sipas të cilit masa e sigurimit nuk mund të zbatohet ndaj një

gruaje shtatzënë apo me fëmijë në gji, një personi mbi shtatëdhjetë vjeç, një personi të sëmurë rëndë. Ajo që vihet re në kodin e procedurës penale italiane, është se në dispozitën e neni 275 nuk përfshihen toksikomanët dhe të alkoolizuarit, si dhe në pikën 3 të tij parashikohen disa vepra penale për të cilat duhet marrë vepra penale, këtë nuk e gjejmë në kodin tonë të procedurës. Vlerësoj se përjashtimi i toksikomanëve dhe i të alkoolizuarve përbën diskriminim negative ndaj diskriminimit pozitiv që parashikon neni 275 i kodit Italian, dhe si i tillë përfshirja e kësaj kategorie nga neni 230 i kodit tonë, përbën një element pozitiv jo diskriminues. Për përcaktimin e veprave penale, vlen i njëjti arsyetim si më sipër, që kanë vetëm rol përcaktues dhe orientues, por asnjëherë shterues. Pika 3 e nenit 230 i kodit të procedurës sonë, nuk gjen pasqyrimin në kodin e procedurës italiane, parashikim ky që është i domosdoshëm për mos t'u lënë vend abuzimeve.

Në lidhje me parashikimet për të miturin, ndryshe nga kodi ynë i cili vetëm disa paragrafë i kushton zbatimit të masës së sigurimit ndaj të miturit, në kodin Italian gjejmë disa nene për zbatimin e kësaj mase ndaj të miturit, mbështetur në parimin “për të mbrojtur rininë, duke parashikuar institutet e nevojshme për këtë qëllim”. Në nenet 16, 17, 18, 19, 20, të kodit Italian, parashikohen kushtet dhe kriteret që duhen mbajtur parasysh në caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturit apo në zbatimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit, kushte dhe kritere këto që duhet të merren në konsideratë bashkë me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 274, 275, 276 të kodit të procedurës italiane.

Në nenin 231 të kodit tonë të procedurës penale, ashtu dhe në nenin 276 të kodit të procedurës penale italiane, parashikohet e drejta që ka gjykata për të zëvendësuar apo bashkuar masën e sigurimit me një tjetër në rastin e shkeljes nga i pandehuri i detyrave dhe kushteve që rrjedhin nga vepra penale.

Neni 277 i kodit të procedurës penale italiane, në mënyrë të shprehur sanksionon faktin se gjatë zbatimit të masave të sigurimit duhet të mbahen gjithmonë parasysh nga gjykata të drejtat dhe liritë themelore të personit ndaj të cilit merret kjo masë, një dispozitë të tillë nuk e

gjejmë në kodin e procedurës sonë, pasi legjislatori mjaftohet me përcaktimin që i bën neni 1 i kodi ku shprehimisht thuhet: “Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimi e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit”. Neni 278 i kodit Italian, parashikon përfundimin e zbatimit të masës së sigurimit, përsërinjë dispozitë e tillë mungon në kodin tonë, duke qenë se një parashikim i tillë përfshihet në mënyrë indirekte në dispozitat e neneve të titullit të masave të sigurimit. Në nenin 279 të kodit të procedurës penale italiane, parashikohet se kush është gjyqtari, i cili do të përcaktojë masat e sigurimit, revokojë apo zëvendësojë atë, gjatë procedimit në gjykatë apo gjatë hetimeve paraprake. Ky parashikim nuk gjen vend në K.Pr.Penale, duke qenë se në nenet 13, 14, 74, 75, 76, 278, 327 e tjerë, përcaktohet se kush do të jetë gjykata që do të ketë kompetencën dhe se një parashikim i tillë sipas nenit 279 të C.P.Penal, vlerësoj se është i tepërt.

Në neni 232 të K.Pr.Penale, parashikohen në mënyrë të renditur masat shtrënguese dhe në nenet vijuese bëhet shtjellimi i tyre, ndërsa neni 280 i C.P.Penal, përcakton se masat shtrënguese të parashikuara në kapitullin dy, mund të zbatohen vetëm në rastin kur personi dyshohet për kryerjen e një veprë penale për të cilën masa e dënimit me burg nuk është më e ulët në maksimum se tre vjet, në kodin tonë nuk gjejmë një parashikim të tillë, dhe se unë mendoj se një parashikim i tillë do të ishte i nevojshëm, për mos t’i lënë hapësirë praktikave të gabuara të ndjekura nga organet proceduese, të cilat dhe për një vepër penale, që parashikon dënim me burg jo më të ulët në maksimum se dy vjet kërkojnë dhe zbatojnë masën e sigurimit arrest në burg.

Në kodin tonë të procedurës penale, parashikohen shtatë masa sigurimi, ndërsa sipas dispozitave të kodit të procedurës penale italiane, masat e sigurimit janë gjashtë, ku garancia pasurore sipas këtij kodi nuk është masë sigurimi. Duke qenë se ngjashmëritë midis dispozitave të të dy kodeve janë të shumta, në lidhje me përmbajtjen e masave të sigurimit, po ndalemi vetëm në analizën e dallimeve. Në rastin *e ndalimit të daljes jashtë shtetit*, dallimi i vetëm qëndron në faktin se sipas pikës 2 të nenit 281 të C.P.P, gjyqtari në momentin kur disponon me



vendim për caktimin e masës së sigurimit, përveç masës së kërkuar nga prokurori mund të caktojë dhe zbatimin e ndalimit të daljes jashtë shtetit, vlerësoj se një parashikim i tillë nuk do të bënte gjë tjetër veçse do të rëndonte të pandehurit, për më tepër se natyra shtrënguese e masave të sigurimit nuk lejon daljen jashtë shtetit. Tek *ndalimi dhe detyrimi për të qëndruar në një vend të caktuar*, dallimi i vetëm konsiston në pikën 4 të neni 283 të C.P.P, i cili i kushton një rëndësi interesave personale të të pandehurit. Masa e sigurimit *arrest në shtëpisjell* një dallim thelbësor midis dy kodeve dhe kjo lidhet me faktin se, sipas C.P.P, i pandehuri ndaj të cilit është zbatuar arresti në shtëpi ndodhet në të njëjtat kushte si i pandehuri ndaj të cilit është zbatuar arresti në burg, ndërsa sipas K.Pr.Penale, i pandehuri ndaj të cilit është zbatuar masa e sigurimit arrest në shtëpi ndodhet në të njëjtat kushte si i pandehuri ndaj të cilit është zbatuar arresti në burg vetëm për sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit. Një gjë e tillë reflektohet dhe në praktikën e gjykatave respektive, jurisprudencë italiane nuk lejon zëvendësimin e arrestit në burg me arrestin në shtëpi apo e kundërta.

Përmbajtja e dispozitës së *arrestit në burg* sipas K.Pr.Penale, është e cunguar pasi limitohet vetëm me sanksionimin e faktit se me vendimin e caktimit të masës së sigurimit arrest në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore të kapë të pandehurin dhe ta dërgojë atë pranë institucionit të paraburgimit, si dhe të njëjtat rregulla janë të vlefshme dhe në rastin e masës së sigurimit të vendosur si rezultat i kërkesës për ekstradim, në këtë rast K.Pr.Penale, mjaftohet me parashikimet e dispozitave të neneve 493 dhe 494, të cilat flasin për masat shtrënguese dhe zbatimin e përkohshëm të tyre në rastin e kërkesës për ekstradim. Tek personat që përfitojnë nga moszbatimi ndaj tyre i arrestit në burg janë dhe personat e sëmurë me AIDS apo sëmundje të rënda imunitare, nëse do të ndodheshim përpara një situatë të tillë, do të ndodheshim përpara një vakuumi ligjor të K.Pr.Penale.

C.P.P, përveç dy masave ndaluese të parashikuara nga kodi ynë, parashikon dhe atë të ndalimit të ushtrimit të të drejtës prindërore. Ndryshimi thelbësor që ekziston ndërmjet dy kodeve lidhet me masën e dënimit që parashikohet për veprën penale për të cilën i pandehuri dyshohet, ku sipas K.Pr.Penale, masa e dënimit me burg duhet të jetë më e lartë në maksimum se një vit, ndërsa C.P.P, parashikon se masa e dënimit me burg duhet të jetë më e lartë se tre

vjet, si dhe në këtë kod specifikohet se ato vepra duhet të cenojnë administratën publike, në rastin e pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, si dhe në rastin e ndalimit të ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale apo afariste vepra penale duhet të kryhet ndaj një veprimtarie publike, ekonomisë publike, industrisë dhe shërbimit.

Formaliteti i masave të sigurimit gjen të njëjtin pasqyrim në të dy kodet, por dhe në këto dispozita ka dallime. Në rastin e caktimit të masës së sigurimit dallimi qëndron në faktin se në C.P.P, nuk parashikohet fakti se gjyqtari nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori dhe thuhet shprehimisht se gjyqtari mund të disponojë me vendim për zbatimin e një mase më të lehtë se ajo e kërkuar nga prokurori vetëm në rastin kur prokurori në kërkesën e tij nuk ka kërkuar zbatimin e një mase konkrete. Në lidhje me vendimin për caktimin e masës së sigurimit, dallimi qëndron vetëm në emërtimin e personit ndaj të cilit merret kjo masë, ku sipas kodit tonë, flitet dhe për të pandehur dhe për person ndaj të cilit merret kjo masë, ndërsa C.P.P, në të gjithë dispozitat e tij shprehet për të pandehurin. Tek momenti i marrjes në pyetje dallimi qëndron në afatin brenda se cilit duhet bërë ky veprim procedural, ku sipas K.Pr.Penale, afati është tre ditë, ndërsa për C.P.P, afati është pesë ditë, si dhe për arrestin në shtëpi afati është pesëmbëdhjetë ditë.

Kohëzgjatja e masave të sigurimit për të dy kodet është e ndryshme gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe gjykimit në apel, ku për K.Pr.Penale, në gjykimin në shkallë të parë janë këto afate: për krimet respektive, 2 muaj, 9 muaj, 12 muaj; për C.P.P, 6 muaj, 12 muaj, 18 muaj;. Për gjykimin në apel K.Pr.Penale parashikon këto afate: 2 muaj, 6 muaj, 9 muaj; ndërsa për C.P.P, 9 muaj, 12 muaj, 18 muaj. Kohëzgjatja tërësore sipas K.Pr.Penale, është 10 muaj, 2 vjet, 3 vjet; ndërsa për C.P.P, është 2 vjet, 4 vjet, 6 vjet.

Në institutin e zgjatjes së paraburgimit ndryshon vetëm fakti se në kodin tonë kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të ndalojë 2/3 e masës së dënimit, ndërsa kodi Italian, kërkon të mos kalohet 1/2 e maksimales së dënimit. Për kohëzgjatjes e masave ndaluese duhet thënë se për K.Pr.Penale, është 3 muaj, ndërsa për C.P.P, është 2 muaj. Në rastin e disponimeve për lirimin e të pandehurit nga burgu C.P.P, ka vendosur afatin prej 20 ditësh brenda të cilit

gjqytari duhet të veprojë, ndërsa kodi ynë nuk e ka kufizuar gjyqtarin në kohë. Vlerësoj se vendosja e një afati të tillë është në funksion të mos zgjatjes së procedimeve. Ankimimi në vija të përgjithshme është i njëjtë në të dyja kodet, por mënyra sesi parashtrohet nga C.P.P, mendoj se është më e duhura, duke qenë se paraqet më të plotë dhe më të detajuar të drejtën e ankimit. Arresti në flagrancë apo ndalimi i dyshuarit dallon në të dy kodet vetëm për sa i përket vendit në të cilin legjislatori ka zgjedhur ti vendosë, ku sipas kodit tonë, është pjesë e titullit të masave të sigurimit, ndërsa sipas kodit Italian, është pjesë e titullit të hetimeve paraprake, duke qenë se këto veprime procedural janë të lidhura me veprimtarinë e policisë gjyqësore. Unë vlerësoj se zgjidhja sipas K.Pr.Penale, lidhet me faktin se arresti në flagrancë apo ndalimi i nënshtrohen kushteve dhe kriterëve të përcaktuara për masat e sigurimit, ndërsa zgjidhja sipas C.P.P, duket sikur kërkon të shkëpusë dhe të veçojë arrestin në flagrancë apo ndalimin e të dyshuarit nga masat e sigurimit, duke i lidhur ato më tepër me veprimtarinë e policisë gjyqësore gjatë fazës së hetimit paraprak.

Si përfundim, mendoj, se me të gjitha avantazhet apo disavantazhet që mund të ketë secili prej këtyre dy kodeve, do të konsiderohen si kode që kanë sjellë ide novatore dhe bashkëkohore, kjo sjell pamundësinë e përcaktimit të më të mirit.

## **5.2. Masat e sigurimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës**

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, është miratuar më 21.12.2012 dhe ka hyrë në fuqi më 1.1.2013. Ky kod përbëhet nga 5 (pesë) pjesë ku konkretisht: pjesa e parë “Dispozita të përgjithshme”, pjesa e dytë “Procedura penale”, pjesa e tretë “Administrimi i procedurës”, pjesa e katërt “Procedurat e veçanta” dhe pjesa e pestë “Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare”. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë përfshirë në pjesën e dytë, kapitulli dhjetë. Ky kod është cilësuar si kodi më perfekt pasi është kodi më i ri dhe ka huazuar më të mirën e kodeve të shteteve të tjera. Për miratimin dhe hyrjen në fuqi të kodit tonë kam folur gjerësisht më sipër, prandaj nuk do ndalem te kjo pjesë. Ndryshe nga kodi ynë i procedurës, i cili e fillon

titullin e masave të sigurimit duke bërë ndarjen tradicionale të masave të sigurimit personal konkretisht në masa shtrënguese dhe masa ndaluese,<sup>168</sup> kodi i Kosovës e nis kapitullin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit me klasifikimin e këtyre masave,<sup>169</sup> për të cilat do të flas gjerësisht më poshtë.

Në pikën tre të nenit 173 të K.Pr.P.K, parashikohet heqja e masave të sigurimit në momentin e pushimit të shkaqeve të cilat e kanë motivuar ekzistencën e tyre dhe në qoftë se plotësohen kushtet zëvendësimi i kësaj mase me një masë tjetër më të butë. E njëjta gjë parashikohet dhe në kodin tonë në nenin 260 “*Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit*”, ku shprehimisht në paragrafin e parë thuhet se, masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre, gjithashtu në paragrafin e dytë parashikohet zëvendësimi i masës me një më të lehtë në momentin kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Në kodin tonë parashikohet dhe mundësia e zëvendësimit të një mase të lehtë me një masë më të rëndë kur nevojat e sigurimit rëndohen, një parashikim i tillë mungon në kodin e Kosovës. Ky i fundit parashikon në mënyrë specifike se çfarë duhet kuptuar me “*masa më të buta*”.<sup>170</sup>

Kodi i Procedurës së Kosovës në nenin 175 paragrafi 1, parashikon se kërkesën për të lëshuar gjykatësi (i cili mund të jetë gjykatësi i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare) urdhërrarrestin e bën prokurori i shtetit ose në raste të ngutshme edhe policia. Ndërsa në kodin tonë parashikohet ndryshe ku në nenin 244 paragrafi 1, thuhet se kërkesën e bën veç prokurori. Dhe për sa i përket organit ekzekutues të urdhërrarrestit, të dy kodet parashikojnë organe të ndryshme të ngarkuara me këtë detyrë, ku në

---

<sup>168</sup> Shih neni 227 “Ndarja e masave të sigurimit personal”, të K.Pr.Penale.

<sup>169</sup> Shih neni 173 “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit”, paragrafi 1, të K.Pr.P.K.

<sup>170</sup> Shih neni 173 “Masat për sigurimi e pranisë së të pandehurit”, paragrafi 5, i K.Pr.P.K.

K.Pr.P.K, konkretisht në nenin 175/3 parashikohet se këtë detyrë e ka policia, ndërsa K.Pr.Penale në nenin 246/1 parashikon se është oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit. I njëjtë është parashikimi, se menjëherë pas arrestimit personi i arrestuar dërgohet para gjyqtarit i cili ka lëshuar masën e sigurimit të arrestit.

Vlerësoj se ky parashikim që bëjnë të dy kodet, është shumë i rëndësishëm pasi plotësojnë një të drejtë të njohur dhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut,<sup>171</sup> ku në nenin 6 të saj “*Edrejta për një proces të rregullt*”, paragrafi 1 shprehet se: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...”. Gjithashtu të dy kodet parashikojnë të drejtat e personit të arrestuar, siç janë e drejta e mbrojtjes, e drejta informimit në gjuhën që ai kupton etj.. Dhe ky parashikim është domethënës pasi, dhe pse ligji ua kufizon lirinë këtyre personave, po ai u garanton disa të drejta gjatë një procedure të tillë. Të njëjtën mbrojtje u jep dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në kodin tonë parashikohet dispozita “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, neni 233, i cili shpreh se me vendim gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori shtetëror shqiptar pa autorizimin e tij, gjithashtu gjykata merr masa për zbatimin e këtij urdhri. Pra këtu kemi të bëjmë me një vendim gjykate që ndalon, ndërsa K.Pr.P.K, e ka parashikuar dispozitën me titull “*Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin*”, neni 176, në këtë rast gjykata nuk shprehet me vendim por kërkon premtimin e të pandehurit se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës kur ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprë penale dhe ka arsye se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Po të shohim në këtë dispozitë dhe në dispozitat e tjera të këtij kodi vëmë re se përdoret “*dyshim i bazuar*” dhe nuk shoqërohet nga fjala “*provë*”. Vlerësoj, se kodi ynë në lidhje me këtë është më i qartë dhe i saktë, pasi parashikimi në dispozitë i fjalës “*provë*”,

<sup>171</sup> Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Romë, 4.XI.1950.

nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale. Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit a të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij.

Pra mos tëndodhemi para njëprocedurëapriori. Për sa u përket detyrave që vendos gjykata për zbatimin e vendimit ose të premtimit të dhënë, janë të njëjta në të dy kodet.

Të dy kodet parashikojnë masën e ndalimit të qëndrimit në një vend të caktuar. Me disa ndryshime të tilla si, kodi ynë në të njëjtën dispozitë neni 235, parashikon si ndalimin e qëndrimit në një vend të caktuar gjithashtu dhe detyrimin e qëndrimit në një vend të caktuar. Dhe në kodin e Kosovës e hasim këtë ku në të të njëjtën dispozitë neni 177, parashikohet ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar. Ndryshimi mes këtyre dispozitave konsiston në parashikimin e kushteve që i bën brenda kësaj dispozite kodi i Kosovës, ndërsa te kodi ynë kushtet dhe kriteret e vendosjes së një mase sigurimi janë parashikuar në dispozita të tjera.

Kemi ngjashmëri në të dy kodet për sa i përket masës së detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore ose në polici, sipas kodit përkatës.<sup>172</sup> Dhe në këtë dispozitë ndryshimi midis kodeve qëndron në parashikimin që i bën kodi i Kosovës, të kushteve për të vendosur këtë masë.

Një masë shumë e rëndësishme që i jep mundësi të pandehurit të procedohet në gjendje të lirë, me kusht që të paraqitet në organin procedues është “*Garancia pasurore*”, parashikuar nga neni 236 i kodit tonë. Sipas kësaj dispozite, vet i pandehuri ose një person që meriton besim nënshkruajnë një deklaratë me të cilën ata deklarojnë se pranojnë të depozitojnë një shumë të

---

<sup>172</sup> Shih neni 178 të K.Pr.P.K dhe Neni 234 të K.Pr.Penale.

caktuar nga gjykata në bankë, e cila shërben si garanci e paraqitjes së të pandehurit në organin procedues.

Të njëjtën dispozitë e hasim dhe të kodi i Kosovës, por me disa ndryshime duke nisur që nga emërtimi i dispozitës, konkretisht në këtë kod emërtohet “*Dorëzania*”, neni 179. Kjo dispozitë parashikon kur i pandehuri mund të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, i jep një vëmendje kësaj mase duke i kushtuar asaj disa nene. Mendoj, duke analizuar të katërt nenet që parashikon ky kod rreth dorëzanisë, se gjithçka është sqaruar në mënyrë specifike. Çdo detaj, çdo mundësi situatë rreth kësaj mase, duke filluar që nga përmbajtja e dorëzanisë,<sup>173</sup> kur ndodhemi para kushteve që ajo duhet hequr<sup>174</sup> dhe analizimi deri në detaje të aktvendimit të dorëzanisë.<sup>175</sup> “*Arrestit në shtëpi*”, është një masë të cilën e ndeshim shpesh në praktikën gjyqësore. Ngjashmëria midis dy kodeve konsiston në kuptimin rreth arrestit në shtëpi, ku kodi ynë në nenin 237 paragrafi 1, shprehet se: “*Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron që i pandehuri të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistentë*”. Gjithashtu në paragrafin 2 shprehet se: “*Kur është e nevojshme, gjykata i vë kufizime ose ndalime të pandehurit për të komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me atë*”. Ndërkohë në nenin 183 paragrafi 3 i kodit të Kosovës, parashikohet se: “*Gjykata me aktvendim vendos se i pandehuri nuk guxon të largohet nga lokalet ku ai e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik për trajtim ose përkujdesje. Gjykata mund ta kufizojë ose ndalojë kontaktin nëpërmjet të pandehurit dhe personave me të cilët ai nuk jeton apo nuk janë të varur nga i pandehuri. Përjashtimisht, gjykata mund të lejojë të pandehurit që për kohë*

---

<sup>173</sup> Shih neni 181 “Përmbajtja e dorëzanisë”, të K.Pr.P.K.

<sup>174</sup> Shih neni 182 “Heqja e dorëzanisë”, të K.Pr.P.K.

<sup>175</sup> Shih neni 180 “Aktvendimi mbi dorëzanimin”, të K.Pr.P.K.

*të caktuar të largohet nga lokalet ku mbahet arresti shtëpiak kur kjo është e domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore ose për kryerjen e ndonjë pune”. Fjalja e fundit e parashikuar në këtë paragraf përbën risi për Kodin e Kosovës, pasi vihet re qartë që te ne mungon ky parashikim. Mendoj, se një parashikim i tillë është shumë i rëndësishëm pasi jeta të ofron disa situata ku një vendimmarrje e tillë është zgjidhja e vetme, dhe në mungesë të tij mund të vijnë pasoja të pariparueshme. Dallimi tjetër mes këtyre kodeve konsiston në organin e ngarkuar me ligj për respektimin e masës së arrestit në shtëpi. Sipas K.Pr.Penale, është prokurori dhe policia gjyqësore të ngarkuar me detyrimin e respektimit të urdhrave që i janë dhënë të pandehurit, neni 237 paragrafi 3.*

Ndërsa sipas K.Pr.P.K, neni 183 paragrafi 6, është gjykata ajo që mbikëqyrë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak drejtpërdrejtë ose nëpërmjet policisë. Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi të dy kodet parashikojnë se vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin.

Në Kodin e Procedurës së Kosovës, në rrethin e masave të butave është dhe “*Diversioni*” neni 184, një masë e tillë nuk ekziston në kodin tonë të Procedurës Penale. Kur i pandehuri plotëson disa kushte: kur është arrestuar për një veprë penale për të cilën dënimi maksimal është jo më shumë se një vit dhe i cili nuk ka dënime të mëparshme ose nuk ka marrë pjesë në diversion me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake mund t’i caktohet kjo masë.

“Arrestit në burg”ose “Paraburgimi”, është masa më e rëndë prandaj kërkon një vëmendje më të madhe, pasi cenon drejtpërdrejtë lirinë e individit. Kjo masë sigurimi mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës penale dhe të pandehurit, neni 230 “*Kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg*” paragrafi 1i K.Pr.Penale. Të njëjtin parashikim bën dhe Kodi i Kosovës konkretisht në nenin 187 “*Kushtet për caktimin e paraburgimit*” paragrafi 1. Ky kod si dhe në parashikim e masave të tjera është me specifik.



## KAPITULLIVI

# INSTITUCIONET QË LUAJNË ROL NË CAKTIMINE MASAVE TE SIGURIMIT

### 6.1. Roli i Prokurorisë në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit

Neni 244 paragrafi 1,<sup>176</sup> shprehimisht thotë: “*masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa*”. Në këtë dispozitë na shprehet qartë rregulli procedural se është pikërisht institucioni i prokurorit që bën kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, duke u mbështetur në arsyet e parashikuara nga ligji.<sup>177</sup>

Në vendimin nr.4, datë 24.6.2009, Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë sqaruar hollësisht rregullat për caktimin e masave të sigurimit, duke theksuar: “*Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar dy mënyra për caktimin e masave të sigurimit personal. Mënyra e parë dhe që është rregulli për caktimin e masave të sigurimit është ajo që parashikohet pikërisht në nenin 244 e vijues të këtij kodi. Sipas këtij rregulli është prokurori, i cili, mbasi ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme se në ngarkim të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet për një veprë penale, ekziston dyshimi i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale i bën kërkesë gjykatës që ta caktojë një masë sigurimi personal, me qëllim që të garantojë nevojat e sigurimit.*

---

<sup>176</sup> Shih neni 244.

<sup>177</sup> Shih neni 228 e vijues të K.Pr.Penale.

## 6.2. Roli i gjykatës në caktimin dhe zbatimin e masës së sigurimit

Neni 244 paragrafi 1 ku shprehimisht thotë: “*masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsytet ku bazohet kërkesa*”. Në diskrecion të prokurorit është vetëm bërja e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, ndërsa vendimmarrja për të pranuar këtë kërkesë dhe më pas caktimi i masës së sigurimit, është në diskrecion vetëm të gjykatës. Pra vetëm një organ si gjykata ka tagrat për të pranuar dhe caktuar një masë sigurimi të caktuar.

Gjithashtu në vendimin nr.4, datë 24.6.2009, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur: “*pasi prokurori ka bërë kërkesë për të vendosur një masë sigurimi, gjykata verifikon nëse ekzistojnë realisht nevojat e sigurimit dhe nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal dhe duke verifikuar rrethanat faktike përcakton llojin e masës së sigurimit në përputhje me kriteret ligjore, me kushtin e vetëm që masa të mos jetë më e rëndë se ajo që kërkohet nga prokurori, neni 244 paragrafi 3 i K.Pr.Penale*.”

Neni 245 “Vendimi i gjykatës”, që nga vetë emërtimi i kësaj dispozite kuptohet që është institucioni i gjykatës i ngarkuar me të drejtën për të marrë vendimin në lidhje me pranimin dhe caktimin e një mase sigurimi të caktuar.

## 6.3. Roli i Policisë gjyqësore në caktimin dhe zbatimin e masës së sigurimit

Neni 246 paragrafi 1 shprehimisht thotë: “*Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që të zgjedhë një mbrojtës, njofton menjëherë mbrojtjen e zgjedhur nga i pandehuri ose i caktuar kryesisht dhe mban procesverbal për të gjitha veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit*”.

Në këtë dispozitë na del qartë roli që ka policia gjyqësore si zbatuese të masës së sigurimit. Pasi, është bërë një kërkesë nga prokurori dhe është marrë një vendim për caktimin e

masës së sigurimit nga gjykata, hyn në lojë oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, i cili realizon zbatimin e këtij vendimi duke i dorëzuar personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që ai ka për të pasur një mbrojtës.

Neni 251 “Arrestimi në flagrancë”, i K.Pr.Penale, shprehet se oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e një personi që kapet në flagrancë, duke u plotësuar disa kushte të caktuara që përmendet hollësisht në këtë dispozitë.

Në vendimin nr.4, datë 24.6.2009, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen: *“Mënyra e dytë që K.Pr.Penale parashikon për caktimin e masës së sigurimit përgjithësisht është nëpërmjet verifikimit të veprimeve me iniciativë të policisë gjyqësore në rastet e arrestimit në flagrancë, apo të ndalimit të personit të dyshuar për një vepër penale i cili ka rrezik ikje”*. Në këtë vendim të kolegjeve të bashkuara na tregohet roli që ka oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore, për të arrestuar një person pra për ti vendos një masë sigurimi, në qoftë së ndodhet para dy situatave që janë gjendja e flagrancës dhe ndalimi.

### **Jurisprudencë:**

Vendimi nr.3, datë 08.07.2013.

Kërkuesi Ylli Çelhaka është akuzuar nga organi i prokurorisë për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal për ngjarjen e ndodhur më datë 28.10.1997 në Rrethin e Kavajës, ku ka mbetur i vrarë me armë zjarri viktima Ardian Hima.

Me vendimin nr.19, datë 24.03.2000 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë e ka deklaruar fajtor të pandehurin Ylli Çelhaka për veprat penale për të cilat akuzohej, duke e dënuar atë përfundimisht me 20 vjet burgim, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe është vendosur mospranimi i ankimit në Gjykatën e Lartë.

Me datën 16.10.2006 Prokuroria pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka lëshuar Urdhrin e ekzekutimit për vendimin e formës së prerë, i cili është ekzekutuar nga organet kompetente me datë 17.10.2006, kohë kur ka filluar edhe llogaritja e dënimit për kërkuesin Ylli Çelhaka.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.558, datë 02.06.2010 ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim të paraqitur nga i dënuari Ylli Çelhaka, duke prishur vendimet e gjykatave dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjatë rigjyimit në shkallë të parë, kërkuesi ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg me pretendimin se ajo e ka humbur fuqinë për shkak të kalimit të afatit të përgjithshëm të paraburgimit, të parashikuar nga neni 261 e vijues i K.Pr.Penale.

Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr.13 akti, datë 20.07.2011 ka vendosur konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit të arrestit në shtëpi, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.19, datë 19.01.2012 ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme dhe pushimin e gjyimit të çështjes në lidhje me masën e sigurimit të arrestit në burg.

Në zbatim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka lëshuar Urdhrin e ekzekutimit që është ankuar nga kërkuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila në përfundim të gjyimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim që është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila ka pranuar kërkesën e kërkuesit, duke anuluar Urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga prokuroria me datë 02.04.2012, me të cilin kërkohet që të ekzekutohet edhe një herë vendimi nr.19, datë 24.03.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta në lidhje me pozicionin e të gjykuarit mbasi kërkesa për rishikim pranohet, vendosi që për njehsimin e praktikës gjyqësore, në këtë drejtim, çështjen penale që i përket kërkuarit Ylli Çelhaka ta kalojë në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Çështjet që shtrohen për t'u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore vlerësohen të jenë:

- a) *Në rast se kërkesa për rishikim të vendimit të dënimit pranohet sipas nenit 453/3 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>178</sup> cila do të jetë pozita procedurale e të gjykuarit në fazën e rigjyimit të çështjes?*
- b) *Në rast se vendimi i fajësisë pas rigjyimit të çështjes ndryshohet, ose i gjykuari shpallet i pafajshëm, cila do të jetë pozita procedurale nëse vazhdon procesi gjyqësor kundër tij?*

Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me çështjet që duhet të unifikohen për efekt të njehsimit të praktikës dhe të pasojës që ka në lidhje me zgjidhjen e çështjes:

Prokurori mbajti qëndrimin se: *“statusi i kërkuarit për rishikim të vendimit të dënimit, pas prishjes së vendimeve, mbetet po ai i të dënuarit dhe në kushtet kur dispozitat e Kreut IV të K.Pr.Penale, në nenet 449 deri 460 të tij, nuk parashikojnë shprehimisht marrjen e masave të sigurimit personal (ndryshe nga disa legjislacione të ngjashme të disa vendeve të tjera që zbatojnë institutin e rishikimit), atëherë mbetet të bëhet interpretimi i këtyre dispozitave për të përcaktuar se në çfarë regjimi sigurimi do të mbetet i gjykuari deri në pritjen e vendimit përfundimtar”.*

Mbrojtësi i të gjykuarit Ylli Çelhaka mbajti qëndrimin se: *“nga momenti që Gjykata e*

<sup>178</sup>Shih neni 453/3 “Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë”, i K.Pr.Penale.

*Lartë ka vendosur rishikimin e vendimit penal dhe çështja është dërguar për t'u rigjykuar, i pandehuri ka marrë cilësinë e të pandehurit në bazë të N.34/3 të K.Penal, i cili parashikon se: Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimitose kur vendoset rishqyrtimi i procesit. Ç'ka do të thotë se nga data 02.06.2010 mbi Ylli Çelhakën nuk ka rënduar një dënim penal me një vendim të formës së prerë dhe kësisoj në mungesë edhe të një mase sigurimi a mundet që ky i pandehur të qëndrojë në paraburgim për efekt të dënimit të mëparshëm”.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përgjigje të çështjeve të shtruara për diskutim me qëllimin unifikimin e praktikës gjyqësore, arrijnë në qëndrimin unifikues se: “Në rastin kur kërkesa e të dënuarit pranohet dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në bazë të kompetencës rishikuese që ka sipas nenit 453 të K.Pr.Penale i hap rrugë procesit gjyqësor të rishikimit, i gjykuari do të vazhdojë të ketë statusin procedural të të dënuarit. Pranimi i kërkesës për rishikim nuk pas sjell në vetvete revokimin e dënimit as edhe lirimin e të dënuarit, por vetëm rihapjen e procesit gjyqësor për efekt të sqarimit të rrethanave të reja me qëllim që vendimi gjyqësor t'i përgjigjet të vërtetës. Ky fakt do të ndodhë vetëm nëse në zbatim të nenit 454 të K.Pr.Penale Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ose gjykata kompetente e cila do të gjykojë çështjen në rishikim, e çmon të nevojshëm pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur nga ecuria e procesit penal vazhdimi i mëtejshëm i vuajtjes së dënimit me burgim do të vinin pasoja të rënda të pariparueshme.

*Pranimi i kërkesës për rishikim nuk e ndryshon pozitën procedurale nga ajo e të dënuarit në atë të të pandehurit. Në rast se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i hap rrugë rishikimit dhe në gjykimin rishikues në gjykatën e shkallës së parë i gjykuari deklarohet i pafajshëm pozicioni procedural i subjektit nuk është më ai i të dënuarit, por i të pandehurit. Kjo gjendje (statusi i të pandehurit) do të vazhdojë derisa vendimi i ri i pafajësisë i dhënë mbas rishikimit të marrë formë të prerë”.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke ju kthyer zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi në bazë të qëndrimit unifikues, konstatojnë se vendimi i gjykatës së apelit në lidhje me anulimin e urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e dënimit me burgim të caktuar me vendimin

nr.19, datë 24.03.2000 është marrë në kuptim dhe zbatim të gabuar të ligjit procedural penal në lidhje me pozitën procedurale të të gjykuarit Ylli Çelhaka, mbasi vendimi penal i dënimit është bërë objekt rishikimi.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se Gjykata e Apelit të Durrësit ka gabuar në interpretimin e nenit 454 të K.Pr.Penale në lidhje me statusin e kërkuesit Ylli Çelhaka gjatë rishikimit duke e konsideruar si të pandehur. Ashtu siç është përmendur më lart, prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, duke qenë se rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm i cili jep mundësinë e vlerësimit të vendimit gjyqësor dhe jo të procesit gjyqësor, ka të bëjë vetëm me efektet e pranimit të kërkesës për rishikim dhe të drejtën që ka gjykata kompetente për të vlerësuar drejtësinë procedurale me qëllimin që të korrigjohet gabimi që ka ardhur duke arritur në një konkluzion që i përgjigjet të vërtetës.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka përcaktuar pozicionin procedural të kërkuesit si i dënuar në lidhje me kërkesën e tij dhe në kushtet kur nuk kishte një vendim të posaçëm në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ka rrëzuar kërkesën e tij për anulimin e urdhrin të ekzekutimit. Arsyeimi ligjor i kësaj gjykate mbështetet në të drejtën që ka prokurori që, në varësi të statusit procedural që ka i gjykuari, në efektet e vendimit gjyqësor të procedojë në ekzekutimin e tij nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit.

Vlerësoj se arsyetimi që bën kolegji në këtë vendim, bie në kundërshtim me Kreun IV<sup>179</sup> të K.Pr.Penale, pasi sipas ligjit tonë procedural penal, Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nuk vendos vetëm për pranimin ose jo të kërkesës për rishikim dhe disponimin mbi vendimin e themelit ua delegon gjykatave më të ulëta, përkundrazi, ajo pasi pranon kërkesën për rishikim prish vendimet e dhëna nga të gjitha gjykatat e tre niveleve pra vendimet e dhëna nga Gjykata e lartë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Rrethit, dhe më pas e dërgon çështjen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Nëse do ndodheshim para

---

<sup>179</sup>Shih neni 449 e vijues të K.Pr.Penale.

situatës, ku Gjykata e Lartë do të vendoste vetëm pranimin e kërkesës për rishikim, pa disponuar mbi vendimet e marra nga gjykatat e tre niveleve, atëherë do të pajtohesh plotësisht me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Pas pranimit të kërkesës për rishikim dhe prishjes së vendimeve nga Gjykata e Lartë nuk ekziston më asnjë vendim dënimi, prandaj personi ndaj të cilit vazhdon procedimi penal menjëherë pas pranimit të kërkesës për rishikim dhe prishjes së vendimeve nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, merr automatikisht cilësinë e të pandehurit dhe gëzon të gjitha të drejtat e tij gjatë proceseve të mëpasshme gjyqësore.

Kjo do të binde ndesh me nenin 27 të Kushtetutës,<sup>180</sup> paragrafi 2 pika a, ku shprehimisht thuhet: *“liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente”*.

Gjithashtu dhe me nenin 5 paragrafi 1 pika a, të K.E.D.Nj.,<sup>181</sup> ku shprehimisht thuhet: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente”*. Në të dyja këto dispozita na del qartë që pa pasur një vendim gjykate nuk mund të kufizohet liria e personit. Kemi të bëjmë me një ndalim ligjor.

Ky vendim gjithashtu, bie në kundërshtim dhe me nenin 30 të kushtetutës:<sup>182</sup> *“kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”*. Përderisa çështja është kthyer në gjykatën e shkallës së parë dhe po shqyrtohet në themel nuk kemi të bëjmë me një vendim të formës së prerë akoma, pra nuk është dhënë një vendim dënimi që ky person të mbajë statusin e të dënuarit. Është jashtë çdo lloj logjike ligjore që një person pa marrë një dënim në ngarkim të tij të mbajë këtë status. Kjo do të çonte në cenimin e parimit të

<sup>180</sup> Shih neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>181</sup> Shih neni 5 i K.E.D.Nj.

<sup>182</sup> Shih neni 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



prezumimit të pafajësisë, një parim shumë i rëndësishëm për një procedim të rregullt penal, ku nuk duhet ta gjykojmë çështjes duke e konsideruar të dënuar, pa u dhënë një vendim nga gjykata kompetente. Çdo person deri sa gjykata të japë vendimin prezumohet i pafajshëm, pra dhe nëkuptimin e kësaj dispozite mbajtja e statusit të të dënuarit pas pranimit të rishikimit nga Gjykata e Lartë dhe dërgimit të çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, është në kundërshtim të plotë me të drejtat kushtetuese. Me këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore<sup>183</sup> në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, por ato nuk e kanë sqaruar gjykatën e rishqyrtimit të çështjes pra gjykatën në shkallë të parë (të pandehur, të gjykuar apo të dënuar), në një kohë që ndaj tij nuk ekziston asnjë lloj vendimi dënimi. Gjithashtu vlerësoj se Kolegji Penal duhet të arsyetonte në vendimin e dhënë prej tij se si do të jetë pjesa hyrëse e vendimit përfundimtar që do të japë gjykata e shkallës së parë pas rishqyrtimit të çështjes pra, si do të quhet kërkuesi në rastin konkret Ylli Çelhaka: i dënuar, i gjykuar apo i pandehur dhe gjithashtu duhet të shpjegojë se si do të jetë dispozitivi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në një kohë kur në arsyetimin e vendimit thuhet se: *kur gjykata e shkallës së parë prish vendimet dhe jep pafajësi masa e sigurimit shuhet.*

